



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr. 1, Tiranë; Tel-Fax: 069 40 57089

E - mail: [rmuca@klsh.org.al](mailto:rmuca@klsh.org.al); Web - site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 07/10/2018

Miratohet

Bujar LESKAJ



KRYETAR

# Raport Auditimi i Performancës "STRATEGJIA ANTIKORRUPSION"



Tetor 2018

Rinald M U Ç A

Drejtor i Departamentit

**Publik:** Ky dokument është pronësi e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ai përmban informacion publik dhe qëllimi i tij është transparenca tek palët e interesuara në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Ligjin 154/2014, "Për Organizimin dhe Funkionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", specifikisht nenin 34, pika (b), sikurse promovimi i përmirësimeve në sektorin publik, në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi dhe menaxhimin e shëndetshëm të 3E-ve. Çdo citim i këtij dokumenti të bëhet referuar burimit të tij zyrtar.



Departamenti i Performancës në KLSH

@Performanca

# **RAPORT AUDITIMI**

## **“PERFORMANCA E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE ANTIKORRUPSION 2015-2020”**

---

**Tetor 2018**

Auditimi është kryer në bazë të shkresave informuese nr. prot. 1222, datë 21.11.2017, si edhe programit të auditimit miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nr. 1222/1, datë 19.03.2018.

Projekt-raporti është draftuar nga grupi auditues dhe drejtori i departamentit në datë 18.06.2018, dhe përcjellë subjekteve: Ministria e Drejtësisë, Prefektura Tiranë, Prefektura Shkodër dhe Prefektura Fier, në përputhje me standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës e konkretisht; Standardet Audituese ISSAI 100, 300, 3000, 3100 dhe 3200, Manualin e Departamentit të Auditimit të Performancës, si edhe Rregulloren e Procedurave të Auditimit.

Në përputhje me Ligjin 154/2014, subjektet nën auditim patën në dispozicion 1 muaj kalendarik nga momenti i marrjes së projekt-raportit për të përcjellë në KLSH të gjitha komentet, observimet, sugjerimet apo mosdakordësitë që do t'i gjykonin të arsyeshme, referuar konkretisht kriterëve dhe argumenteve të tyre. Në respektim të afatit 1-mujor për komente nga subjektet nën auditim, vetëm Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. 7144/1, dt. 25.07.2018, Prefektura e Qarkut Tiranë, me shkresën nr. 3062/1 prot., datë 17.07.2018 dhe AMSHC me shkresën nr. 135/1 prot., datë 19.07.2018, përcollën shënime dhe komente mbi projekt-raportin e auditimit. Këto shënime dhe komente janë reflektuar në raportin përfundimtar të auditimit.

Pas hartimit të raportit përfundimtar, vlerësimit të dosjes audituese nga drejtori i departamentit dhe garantimit të cilësisë nga departamenti juridik dhe kontrollit të zbatimit të standardeve, Kryetari i KLSH-së konkludoi me Vendimin nr. 143, dt. 28.09.2018 e nr. prot. 1222/15.

Auditimi është kryer nga grupi i auditimit:

1. Z. Artur Hasanbelliu;
2. Z. Gjovalin Preçi;
3. Znj. Megi Kurushi;
4. Znj. Eva Leka.

dhe mbikëqyrur në mënyrë të posaçme nga drejtori i dept. të auditimit të performancës në KLSH, z. Rinald Muça.

## PËRMBAJTJA

Lista e shkurtimeve .....	7
1. RËNDËSIA E AUDITIMIT .....	8
1.1 Konteksti i problemit social .....	9
1.2 Strategjia e KLSH-së në auditimet e performancës .....	10
1.3 Auditime të mëparshme në këtë fushë.....	12
1.4 Subjekti nën auditim.....	13
1.4.1 Hyrje në subjektin që do të auditohet.....	14
1.4.2 Politikat e institucionit.....	14
1.4.3 Pesha në buxhet dhe PBB .....	15
1.4.4 Risqet e aktivitetit të subjektit .....	16
1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	18
1.4.6 Feedback-u i subjektit.....	20
2. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT .....	21
2.1 Objektivi dhe problemi i performancës .....	21
2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit të performancës.....	21
2.1.2 Objektivi i auditimit.....	22
2.2 Përkufizimet dhe terminologjia.....	23
2.3 Kriteret.....	23
2.3.1 Kriteret e politikës .....	23
2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit .....	23
2.3.3 Kriteret teknike dhe akademike .....	24
2.3.4 Kriteria të tjera/Praktika të mira.....	25
2.4 Piramida e pyetjeve audituese .....	25
2.4 Skema e Auditimit .....	26
2.5.1 Qasja/metodologjia e auditimit .....	27
2.5.2 Metodatat/teknikat audituese (Pragmatike/ qasja) .....	27
2.6 Rezultatet e parashikuara .....	28
2.6.1 Impakti për Kuvendin dhe Qeverinë .....	28
2.6.2 Impakti për publikun dhe palët e interesit.....	28
2.6.3 Forma e publikimit .....	29
3. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE .....	30
3.1 A është SMART objektivi A.11 dhe nënobjektivat përkatës? .....	32
3.1.1A ekziston metodologjia e duhur që integron arritjen e nënobjektivit në atë objektiv madhor të strategjisë?.....	32
3.2 Si janë zbatuar nënobjektivat e strategjisë dhe aktivitetet e PV për adoptimin e politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore?.....	48
3.2.1 Sa ka ndikuar angazhimi i Prefekturave në adoptimin e politikave kundër korrupsionit në nivel vendor? .....	48
3.2.2 A janë efektiv mekanizmate Monitorimit dhe të Vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal? .....	52
3.2.3 A realizohet ofrimi i shërbimeve administrative përmes sporteve unike në nivel vendor? .....	56

3.3 Cili është perceptimi i opinionit publik dhe palëve të tjera për politikat e ndërmarra kundër korrupsionit në qeverisjen vendore? .....	60
3.2.4 Si është perceptimi i opinionit publik mbi adoptimin e politikave kundër korrupsionit nga zyrtarët vendorë? .....	62
3.3.2 Cili është opinioni i shoqërisë civile mbi korrupsionin në qeverisjen vendore? .....	67
4. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE, KONKLUSIONEVE DHE REKOMANDIMEVE.....	78
4.1. Aneksë (tabela, grafikë, figura, pyetësorë, literature, etj.) .....	92
4.2 Bibliografia.....	97
5. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE .....	98

## Skemat

Skema 1: Varësia organizative e sektorëve të angazhuar me antikorrupsionin .....	13
Skema 2: Piramida e pyetjeve të auditimit .....	25
Skema 3: Skema e Auditimit .....	26
Skema 4: Grupet e interesit të konsultuara gjatë auditimit nga grupi i auditimit .....	30
Skema 5: Procesi në të cilin është audituar strategjia antikorrupsion dhe Plani i Veprimit 2015-2020.....	30
Skema 6: Institucionet zbatuese të SNKK 2015-2020 .....	42

## Grafikët

Grafiku 1: Renditja e Shqipërisë dhe fqinjëve në perceptimin e korrupsionit për vitin 2017.....	10
Grafiku 2: Renditja e Shqipërisë dhe fqinjëve në Index Score për vitin 2017.....	10
Grafiku 4: Prezantimi grafik i vendeve vakante dhe atyre të plotësuara me staf në tre sektorët me fokus antikorrupsionin.....	43
Grafiku 5: Rastet dhe fondet e abuzuara nga kontrollet e SHSSH 2015-2017.....	53
Grafiku 6: Ecuria e ngritjes së sporteve unike nga bashkitë 2015-2017.....	58
Grafiku 7: Perceptimi i qytetarëve mbi korrupsionin në qeverisjen vendore, për 3 vjeçarin e fundit .....	63
Grafiku 8: Format më të përhapura të korrupsionit në qeverisjen vendore.....	64
Grafiku 9: Masa e zbatimit nga qeverisja vendore e nënobjektivave të përcaktuara në PV .....	65
Grafiku 10: Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit për Shqipërinë dhe vendet e rajonit .....	68
Grafiku 11: Rëndësia e ndërmarrjes së aktiviteteve antikorrupsion (të gjeneruara nga praktikantët e mira) nga OJF-të vendase.....	76

## Tabelat

Tabela 1: Parashikimi i financimit të SNKK sipas qasjeve dhe burimeve të financimit ..	15
Tabela 3: Shpenzimet buxhetore për Strategjinë ndaj PBB për 2015-2016.....	16
Tabela 4: Analiza SËOT .....	17
Tabela 5: Arsyet e raportuara nga prefekturat për mos realizimin e objektivit specifik A11.1 “Krijimi i faqeve web të përditësuara” .....	39
Tabela 6: Masa e realizimit të objektivit specifik A11.1 “Krijimi i faqeve web të përditësuara” në planin e veprimit 2015-2020.....	40
Tabela 7: Vendet vakante pranë Ministrisë së Drejtësisë për sektorët dedikuar antikorrupsionit.....	42
Tabela 8: Raportimi i të gjitha prefekturave lidhur me A11.....	49
Tabela 9: Raportimi sipas prefekturave të marra në auditim.....	49
Tabela 10: Përmbledhje e realizimit të masave të objektivit madhor A11 .....	50
Tabela 11: Rastet dhe vlerat përkatëse të abuzimeve me fondet nga SHSSH 2015-2017 .....	53
Tabela 12: Efektiviteti i politikave antikorrupsion në Shqipëri dhe vendet e rajonit ..	69
Tabela 13: Krahasimi i rezultateve të synuara nga strategjia me rezultatet faktike të arritura .....	70



## ✂ Lista e shkurtimeve

BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
EUROSAI	European Organization of Supreme Audit Institutions Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
IDI	INTOSAI Development Initiative Iniciativa e Zhvillimit INTOSAI
INSTAT	Instituti i Statistikave
INTOSAI	International Organization of Supreme Audit Institutions Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPA(EU)	Instrument for Pre-Accession Assistance - European Commission Instrument i Ndhmës së Para-Anëtarësimit - Komisioni Evropian
ISSAI	International Standards of Supreme Audit Institutions Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KKK	Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
PV	Plani i Veprimit
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
SAI	Supreme Audit Institution Institucioni Suprem i Auditimit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SMART	Specific, Measurable, Achievable, Relevant, Time-Oriented Specifik, i Matshëm, i Arritshëm, i Rëndësishëm, i Orientuar drejt kohës
SNKK	Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit
SËOT	Strengths, Ëeaknesses, Opportunities, Threats Fuqitë, Dobësitë, Shancet, Kërcënimet
TI	Transparency International
UNDP	United Nations Development Programme Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

## 1. RËNDËSIA E AUDITIMIT

Auditimi në përgjithësi ka të bëjë me ekzaminim sistematik dhe të pavarur të dokumentacionit tërësor të një organizate, ndërsa auditimi i performancës lidhet me auditimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit dhe synon krahas të tjerave, formatizimin e ekonomisë, mirmenaxhimin e financave dhe fondeve publike, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe përdorimit të tyre, në luftë me abuzimin dhe shpërdorimin, vjedhjen, korrupsionin dhe keqpërdorimin e tyre.

KLSH auditon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë publikë, për të evidentuar nëse aktiviteti i tyre ka qenë me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet, duke rekomanduar masat e duhura për përmirësimin e performancës së tyre. Veç këtyre, nëpërmjet auditimit, KLSH bën transparente përdorimin e fondeve publike, administrimin e pronës publike dhe burimeve natyrore kombëtare, kryerjen në kohë, me cilësi dhe kosto optimale të shërbimeve publike etj.<sup>1</sup> Nëpërmjet auditimeve të performancës, KLSH bën vlerësimin e rezultateve përfundimtare dhe objektive të vendosura, në përputhje me politikat e subjektit të audituar.

Kryerja e auditimeve në përgjithësi dhe atyre të performancës në veçanti nga KLSH bëhet në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe EUROSAI. ISSAI 5700-Udhëzues për auditimin e parandalimit të korrupsionit, midis të tjerave ka përcaktuar se: *“Elementi i parë kyç për një luftë të suksesshme kundër korrupsionit është krijimi i objektivave ose prioriteteve strategjike përkatëse. Krijimi i një mjedisi pa korrupsion brenda një organizate është qëllim i dëshirueshëm, por jo gjithmonë mund të jetë një objektiv realist, pasi në disa raste korrupsioni mund të frenohet vetëm në një nivel të pranueshëm.”*

Tematika e auditimeve të performancës, nis me përzgjedhjen e propozimeve për auditim që në vitin paraardhës, në zbatim të Manualit të Auditimit të Departamentit të Performancës, i miratuar me urdhrin e Kryetarit të KLSH-së nr. 47, datë 30.04.20152. Veç kësaj, bashkëpunimi dhe ndarja e eksperiencave të përbashkëta me SAI-et e tjera për tema të caktuara auditimi është një nga rrugët e rritjes së cilësisë së auditimeve të KLSH-së. Në këtë kuadër është evidentuar dhe nevoja e auditimit të efektivitetit të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2015-2020. Fokusimi në këtë temë vjen pas krijimit të një eksperience departamentale mbi 6-vjeçare në auditimet e performancës të një numri të konsiderueshëm të institucioneve publike.

Korrupsioni mund të ketë një ndikim të madh negativ në ecurinë ekonomike, pasi ndikon në uljen e investimeve dhe ngadalëson rritjen ekonomike. Gjithashtu, ai transferon burimet publike në përfitime private, duke shmangur shpenzimet publike të nevojshme për arsimin, shëndetësinë, infrastrukturën, etj.

Duke zvogëluar të ardhurat nga taksat, korrupsioni mund të ndërlikojë menaxhimin makroekonomik. Ndër llojet e tjera të keqpërdorimeve, korrupsioni lidhet me nepotizmin, favorizimin, klientelizmin, ryshfetin, zhvatjen, përvetësimin, vjedhjen dhe mashtrimin.

Bazuar në sa më sipër, si dhe në faktin që Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me funksionin e tij kushtetues, ka për kompetencë auditimin me qëllim mbrojtjen e

---

<sup>1</sup> Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Neni 6.

<sup>2</sup> Manuali i Auditimit të Performancës

interesave publike, Departamenti i Auditimit të Performancës në KLSH ndërmori auditimin e performancës së efektivitetit të zbatimit të SNKK 2015-2020 dhe Planit të Veprimt (PV) 2015-2017. Nëpërmjet këtij auditimi, duke identifikuar dhe analizuar për një periudhë 3-vjeçare (2015-2017) çështjet që kanë të bëjnë me realizimin e objektivave të Strategjisë dhe zbatimin e PV, nivelin e angazhimit të aktorëve të përfshirë në këto dokumente, mbështetjen shtetërore, etj., janë paraqitur rekomandimet e duhura në drejtim të rritjes së nivelit të parandalimit të korrupsionit, në dobi të zhvillimit ekonomik, social dhe demokratik të vendit. Gjithashtu, ky auditim performance është një vlerë e shtuar në përvojën institucionale, pasi është orientuar në një segment të rëndësishëm të zbatimit të dokumenteve strategjike me impakt tërësor, në kushtet e mungesës së auditimeve të mirëfillta të performancës me këtë fokus.

### **1.1 Konteksti i problemit social**

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, politik dhe social është synimi kryesor i çdo vendi, për më tepër kjo bëhet dhe më e rëndësishme në shtetet me demokraci të brishtë dhe me institucione të dobëta. Krahas të tjerave, korrupsioni është një nga pengesat kryesore për arritjen e këtij synimi. *“Korrupsioni shkatërron vendet e punës dhe pengon zhvillimin, i kushton ekonomisë së botës miliarda dollarë çdo vit. I ngujon të varfrit në varfëri, përderisa qeveritë e korruptuara anembanë botës vjedhin buxhetin e shtetit dhe parandalojnë që njerëzit e devotshëm që punojnë me djersë dhe me ndershmëri të fitojnë nga frytet e punës së tyre. Korrupsioni vjedh investimet që duhej të shkonin në shkolla dhe spitale përderisa të korruptuarit u shmangen taksave që duhen paguar.”*<sup>3</sup> Me rritjen e korrupsionit dhe njohjen e efekteve të dëmshme të tij në rritjen ekonomike dhe stabilitetin shoqëror, kërkesa për strategji praktike për të reduktuar korrupsionin është rritur në mënyrë drastike.

Në vitin 2015, Progres-Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë ka theksuar se: *“U miratua një strategji e re antikorrupsion dhe një plan veprimi. Megjithatë, korrupsioni është i përhapur dhe nevojiten më shumë përpjekje për të bërë përparim me qëllim të krijimit të një rekordi të qëndrueshëm të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në të gjitha nivelet”*. Edhe në vitin 2016 është vlerësuar se nevojiten më shumë përpjekje për të luftuar korrupsionin në nivel të lartë, si dhe që, korrupsioni mbetet mbizotërues në shumë fusha dhe vazhdon të jetë një problem serioz.<sup>4</sup>

Korrupsioni dhe luftimi i tij vijojnë të jenë një nga sfidat kryesore dhe një nga prioritetet madhore ndërsektoriale për Shqipërinë, si dhe një ndër pesë politikat të cilat vendi ynë këshillohet t'i ndjekë me përparësi në procesin e integritetit evropian të vendit. Këtij qëllimi i shërben hartimi i SNKK 2015–2020, të miratuar me VKM nr. 247, datë 20.3.2015, si dhe PV i cili i referohet periudhës 2015–2017.

Sipas “Transparency International” Shqipëria renditet e 91-ta nga 176 vende në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit, një vend më sipër se Bosnje-Hercegovina, më mirë se Maqedonia (vendi i 107), por më keq se Kosova (85), Serbia (77), Greqia (59), Mali i Zi (64), etj. Parë në dinamikë në periudhën 2012-2016, Shqipëria ka bërë hapa përpara në perceptimin e nivelit të korrupsionit, duke shfaqur prirje në ulje, pasi në


---

<sup>3</sup>David Cameron-Ish kryeministri britanik.

<sup>4</sup> Commission Staff Working Document, Albania 2016 Report


vitin 2013 mbante 31 pikë dhe u ngrit në 39 pikë në vitin 2016, duke zbritur një pikë në 2017 me vlerësimin prej 38 pikësh<sup>5</sup>.

**Grafiku 1: Renditja e Shqipërisë dhe fqinjëve në perceptimin e korrupsionit për vitin 2017**



Burimi: Transparency International, perceptimi ndaj korrupsionit për vitin 2017.  
Punoi: Grupi i auditimit, KLSH

**Grafiku 2: Renditja e Shqipërisë dhe fqinjëve në Index Score për vitin 2017**



Burimi: Transparency International, Corruption Index Score për vitin 2017.  
Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

**1.2 Strategjia e KLSH-së në auditimet e performancës**

KLSH është i përkushtuar që të ruajë dhe promovojë vlerat e shoqërisë së hapur dhe të menduarit kritik, vetë-reflektues. Ai synon përsosmërinë në zotërimin e njohurive dhe aftësive audituese, kulturën për të ndjekur zhvillimin profesional dhe krijimin e dijeve të reja, si dhe angazhimin në promovimin e aplikimit të tyre në praktikën audituese, veçanërisht nëpërmjet implikimeve të tyre në rastet e korrupsionit dhe keqpërdorimit të fondeve publike.

KLSH, në përmbushje të misionit të tij, ka zhvilluar dhe do të zhvillojë instrumente dinamike drejt përsosjes së funksionimit, nëpërmjet vlerësimit objektiv të aktiviteteve, arritjeve dhe mangësive të tij. KLSH synon të jetë një model i ri për auditimin publik rajonal, një qendër për studimin e sfidave bashkëkohore të auditimit

<sup>5</sup> Vlerësimi me pikë është nga 1-100, ku sa më shumë pikë niveli i korrupsionit, aq më i ulët është ai.

në fushat ekonomike, sociale dhe politike dhe bazuar në analizën e “rrënjës” së faktorëve shkak-pasojë dhe një institucion që udhëheq nëpërmjet shembullit për të sjellë vlerë dhe krijuar impakt pozitiv në jetën dhe dinjitetin e qytetarëve.

KLSH ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme zhvillimet ndërkombëtare në fushën e auditimit, duke u përpjekur në përvetësimin e praktikave më të mira, si dhe i është përshtatur zhvillimeve ekonomike brenda vendit, me qëllim që të sigurojë shërbime publike optimale nëpërmjet përdorimit me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

Në këtë kuadër, KLSH, në përmbushje të funksionit të vet kushtetues, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI dhe Manualin e Departamentit të Auditimit të Performancës, i orientuar drejt modernizimit dhe rritjes cilësore profesionale të kapaciteteve njerëzore, strukturore dhe teknike, në të gjithë administratën publike, po e vë theksin gjithnjë e më tepër tek auditimi i performancës dhe roli këshillimor i tij.

“Auditimi i performancës” ka të bëjë me:

- Auditimin e ekonomicitetit, që nënkupton minimizimin e kostos së burimeve që përdoren në një veprimtari publike, duke mos cenuar cilësinë e tij;
- Auditimin e eficiencës, që nënkupton optimizimin e raportit, burime-rezultate të veprimtarisë publike, duke modifikuar proceset, strukturat dhe gjithë zinxhirin ekonomik të vlerës, në përputhje me standardet kombëtare e ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira;
- Auditimin e efektivitetit, që nënkupton vlerësimin e rezultateve përfundimtare dhe objektivave të vendosura, në përputhje me politikat e subjektit të audituar.

Objektivat për auditimin e performancës, të përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit 2018-2022, shkojnë përtej nxitjes së ndryshimit, duke synuar në rritjen e impaktit që këto auditime duhet të sjellin në interes të palëve të përfshira. Për këtë qëllim, Departamenti i Auditimit të Performancës synon të:

- Përcjellë në Kuvend çdo raport auditimi performance, duke kërkuar edhe të dëgjohet në seanca të posaçme për çështje kritike.
- Shtojë peshën e vet të raportimit në dy raportet që KLSH përcjell çdo vit si dokumente integrale në Kuvend (Raporti për Zbatimin e Buxhetit Faktik dhe Raporti për Performancën Institucionale).
- Rrisë pjesëmarrjen aktive në konferenca, *workshop*-e e takime jashtë vendit, duke prezantuar dhe promovuar punën audituese;
- Organizojë mbi baza periodike takime me gazetarët, akademinë dhe shoqërinë civile për të rritur impaktin dhe marrë *feedback*.
- Ruajë dhe rrisë prezencën në median e shkruar, duke synuar kalimin edhe në median vizive.
- Shtojë numrin e ndjekësve në kanalet sociale, duke shënjestruar moshën e re, për të ndërgjegjësuar brezin e ri për problemet e vendit dhe joshur ata drejt pjesëmarrjes në zgjidhjen e problemeve.
- Nxisë dhe mbështesë botimet institucionale lidhur me performancën.

Auditimi i Performancës në KLSH, në momentin e hartimit të Strategjisë 2018-2022, synon të rritet duke u bërë promotor i zhvillimit institucional dhe konsoliduar në një auditim analitik, këshillues, bashkëpunues e vlerështues duke synuar që numri i auditimeve të performancës të shkojë në 30-35% të punës audituese institucionale.

Kontrrolli i Lartë i Shtetit nuk auditon thjesht institucionet publike për performancën e tyre, por udhëheq institucionalisht me performancën e vet.

Nga ana tjetër, Kontrrolli i Lartë i Shtetit, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, bashkëpunon me institucione të tjera të larta të auditimit, me organizata profesionale, vendase apo ndërkombëtare<sup>6</sup>. Një nga format e bashkëpunimit është dhe pjesëmarrja në formë të përshtatshme për auditimin. Në këtë kuadër, KLSH në mars të vitit 2017 ka nënshkruar Marrëveshjen e bashkëpunimit për Programin Global të INTOSAI Development Initiative (IDI) mbi Institucionet Supreme të Auditimit në luftën kundër korrupsionit. Pikërisht ky auditim performance i SNKK është në detyrimet e kësaj marrëveshjeje, i cili kryhet duke shkëmbyer eksperiencat me mjaft vende të tjera të botës, bazuar në ISSAI 30 “Kodi i etikës”.

Gjithashtu, Kontrrolli i Lartë i Shtetit ka qenë pjesëmarrës në Konferencën e VI-të Ndërkombëtare për Antikorrupsionin, mbajtur në Varshavë, Poloni në datat 9-10 dhjetor 2015, fokusi i së cilës ishte forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

### **1.3 Auditime të mëparshme në këtë fushë**

Grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion mbi auditimet e kryera për performancën e zbatimit të SNKK dhe PV në periudhën 2015-2017. Nga analiza e dokumentacionit, si dhe nga takimet me pjesëtarë të stafit të Ministrisë së Drejtësisë (MD), konstatohet se nuk ka pasur auditime mbi zbatimin e strategjisë antikorrupsion.

KLSH, nëpërmjet veprimtarisë saj audituese (auditime përputhshmërie, financiare, të performancës dhe të IT-së) ka pasur në qendër të vëmendjes luftën kundër korrupsionit në institucionet publike nëpërmjet masave rekomanduese për përmirësime ligjore, organizative, shpërblim dëmi, administrative, disiplinore dhe kallëzime penale. KLSH, nëpërmjet auditimeve i ka paraqitur Kuvendit, mediave dhe mbi të gjitha publikut, vlerat dhe përfitimet që ka sjellë performanca e KLSH-së, referuar impaktit në financat publike dhe luftën ndaj korrupsionit në Shqipëri.

Në vitin 2015, janë marrë në analizë 464 shkelje të konstatuara nga KLSH në disa institucione. Bazuar mbi perceptimin e monitoruesit, por mbështetur në gjetjet e KLSH-së dhe rekomandimet që janë dhënë, është konstatuar një shkallë e ulët e shkeljeve me natyrë korruptive në krahasim me ato që lidhen me shkelje të procedurave dhe më shumë në krahasim me ato që përbëjnë shkaktim dëmi. Kështu kemi shkelje me natyrë korruptive, gjithsej, 92 ose afërsisht 20%; shkelje me shpërdorim të pasurisë, gjithsej, 87 ose 19% dhe shkelje të procedurave, gjithsej 285 ose 61%<sup>7</sup>.

Në përputhje me objektivin e tij strategjik të përmirësimit të qeverisjes, nëpërmjet thellimit të luftës kundër korrupsionit, institucioni gjatë vitit 2016, për shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, me pasojë shpërdorimin e fondeve publike dhe dëmtimin e pronës publike, ka bërë 49 kallëzime penale ndaj 191 punonjësve publikë, kryesisht nëpunës të lartë dhe të mesëm të administratës<sup>8</sup>.

Sipas të dhënave në vitin 2017, KLSH ka bërë 51 kallëzime penale për 126 nëpunës të administratës publike për dëmin ekonomik të shkaktuar prej 151,946 mijë lekë.

---

<sup>6</sup> Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 8.

<sup>7</sup> Raporti Vjetor i Performancës 2015.


<sup>8</sup> Raporti Vjetor i Performancës 2016.

#### 1.4 Subjekti nën auditim

Subjekti nën auditim është Ministria e Drejtësisë, e cila me VKM nr. 506, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, është në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK), rol të cilin që prej 22.11.2013 e ka mbajtur Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore. Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, si dhe ushtron çdo përgjegjësi tjetër shtetërore që i ngarkohet me ligj ose akte të Këshillit të Ministrave.<sup>9</sup>

Sipas strukturës organizative<sup>10</sup> të MD-së, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave në Fushën e Drejtësisë, tek Drejtoria e Programeve në Fushën e Drejtësisë është Sektori i Programeve në Fushën e Drejtësisë dhe Antikorrupsionit, i cili përbëhet nga 3 nëpunës: 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë. Gjithashtu, po në këtë Drejtori, tek Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve ndodhet Sektori i Projektit Antikorrupsion i përbërë nga 3 nëpunës.

#### Skema 1: Varësia organizative e sektorëve të angazhuar me antikorrupsionin



Burimi: Ministria e Drejtësisë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

<sup>9</sup>VKM nr. 506, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”

<sup>10</sup> <http://www.drejtesia.gov.al/al/ministria/organigrama-e-ministrise-se-drejtises>

Meqenëse grupi i auditimit mori në shqyrtim zbatimin e SNKK dhe të PV për objektivin A.11 “Adoptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore”, subjekte auditimi ishin 3 prefektura dhe 3 bashki me shpërndarje territoriale në të gjithë vendin. Duke marrë për bazë shtrirjen gjeografike, si dhe numrin e popullsisë e aktiviteteve, u përzgjedhën prefekturat dhe bashkia e Tiranës, Shkodrës dhe Fierit. Sipas të dhënave të monitorimit për vitin 2015, janë gjithsej 60 pika kontakti, nga të cilat për 12 prefekturat niveli i përfaqësimit varion nga Sekretari i Përgjithshëm te Drejtor Drejtorie/Shef Sektori, Këshilltar apo pozicione të ngjashme.

#### **1.4.1 Hyrje në subjektin që do të auditohet**

Ministria e Drejtësisë, si institucion i administratës shtetërore është ngritur në zbatim të Ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe fusha e përgjegjësisë shtetërore të kësaj ministrie është përcaktuar me VKM nr. 506, datë 13.9.2017.

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, ushtron funksione dhe ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe midis të tjerave ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, etj., si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi<sup>11</sup>. Në *website*-n zyrtar të MD nuk është i përfshirë në funksionin dhe misionin e saj në mënyrë specifike roli i KKK.

Lufta kundër korrupsionit nuk përbën vetëm një prioritet për Qeverinë ndër shumë të tjerë, por përbën një nga 5 prioritetet kyçe që Bashkimi Evropian ka vendosur për Shqipërinë në rrugëtimin e saj të integritimit në familjen evropiane. Në këtë kuadër, në shkurt 2015, Qeveria prezantoi portalin unik të denoncimit të praktikave korruptive [www.stopkorrupsionit.al](http://www.stopkorrupsionit.al), një platformë e krijuar enkas për qytetarët, përmes së cilës ata kanë mundësi të denoncojnë edhe në mënyrë anonime praktikat korruptive me të cilat përballen, por që në tetor 2017, është cilësuar nga Kryeministri si faqe elektronike që nuk ka funksionuar.<sup>12</sup>

Duke qenë se korrupsioni është tejet kompleks dhe prek shumë sektorë, qeveria ka caktuar një koordinator kombëtar kundër korrupsionit dhe ka ngritur një rrjet institucionesh përgjegjëse kundër korrupsionit. Megjithatë, sfidat më të mëdha mbeten në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë dhe bashkërendimin e punës së institucioneve, si edhe ndryshimet e nevojshme ligjore për të siguruar efektivitetin në luftën kundër korrupsionit.<sup>13</sup>

Subjektet e audituara janë dhe tre prefektura me bashkitë qendër: Tiranë, Shkodër dhe Fier. Në zbatim të SKKK dhe të PV, prefekturat kanë pikat e kontaktit të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit, si dhe përgatisin raportet e monitorimit për sekretariatit teknik.

#### **1.4.2 Politikat e institucionit**

Politikat e Ministrisë së Drejtësisë në drejtim të monitorimit dhe zbatimit të SNKK 2015-2020 dhe PV 2015-2017 janë në një fazë fillestare, pasi roli i Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit për këtë çështje i është dhënë në shtator 2017.

---

<sup>11</sup> <http://www.drejtesia.gov.al/al/ministria/misioni>

<sup>12</sup> Nga fjala e Kryeministrit gjatë prezantimit të platformës së bashkëqeverisjes, 6 tetor 2017

<sup>13</sup> Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim, fq 20-21

Në fakt, deri në shtator 2017, institucioni i ngarkuar drejtpërdrejt dhe me çështje thelbësore, të veçantë dhe të zgjeruar të fushës së veprimtarisë për bashkërendimin e punës për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit ka qenë Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore. Në këtë mënyrë, që nga viti i kaluar ka një rrudhje të rëndësisë së trajtimit të politikave institucionale kundër korrupsionit.

Megjithatë, qeveria ka synuar intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, për të ç'montuar murin e paprekshmërisë e pandëshkueshmërisë, për t'u përqendruar në tre drejtime: parandalim, ndërgjegjësim dhe ndëshkim<sup>14</sup>. Këto synime kanë gjetur shprehjen e tyre në SNKK 2015-2020 dhe PV 2015-2017, të miratuara me VKM nr. 247, datë 20.3.2015.

Vizioni i Strategjisë kundër korrupsionit mban në konsideratë institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm.<sup>15</sup>

Parë në tërësi, konstatohet se pikat e kontaktit dhe rrjeti i koordinatorëve janë në tre nivele: në institucionet qendrore, institucionet e pavarura dhe në nivel lokal për prefekturat. Në këtë kuadër, në varësi të peshës që zënë objektivat dhe nënobjektivat për njësitë e qeverisjes vendore dhe prefekturat, realizimi i tyre ndikon në zbatimin e Strategjisë dhe të Planit të Veprimit.

### 1.4.3 Pesha në buxhet dhe PBB

Financimi i Planit të Veprimit të strategjisë është planifikuar të realizohet nga dy burime kryesore, nga buxheti i shtetit dhe nga mbështetja financiare e komunitetit të donatorëve. Buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit në masën 49% të financimit të nevojshëm. Ndërsa pjesa tjetër pritet të financohet nga Bashkimi Evropian dhe nga donatorët (Banka Botërore, UNDP, OSBE, USAID, OPDAT, etj.). Në momentin e hartimit të Planit të Veprimit hendeku financiar vlerësohet të jetë në masën 23% të totalit<sup>16</sup>.

Të dhënat mbi kostot e parashikuara të kësaj Strategjie, së bashku me burimet e financimit të ndara sipas Qasjeve jepen në tabelën e mëposhtme dhe ilustrohen grafikisht në vijim.

**Tabela 1: Parashikimi i financimit të SNKK sipas qasjeve dhe burimeve të financimit**

Qasjet e Strategjisë	Kostoja totale potenciale	Burimet e financimit			
		Buxheti i shtetit	IPA (EU)	Donatorë të tjerë	Hendeku financiar
<b>Qasja Parandaluese</b>	986,706,634.6	372,174,714.6	170,240,000	268,619,000	175,672,920
<b>Qasja Ndëshkimore</b>	548,090,432	477,791,000	-	-	70,299,432
<b>Qasja Ndërgjegjësuere</b>	195,930,243	1,080,000.00	-	48,970,243	145,880,000

<sup>14</sup><https://www.kryeministria.al/al/programi/shteti-i-se-drejt-es-dhe-demokratizimi-i-shoqerise/lufta-kunder-korrupsionit>


<sup>15</sup> Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020, kapitulli 2

<sup>16</sup> Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020, kapitulli 4 – Burimet Financiare

<b>Total</b>	1,730,727,309	851,045,714.6	170,240,000	317,589,243	391,852,352
<b>Ekuivalent në EURO</b>	12,362,337.93	6,078,897.96	1,216,000	2,268,494.59	2,798,945.37

Burimi: Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nga të dhënat konstatohet se në shumën e parashikuara për t'u alokuar për SNKK, pesha më e madhe e fondeve është parashikuar të sigurohet nga financues të tjerë në masën 51% të totalit të kostos potenciale, ndërsa 49 % nga buxheti i shtetit. Qasja së cilës do t'i alokohen më shumë fonde në total është ajo parandaluese, 57% e totalit të fondeve të planifikuara për zbatimin e SNKK. Për shkak të rëndësisë dhe peshës së madhe të fondeve, Qasja Parandaluese do të jetë në fokus të këtij auditimi.



**Tabela 2: Shpenzimet buxhetore për Strategjinë ndaj PBB për 2015-2016**

*në 000 lekë*

Emërtimi	2015	2016
<b>PBB total</b>	2,333,075,723	2,413,800,143
<b>Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit</b>	151,512	357,041
<b>Përqindja ndaj PBB total</b>	<b>0.006%</b>	<b>0.015%</b>

Burimi: Të dhëna të INSTAT dhe raportit vjetor 2016 SNKK, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nëse do të vërenim peshën që Strategjia zë në tërësinë e Prodhimit të Brendshëm Bruto, do të dallonim qartësisht se ajo është edhe më e cunuar në krahasim me peshën në buxhetin e shtetit. Financimi për SNKK ka zënë vetëm 0.006% të vlerës totale të PBB për vitin 2015 në Shqipëri, si dhe 0.015% për vitin 2016. Sikurse në tabelën pararendëse, vihet re një rritje e lehtë në vitin 2016. Financimi i SNKK dhe pesha që ajo zë në buxhet ka rëndësi jetike për implementimin e politikave të saj dhe luftës ndaj korrupsionit.

#### 1.4.4 Risqet e aktivitetit të subjektit

Risqet e aktivitetit të subjektit janë ato me të cilat përballet MD dhe institucionet e

tjera përgjegjëse për realizimin e funksioneve dhe përgjegjësi të tyre në lidhje me zbatimin e Strategjisë dhe PV.

Korrupsioni dhe luftimi i tij vijojnë të jenë një nga sfidat kryesore dhe një nga prioritetet madhore ndërsektoriale për Shqipërinë<sup>17</sup>. Transparenca në veprimtarinë shtetërore, parandalimi i konfliktit të interesave, deklarimi i pasurisë, kontrolli i financimit të partive politike, etj., janë disa prej sfidave kryesore në kuadrin e parandalimit të korrupsionit.

Risqet e aktivitetit të Ministrisë së Drejtësisë në rolin si Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit dhe institucioneve të tjera përgjegjëse të përfshira në luftën kundër korrupsionit, fokusuar në artikullimin dhe adoptimin e politikave antikorrupsion në nivelin e qeverisjes vendore, janë analizuar dhe evidentuar të klasifikuara sipas analizës SWOT.

**Tabela 3: Analiza SWOT**

Fuqitë (S)	Dobësitë (W)
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Plani i ri i veprimit i hartuar nga vetë MD në rolin e koordinatorit.</li> <li>• Faqe web e përditësuar e MD</li> <li>• Programi i transparencës së MD-së</li> <li>• Stafi antikorrupsion në MD më i madh në numër dhe më i konsoliduar se në Ministrinë e Shtetit për Çështjet Vendore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mosrespektim i detyrave funksionale që i ngarkon ligji.</li> <li>• Mosrespektim i detyrave funksionale që i ngarkon VKM, Nr. 506, datë 13.9.2017.</li> <li>• Përcaktimi me vonesë i KKK nga ana e Ministrit të Drejtësisë që nga momenti i marrjes së kësaj kompetence.</li> <li>• Mungesa e arkivave dhe e kujtesës institucionale për vijimin e punës pa ndërprerje</li> <li>• Objektiva dhe nënobjektivat jo-SMART të SNKK dhe PV-së.</li> <li>• Rrjeti i pikave të kontaktit jo i plotë dhe jo i rishikuar në lidhje me ndryshimet, në vazhdimësi.</li> <li>• Lista jo të plota dhe të papërditësuara të pikave të kontaktit (fokale) nga ana e MD.</li> <li>• Në rregulloren dhe dokumentet strategjike të institucionit nuk është reflektuar marrja e rolit të KKK në MD.</li> <li>• Mosemërimi i stafit në pozicionet e përcaktuara në Strukturën Organizative të MD, në Sektorin e Programeve në Fushën e Drejtësisë dhe Sektorin e Projektit Antikorrupsion</li> <li>• Mungesë e faqeve web apo faqe web të prefekturave të papërditësuara.</li> </ul>

<sup>17</sup> Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020, fq. 5

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesë specialistësh, të nevojshëm për adoptimin e politikave antikorrupsion të përcaktuar në SNKK. Si p. sh. për krijimin dhe menaxhimin e faqeve web, apo regjistrin tematik të ankesave, etj.</li> <li>• Pamundësi e prefekturave për të publikuar në web dokumentet e përcaktuara në SNKK, si rezultat i mungesës së faqeve.</li> <li>• Mungesa e besimit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional nga MD dhe prefekturat, me aktorët e tjerë të përfshirë në strategjinë ndërsektoriale kundër korrupsionit.</li> <li>• Mungesa në burimet njerëzore dhe në kapacitetet e tyre.</li> </ul>
<b>Shanset (O)</b>	<b>Kërcënimet (T)</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Çështja antikorrupsion (në Shqipëri) në fokus të ndërkombëtarëve dhe Bashkimit Evropian.</li> <li>• Çështja antikorrupsion një ndër prioritetet kryesore të qeverisë.</li> <li>• Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale në 2014-ën.</li> <li>• Miratimi i Ligjit nr. 60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”</li> <li>• Ndryshimet në ligjin antimafia në 2014-ën.</li> <li>• Miratimi i Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”</li> <li>• Mundësia e përditësimit dhe ndryshimit të Planit të Veprimit.</li> <li>• Platforma e Bashkëqeverisjes “Shqipëria që duam”.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mos saktësimi i një strukture që siguron vazhdimësinë dhe mbarëvajtjen e zbatimit të strategjisë dhe Planit të Veprimit.</li> <li>• Pamundësia për përditësimin e SNKK.</li> <li>• Mos arritja e mbështetjes financiare të nevojshme nga ana e Këshillit të Ministrave nëpërmjet komunitetit të donatorëve, për ato masa të PV-së që nuk janë të mbuluara financiarisht në SNKK.</li> <li>• Paqëndrueshmëria e administratës publike.</li> <li>• Moskrijimi i strukturave, apo mospërcaktimi i personave përgjegjës nga institucione zbatuese, për të siguruar zbatimin e masave të përcaktuara në SNKK.</li> <li>• Mungesë e angazhimit nga ana e aktorëve të tjerë (shoqëria civile dhe publiku) në luftën kundër korrupsionit.</li> <li>• Mosreflektimi i opinionit dhe eksperiencave të palëve të tjera (publiku, organizatat jofitimprurëse, etj.) në hartimin e SNKK dhe PV.</li> </ul>

Punoi: Grupi i auditimit, KLSH

#### 1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjektit

Subjekti i audituar është MD, e cila detyrën e KKK e ka marrë në shtator 2017, me VKM nr. 506, datë 13.9.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të

Ministrisë së Drejtësisë”. MD, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, në rolin e KKK, bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, si dhe ushtron çdo përgjegjësi tjetër shtetërore që i ngarkohet me ligj ose akte të Këshillit të Ministrave.<sup>18</sup>

Më parë kjo detyrë është ushtruar nga ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, i cili për shkak të shkrirjes nuk funksionon më si i tillë.

Në zbatim të SNKK, institucionet e pushtetit vendor, përfshihen në programin antikorrupsion, duke adoptuar objektivat dhe politikat antikorrupsion të qeverisë, dhe duke i përshtatur ato me specifikat e pushtetit vendor në këto drejtime kryesore:

1. Krijimi i *one stop shop* në nivel vendor për ofrimin e shërbimeve dhe/ose lehtësimi i procedurave për marrjen e shërbimeve;
2. Krijimi i faqeve web të përditësuara dhe publikimi i të dhënave në çdo njësi i buxheteve dhe i shpenzimeve të çdo bashkie;
3. Ofrimi i praktikave më të mira njësigje të reja të qeverisjes vendore lidhur me menaxhimin dhe raportimin e financave;
4. Krijimi i mekanizmit të monitorimit dhe të vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe të ndihmës ekonomike në nivel lokal.

Të gjitha këto drejtime, zbërthehen sipas PV 2015-2017 në 6 produkte finale që parashikohen të arrihen nga zbatimi i objektivit A11 të SNKK:

- Krijimi i faqeve web të përditësuara
- Krijimi i mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal
- Publikimi në ambientet publike dhe internet të prefekturave të buxheteve dhe shpenzimeve të çdo komune dhe bashkie në qark
- Krijimi i regjistrit tematik të ankesave
- Ofrimi i shërbimeve administrative në nivel vendor përmes sporteleve unike
- Publikimi në ambientet publike të çdo prefekturave të akteve nënligjore të miratuara nga bashkitë përkatëse të qarikut

Në zbatim të kësaj strategjie, këto produkte të parashikuara për t’u arritur deri në fund të vitit 2017, në thelb synojnë të rrisin aksesin e informacionit të publikuar për çdo qytetar dhe të minimizojnë radhët e pritjes nëpër institucionet e pushtetit lokal. Në këtë mënyrë, këto produkte kërkojnë të ulin edhe kontaktin e qytetarëve me zyrtarët e komunave apo bashkive duke ulur riskun e korrupsionit të mundshëm.

Gjithashtu, transparenca dhe disponueshmëria në dhënien e informacioneve lidhur me aktivitetin e pushtetit lokal që parashikojnë këto produkte, synojnë të rrisin cilësinë e llogaridhënies duke ulur riskun e keqpërdorimit të fondeve të mundshme.

Mundësia për të depozituar ankesat e qytetarëve lidhur me vështirësitë dhe problemet që ata hasin çdo ditë në njësitë e pushteti lokal, ndikon drejtpërdrejt në rritjen e llogaridhënies dhe formalizimit të procesit të trajtimit të ankesave të qytetarëve.

6 produktet e parashikuara nga PV synojnë rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, duke vendosur kështu hallkën bazë të minimizimit të korrupsionit.

---

<sup>18</sup>VKM nr.506, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë” pika 4.

#### **1.4.6 Feedback-u i subjektit**

##### **Faza studimore:**

Institucionet kanë shprehur gatishmërinë për t'iu përgjigjur në kohë takimit prezantues dhe atyre konsultuese e sqaruese, si dhe plotësimin e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar. Përcjellja e informacionit të kërkuar, kryesisht lidhur me dokumentacionin për veprimtarinë 2015-2017 të zbatimit të Strategjisë kundër korrupsionit 2015-2020 dhe PV 2015-2017 ka hasur në vështirësi, pasi fondi arkivor i veprimtarisë shtetërore kundër korrupsionit është administruar deri në shtator 2017 nga ish-Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore.

Drejtuesit e MD kanë shfaqur interes dhe janë treguar bashkëpunues për rezultatet e auditimit të performancës së zbatimit të SNKK dhe të PV.

##### **Faza e terrenit:**

Institucionet përgjithësisht kanë shfaqur gatishmërinë për bashkëpunim me grupin e auditimit, si më poshtë:

**Ministria e Drejtësisë** - Pavarësisht këmbënguljes (rikujtim nëpërmjet *email*-eve dhe takimeve) për muaj me radhë nga grupi i auditimit të KLSH (G.A), MD nuk ka sjellë një përgjigje zyrtare lidhur me pyetjet dhe kërkesat që grupit i auditimit i ka drejtuar ministrisë në formë shkresore.

Me qëllim ardhjen në ndihmë MD-së në gjenerimin e përgjigjeve për pyetjet dhe kërkesat e bëra, G.A propozoi organizimin e një takimi të përbashkët midis Zv/Ministres në rolin e KKK-së, stafit të MD-së, përgjegjës për antikorrupsionin dhe grupit të auditimit. Edhe pas organizimit të këtij takimi, nuk pati një përgjigje zyrtare nga ana e MD-së, duke rezultuar në mosrealizim të përcjelljes së informacionit zyrtar të kërkuar.

Komunikimi me znj. Zv/Ministre dhe stafin e saj ka qenë korrekt, por mungojnë qëndrimet zyrtare nga ana e institucionit mbi pyetjet dhe kërkesat e bëra nga G.A gjatë kësaj faze.

Ndërsa, lidhur me organizimin e takimit për informim në fazën e terrenit, të kërkuar nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës<sup>19</sup> dhe G.A, Sekretari i Përgjithshëm nuk mundi të gjejë kohë për të qenë prezent, duke rezultuar në mosrealizim të këtij takimi dhe rrjedhimisht mospërcjellje të informacionit të kërkuar.

**Prefekturat** - Prefekturat e përfshira në auditim, ajo e Tiranës, Shkodrës dhe e Fierit, kthyen përgjigjet e tyre zyrtare shkresore lidhur me informacionet fillestare të kërkuara nga G.A. Materiali i marrë nga prefekturat ishte i përgjithshëm, jospecifik, dhe shpesh nuk i kthente përgjigje pyetjeve të drejtuara nga G.A. Për informacion më të detajuar dhe më specifik, G.A i drejtoi prefekturave të Shkodrës dhe Fierit pyetje të tjera nëpërmjet e-mailit zyrtar. Lidhur me këto pyetje, nuk pati asnjë reagim nga ana e tyre.

**AMSHC (Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile)** - Subjekt jo nën auditim, por i përfshirë si palë interes, ka treguar gatishmëri për t'i përcjellë grupit të auditimit informacionet e kërkuara nga ky i fundit, brenda afateve të përcaktuara.

---

<sup>19</sup> Email zyrtar dërguar asistentes së Sekretarit të Përgjithshëm, Ministria e Drejtësisë, nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës, KLSH, datë 25 Prill 2018 ora 10:15 AM

## 2. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT

Auditimi i efektivitetit të SNKK paraqitet si një auditim kompleks sa i përket numrit të institucioneve që janë përfshirë në implementimin e kësaj strategjie, por edhe rolit që secili nga këto subjekte ka. Në varësi të dokumentacionit të grumbulluar dhe të analizuar, të dhënave të kërkuara dhe të plotësuara nga subjekti i audituar, komunikimeve me stafin, gjatë fazës studimore dhe fazës së terrenit, janë aplikuar qasje audituese të ndryshme, në varësi të çështjeve të përzgjedhura për t'u shqyrtuar. Për realizimin e objektivave të auditimit është grumbulluar dokumentacioni i nevojshëm si nga pikëpamja cilësore, ashtu edhe sasiore.

Bazuar sa më sipër, tre ishin qasjet audituese që u përdorën dhe u alternuan në varësi të dokumentacionit të mbledhur, selektuar dhe analizuar.

- **Qasja sasiore** e cila u përdor për të dhënat sasiore primare dhe sekondare, të cilat na dërguan drejt konkluzioneve me besueshmëri statistikore. Analizat u realizuan nëpërmjet pyetësorëve me pyetje të mbyllura, duke u analizuar dhe krahasuar me kritere dhe standarde të pararendosura.
- **Qasja cilësore** u përdor për atë pjesë të materialeve ku treguesit janë të pamatshëm. Për këtë qasje janë përdorur pyetësorë me pyetje të hapura.
- Përveç dy qasjeve të mësipërme, për shkak të kompleksitetit të auditimit, është përdorur dhe **qasja pragmatike**. Kjo lloj qasjeje është një miks midis dy qasjeve të mësipërme, por është edhe qasja më e përshtatshme për auditimet e performancës, sepse përdor larmishmëri metodash dhe tipe të dhënash.

### 2.1 Objektivi dhe problemi i performancës

Gjatë kryerjes së këtij auditimi të performancës është analizuar shkalla e realizimit të objektivave të planifikuara, pra rezultatet e matura kundrejt synimeve dhe atje ku është e mundur edhe burimet e shpenzuara për të arritur këto objektiva.

Kjo do të thotë se një vend të rëndësishëm dhe kryesor në auditimin e zbatimit të Strategjisë antikorrupsion ka zënë **efektiviteti**. Kështu, hartimi i Strategjisë i strukturuar në tre qasje: parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuese, me objektivat dhe synimet e veçanta brenda tyre, i mundëson grupit të auditimit shqyrtimin dhe analizimin e nivelit të realizimit, me ndikim në efektivitetin e zbatimit të saj në jetën ekonomike e sociale të qytetarëve shqiptarë.

Strategjia kundër korrupsionit ka të përcaktuar dhe burimet financiare për produktet e Planit të Veprimit tre-vjeçar 2015-2017 në zbatim të saj, pra kostot e zbatimit të masave konkrete të paraqitura nga secila ministri apo institucion përgjegjës për realizimin e tyre. Mbi këtë bazë, grupi i auditimit të KLSH ka kryer një analizë vlerësuese të performancës së këtyre shpenzimeve, nëpërmjet **eficiencës**: minimizimit të input-eve (burimeve: financiare, njerëzore dhe/ose materiale), kur rezultatet janë të fiksuara, ose maksimizimin e rezultateve, kur input-et janë fikse.

Ashtu siç përcakton dhe vetë Strategjia, ajo bazohet në parimin e koordinimit midis institucioneve me qëllim arritjen e objektivave që përfshihen në SKZHI duke zbatuar një qasje sistematike dhe të integruar.

#### 2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit të performancës

Në vitet e fundit, shumë studime kanë paraqitur efekte të kosto ekonomike dhe sociale të korrupsionit si: pengesa në investime (vendase dhe të huaja), frenimin dhe

zvogëlimin e rritjes ekonomike, kufizimin e tregtisë, deformimin e madhësisë dhe përbërjes së shpenzimeve qeveritare, dobësimin e sistemeve financiare dhe zgjerimin e ekonomisë së fshehtë. Sipas studimeve, por tashmë e provuar me realitetin shqiptar të një tranzicioni të gjatë dhe të vështirë, rezulton se ka një lidhje të fortë mes korrupsionit dhe rritjes së nivelit të varfërisë e pabarazisë së të ardhurave tek qytetarët. Gjithashtu, shtrembërimet fiskale të shkaktuara nga korrupsioni ulin cilësinë e shërbimeve qeveritare deri në përjashtim, veçanërisht me pasoja të rënda për shtresat e marginalizuara, të varfra, etj.

**Në këtë mënyrë, auditimi është fokusuar në qasjen parandaluese të korrupsionit sipas Strategjisë dhe PV, në objektivin A11 “Artikuli dhe adoptimi i politikave antikorrupsion në nivelin e qeverisjes vendore” përfshirë të gjitha nënobjektivat dhe synimet e tij duke marrë një rast studimor në nivel sektorial brenda tyre.** Kjo pasi, siç përcakton dhe vetë Strategjia, ajo bazohet në parimin e koordinimit midis institucioneve me qëllim arritjen e objektivave që përfshihen në SKZHI duke zbatuar një qasje sistematike dhe të integruar.

Problemi i performancës është zhvillimi i luftës kundër korrupsionit nëpërmjet zbatimit të plotë të Strategjisë dhe PV, për të shmangur koston ekonomike dhe për të rritur cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve, në funksion të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

### **2.1.2 Objektivi i auditimit**

*“Korrupsioni në Shqipëri është endemik, veçanërisht në gjyqësor. Po ashtu, respektimi i pronës private mbetet në nivele të ulëta. Zbatimi i reformës së sistemit gjyqësor ka filluar kohët e fundit, por klima e investimeve mbetet problematike dhe Shqipëria perceptohet si një vend i vështirë për të bërë biznes. Të drejtat e pronës mbeten një tjetër sfidë në Shqipëri, pasi titulli i pronësisë është vështirë të merret. Ka aktorë të paskrupullt që manipulojnë sistemin e korrumpuar të gjykatave për të marrë titullin e pronësisë në tokë jo të tyre”<sup>20</sup>.*

Synimi i këtij auditimi ka qenë të verifikojë nëse ekziston një kornizë institucionale efektive në nivel kombëtar për parandalimin e korrupsionit në Shqipëri e cila do të bënte të mundur realizimin e objektivit 16.5<sup>21</sup> të Agjendës 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

Auditimi u përqendrua në masat e ndërmarra nga qeveria në tërësi, MD dhe institucionet e varësisë së saj, për vitet financiare 2015/2016 dhe 2016/2017. Auditimi ka vlerësuar rolin e agjencive përkatëse në parandalimin e korrupsionit dhe lehtësimin e aksesit të publikut në marrjen e shërbime publike efektive.

Gjithashtu, janë shqyrtuar mekanizmat e zbatimit të kuadrit ligjor, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për Strategjinë dhe PV, si dhe burimet financiare të alokuara për funksionimin efektiv të këtyre subjekteve.

**Objektivi i auditimit është efektiviteti dhe eficiensa e objektivit A11 të Strategjisë: “Artikuli dhe adoptimi i politikave antikorrupsion në nivelin e qeverisjes vendore”<sup>22</sup>, analizuar në thellësi dhe gjerësi, pjesë e qasjes parandaluese.**

---

<sup>20</sup> Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për vitin 2017

<sup>21</sup>Objektivi 16.5 Të zvogëlohet ndjeshëm korrupsioni dhe ryshfeti në të gjitha format e tyre.

<sup>22</sup> Sikurse parashikon objektivi A.11, PV 2015-2017

## 2.2 Përkufizimet dhe terminologjia

- **Auditim:** Proces i domosdoshëm i një sistemi rregullator, i cili ka për qëllim të zbulojë devijimet nga standardet e pranuar dhe shkeljet e parimeve të ligjshmërisë, eficiencës, efektivitetit, ekonomikitetit dhe të menaxhimit financiar;
- **Strategji:** Strategji është një dokument i cili përcakton objektivat afatmesme të politikave të një fushe të caktuar dhe në përgjithësi përfshin qëllimet, veprimet për arritjen e qëllimeve dhe mobilizimin e burimeve për ekzekutimin e veprimeve;
- **Korrupsion:** është një formë e sjelljes së pandershme ose jo etike nga një person i ngarkuar me një detyrë shtetërore, shpesh për të siguruar përfitime personale, përfshirë ryshfetin dhe përvetësimin edhe brenda praktikave që janë ligjore.
- Korrupsioni merr shumë forma, por gjithmonë përfshin abuzimin me postin e besuar për përfitime private.<sup>23</sup>
- **Plan veprimi:** është një plan i detajuar që përshkruan veprimet e nevojshme për të arritur një ose më shumë qëllime, disa aktivitete që duhet të kryhen mirë për një strategji të suksesshme;
- **Risk:** Mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar, e cila do të ndikonte negativisht në arritjen e objektivave të një njësie organizative apo të shoqërisë në tërësi;
- **Monitorim:** është një proces që ndihmon në përmirësimin e performancës dhe arritjen e rezultateve, i cili synon të përmirësojë menaxhimin aktual dhe të ardhshëm të rezultateve dhe impaktit, duke vendosur lidhje midis veprimeve të kaluara, të tanishme dhe të ardhshme;
- **Inspektim** është vlerësimi kritik, i cili përfshin shqyrtimin, matjen, testimin, standardin dhe krahasimin e materialeve ose çështjeve, duke përcaktuar nëse materiali ose çështja është në sasinë dhe kushtet e duhura, si dhe nëse ajo përputhet me kërkesat e zbatueshme ose të specifikuara;
- **Kontrolli** është tërësia e instrumenteve të krijuara për t'u siguruar që veprimtaria e subjektit është në përputhje me rregullat dhe kërkesat e jashtme dhe të brendshme, rregulloret, direktivat e drejtimit etj.

## 2.3 Burimet e Kriereve

Për shkak të fokusit dhe qasjes pragmatike të auditimit, Grupi ka përdorur kriteret e kategorizuara si më poshtë:

### 2.3.1 Kriteret e politikës

- Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 dhe Plani i Veprimit
- Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015 – 2020;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020;
- Programi Qeverisës 2017-2021;

### 2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit

- Raportim për Planin e Veprimit për 5 Prioritetet e Komisionit Evropian;
- Raport Vjetor, Viti 2017 mbi Monitorimin dhe Zbatimin e “Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020”

---

<sup>23</sup> <https://www.transparency.org/>

- Raport Vjetor, Viti 2016 mbi Monitorimin dhe Zbatimin e “Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020”, Mars 2016;
- Raporti Vjetor i Monitorimit, Viti 2015 “Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015 – 2020”;
- Raport Monitorimi Nr. 2 Periudha: Janar-Qershor 2016 “Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020”;
- Raport Monitorimi Nr. 3 Periudha: Korrik-Dhjetor 2016;

### **2.3.3 Kriteret teknike dhe akademike**

- Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe “Norma Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligj nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Ministrisë së Drejtësisë”;
- Urdhër i Kryeministrit, nr. 129 datë 21.09.2015 “Për Marrjen e Masave Institucionale dhe Operacionale për Zbatimin e Qasjes Sektoriale dhe Krijimin e Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave”
- Urdhër i Kryeministrit, nr. 93 datë 07.08.2012 “Për Përgatitjen e Strategjisë Sektoriale dhe Ndërsektoriale Kombëtare për Periudhën 2013-2020, si dhe Dokumenteve Strategjike Sektoriale 2013-2020, në Kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2013-2020”;
- Urdhër i Kryeministrit, nr. 139 datë 01.07.2010 “Për Zbatimin e Procesit të Monitorimit të Strategjive Sektoriale e Ndërsektoriale”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 241, datë 20.4.2018 “Për Miratimin e Planit të Veprimit 2018-2020, në Zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2020, e të Pasaportës së Indikatorëve, Krijimin, Funksonimin dhe Detyrat e Komitetit Koordinator për Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2020, dhe Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 506, datë 13.9.2017 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 247, datë 20.3.2015 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1012, datë 22.11.2013 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore”;
- Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 2237 datë 20.02.2018 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë dhe Detyrave të zëvendësministrave të Drejtësisë”
- Udhëzim i Ministrit për Çështjet Vendore “Udhëzime në lidhje me përgatitjen e Plan Veprimit kundër Korrupsionit 2014-2017”
- Rregullore e Brendshme “Për Organizimin dhe Funksonimin e Ministrisë së Drejtësisë” Miratuar me Urdhrin nr. 5745, datë 13/08/2008, të ndryshuar
- Korrespondencë nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore nr. Prot. 3037, datë 25.06.2015 Drejtuar Delegacionit të BE “Për Mbështetjen për Formulimin, Koordinimin dhe Zbatimin e Politikave Antikorrupsion”;
- Korrespondencë nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore nr. Prot. 342 datë 22.01.2015 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm në Kryeministri për “Treguesit e Sugjeruar për Monitorimi e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim”;


### **2.3.4 Kritere të tjera/Praktika të mira**

- Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA II) Indicative Strategy Paper for Albania (2014-2020);
- European Commission, Brussels, 9.11.2016 Sëd Final Commission Staff Working Document, Albania 2016 Report;
- European Commission, Brussels, 10.11.2015 Sëd(2015) 213 Final Commission Staff Working Document, Albania 2015 Report;
- SIGMA, 2017, Albania “The Principles of Public Administration”;
- SIGMA, 2016, Albania “The Principles of Public Administration”;
- SIGMA, 2015, Albania “The Principles of Public Administration”;
- IRM and Transparency International UK “Bribery Risk Guide” 2016;
- NAVEX Global “ Anti-Bribery and Corruption Risk Assessment Checklist” 2016;
- United Nations Mission in Sudan (UNMIS) “Role of Audit in Fighting Corruption” 2016;
- The Institute of Internal Auditors “Auditing Anti-Bribery and Anti-Corruption Programs” June, 2014;
- United Nations Global Compact Office “Guide for Anti-Corruption Risk Assessment” 2013;
- UNDP “A Users’ Guide to Measuring Local Governance” Oslo Governance Centre;
- U4 BRIEF “The Proxy Challenge: Ehy bespoke Proxy indicators can help solve the anti-corruption measurement problem” 2013;
- Keneth M. Dye “Corruption and Fraud Detection by Supreme Audit Institutions”;
- The Institute of Internal Auditors “Role of Audit in Fighting Corruption”;
- The Institute of Internal Auditors “Audit of Institutional Framework for Fighting Corruption”;
- World Bank Institute “Reducing Corruption at the Local Level”, October 2000;

### **2.4 Piramida e pyetjeve audituese**

*Pyetja kryesore: A ka rezultuar efektiv adoptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore për zbatimin e objektivit A.11 të SNKK?*

### **Skema 2: Piramida e pyetjeve të auditimit**



### Nënpyetjet e nivelit të parë:


- 1.1 A janë SMART nënobjektivat e strategjisë dhe aktivitetet e PV në objektivin e adoptimit të politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore?
- 1.2 Si janë zbatuar nënobjektivat e strategjisë dhe aktivitetet e PV për adoptimin e politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore?
- 1.3 Cili është perceptimi i opinionit publik dhe palëve të tjera për politikën e ndërmarra kundër korrupsionit në qeverisjen vendore?

### Nënpyetjet e nivelit të dytë:

- 1.1.1 A është aplikuar metodologjia e duhur për të integruar arritjet e nënobjektivave me atë të objektivit madhor ku ato bëjnë pjesë?
- 1.2.1 A ka ndikuar angazhimi i Prefekturave në adoptimin e politikave kundër korrupsionit në nivel vendor?
- 1.2.2 A janë efektive mekanizmat e Monitorimit dhe të Vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal?
- 1.2.3 A realizohet ofrimi i shërbimeve administrative përmes sporteveleve unike në nivel vendor?
- 1.3.1 Si është perceptimi i opinionit publik mbi adoptimin e politikave kundër korrupsionit nga zyrtarët vendorë?
- 1.3.2 Cili është opinionimi i shoqërisë civile mbi korrupsionin në qeverisjen vendore?

## 2.4 Skema e Auditimit

### Skema 3: Procesi strategjik antikorrupsion në terma të 3E-ve



Burimi: Prezantimi i skemës në workshop-in e IDI-t, Lusaka, Zambia, në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar për këtë auditim, Grupi i Auditimit, KLSH

### 2.5.1 Qasja/metodologjia e auditimit

Sikurse është cilësuar edhe më herët, për t'iu përgjigjur pyetjes kryesore nëpërmjet nënpyetjeve të dy niveleve të tjera, është përdorur qasja pragmatike, e cila përfshin qasjen sasiore edhe atë cilësore. Kjo qasje u përzgjedh nga grupi i auditimit në varësi të të dhënave dhe dokumentacionit të grumbulluar dhe është përdorur gjatë shtjellimit të tyre. Zbatimi i qasjes pragmatike ka siguruar një trajtim shterues të performancës së SNKK në funksion të luftës kundër korrupsionit, një problem ky me karakter social dhe ekonomik, e gjithashtu një temë me interes të lartë publik.

Paradigma kryesore e këtij auditimi është: "Implementimi i SNKK dhe i Planit të Veprimit mund të realizohet me efektivitet vetëm nëse përcaktimi i objektivave madhore dhe i produkteve finale të këtyre dokumenteve strategjike, është i qartë, i matshëm, i realizueshëm, me lidhje të drejtpërdrejtë me synimin madhor të tyre dhe me afate të përcaktuara kohore."

Auditimi i zbatimit të SNKK si strategji për të luftuar korrupsionin për periudhën 2015-2017, fokusuar në qasjen parandaluese, ka evidentuar prirjet në realizimin e objektivit A.11 dhe nënobjektivave të tij. Ky evidentim, së bashku me analizimin e veprimeve të ndërmarra nga nj.q.v. për të mbështetur realizimin e objektivit në fjalë, kanë bërë të mundur arritjen e konkluzioneve të sakta e objektive, si dhe ofrimin e rekomandimeve të duhura nga grupi i auditimit

### 2.5.2 Metodatat/teknikat audituese (Pragmatike/ qasja)

Janë përdorur këto metoda:

- Analiza dhe krahasimi i rezultateve të monitorimit me objektivat e vendosura në Strategji dhe në PV;
- Analizë sasiore dhe cilësore e informacionit të ofruar nga MD dhe më gjerë;
- Intervista me stafin e angazhuar me programin dhe projektin antikorrupsion;
- Analiza të procedurave të raportimit të institucioneve të përfshira në zbatimin e SNKK;
- Intervista me denoncues të rasteve të korrupsionit dhe stafit të angazhuar në luftën kundër korrupsionit;

- Rishikim dhe vlerësim i të dhënave statistikore dhe dokumentacionit të grumbulluar gjatë fazës studimore dhe asaj të terrenit;
- Analizë sasiore dhe cilësore e veprimtarisë së drejtuesve dhe specialistëve në përmbushje të detyrave kundër korrupsionit;
- Zbatimi i metodave dhe teknikave të përdorura në auditime të ngjashme të kryera nga vendet e tjera.

## **2.6 Rezultatet e parashikuara**

Auditimi i performancës së SNKK, duke u fokusuar në efektivitetin e zbatimit të saj dhe PV 2015-2017, ka kryer një shqyrtim të detajuar të objektivit A.11 dhe nënobjektivave të tij, të përcaktuara në PV sipas afatit dhe palëve përgjegjëse, duke u kujdesur dhe për cilësinë e plotësimit të tyre, të produkteve të PV, si dhe të mbulimit të tyre me kostot financiare eventuale.

Në mënyrë të veçantë është shqyrtuar roli dhe efektiviteti i MD në cilësinë e KKK dhe adoptimi i politikave antikorrupsion në nivelin e qeverisjes vendore, fokusuar në tre prefektura dhe bashki.

Të dhënat e monitorimit, dokumente të tjera, intervistat, pyetësorët, vizitat në terren etj., për zbatimin e strategjisë, të shqyrtuara dhe të analizuara për një periudhë 3-vjeçare (2015-2017), parashikohen të kenë impakt social kryesisht në popullsinë e marginalizuar.

Paraqitja e problematikave të konstatuara në zbatimin e Strategjisë dhe PV, do të mundësojë që jo vetëm të përmirësohet veprimtaria e MD në koordinimin e zbatimit në tërësi, por edhe zhvillimi ekonomik dhe social i vendit nga efektiviteti i luftës kundër korrupsionit. Nëpërmjet këtij auditimi është bërë transparente veprimtaria e institucioneve publike në drejtim të luftës kundër korrupsionit, gjë e cila synon të rrisë përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien përballë opinionit të gjerë publik.

### **2.6.1 Impakti për Kuvendin dhe Qeverinë**

Rezultatet e këtij auditimi të performancës do të kenë impakt për Kuvendin, pasi do t'i krijojnë mundësinë të njihet në mënyrë të detajuar dhe të veçantë me problematikën që ka shoqëruar performancën dhe efektivitetin në implementimin e SNKK dhe arritjen e objektivave të përcaktuara në këtë strategji të cilat kanë ndikim të madh në jetën ekonomike dhe sociale të shqiptarëve.

Raporti përfundimtar, i cili pasqyron gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet, do të ndikojë për Qeverinë, duke nxitur përmirësimin e kuadrit të nevojshëm rregullator, si dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet aktorëve dhe faktorëve përgjegjës në varësi të saj për implementimin më të mirë të strategjisë dhe arritjen e objektivave të përcaktuara.

### **2.6.2 Impakti për publikun dhe palët e interesit**

Nga auditimi i efektivitetit të zbatimit të SNKK dhe të PV, janë bërë përpjekje që jo vetëm të bëhet transparente veprimtaria shtetërore në këtë drejtim, por nëpërmjet vlerësimit të ecurisë së zbatimit, të arrihet ndikimi në rritjen e përgjegjshmërisë së institucioneve dhe nëpunësve publikë të angazhuar në këtë proces, përballë taksapaguesve dhe opinionit publik.

Veç kësaj, duke evidentuar problematikën dhe mangësitë, shoqëruar me zbatimin e SNKK 2015-2020 dhe të PV 2015-2017 në periudhën 2015-2017, do të ndikohet në

përmirësimin e veprimtarisë së qeverisë në luftën kundër korrupsionit, nëpërmjet rekomandimeve përkatëse.

### **2.6.3 Forma e publikimit**

Raporti Përfundimtar i Auditimit, do u dërgohet subjekteve nën auditim, si dhe një kopje do i përcillet zyrtarisht Kryeministrit.

Një përmbledhje e Raportit Përfundimtar të Auditimit do të publikohet në website-in e KLSH-së dhe rrjetet sociale të Departamentit të Auditimit të Performancës. Raporti Përfundimtar i Auditimit është pjesë dhe e Raportit të veprimtarisë vjetore të KLSH-së. Gjithashtu, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet do të jenë pjesë e ëorkshop-eve periodike të Departamentit të Performancës dhe KLSH-së, si dhe vendeve të tjera nënshkruese të marrëveshjes së bashkëpunimit IDI.

Pas vendimit nga Kryetari i KLSH-së për këtë auditim dhe dërgimit të Raportit subjekteve të audituara, do të përgatitet një artikull për median e shkruar.

### 3. SHITJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE

“Dokumenti Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit ka për qëllim të përcaktojë objektivat dhe drejtimet kryesore të politikave të cilat do të udhëheqin planin e veprimit të qeverisë për luftën kundër korrupsionit...<sup>24</sup>”. Si një strategji e cila synon të luftojë një fenomen shumëdimensional, edhe efektet e saj duhet të analizohen në shumë drejtime dhe duke përfshirë shumë palë interesi.

Përveç evidencave fizike, elektronike, intervistave dhe komunikimeve të shumta me stafin e subjekteve të përfshira në auditim, grupi i auditimit ka kryer takime dhe ka gjeneruar dëshmi nga:


1. Shoqëria civile, duke takuar organizata të ndryshme jo qeveritare me fokus në luftën antikorrupsion (IDM dhe IDRA)
2. Ish-stafi i Ministrisë së Shtetit për Çështjet Vendore
3. Stafin e Njesisë së Politikave për Zhvillim dhe Mirëqeverisje, pranë Kryeministrisë
4. Agjencinë për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile
5. Ish-ekspertë të përfshirë në hartimin e strategjisë së mëparshme anti korrupsion dhe në ofrimin e konsulencës.

**Skema 4: Grupet e interesit të konsultuara gjatë auditimit**



Punoi: Grupi i auditimit të KLSH

**Skema 5: Procesi në të cilin është audituar SNKK dhe PV 2015-2020**



Punoi: Grupi i auditimit të KLSH

<sup>24</sup>Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2020 - Hyrje

Prandaj gjetjet e evidentuara janë një kryqëzim i evidencave fizike, elektronike, komunikimeve të dokumentuara, intervistave dhe pyetësorëve të gjeneruar nga puna audituese.

Në përfundim të auditimit, pasi grupi i dha përgjigje pyetjeve dhe nënpyetjeve të auditimit, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucionet e përfshira në këtë auditim, pasi KLSH përcolli projekt-raportin auditues në subjektet përkatëse dhe reflektoi me komentet e observacionet e tyre, u arrit në këtë mesazh auditimi:

---

*SNKK dhe PV janë krijuar për të qenë në linjë me një nga 5 rekomandimet e BE-së dhe rezultati final i tyre duhet të reduktonte ndjeshëm korrupsionin në vend me anë të përfshirjes së të gjitha palëve të interesit. Pavarësisht këtij synimi, SNKK dhe rrjedhimisht PV që e detajon atë vuajnë planifikimin e dobët të objektivave të saj, specifikisht të objektivit A11 audituar nga KLSH. Ky planifikim i dobët shprehet në formulimin e nënobjektivave jo-SMART, moskonsultimin apo konsultimin fiktiv të palëve të interesit në hartimin e këtyre dokumenteve, mungesën e metodologjisë që përkthen objektivat operacionale në strategjike, mungesën e koherencës midis PV dhe SNKK, si edhe miratimit të kësaj Strategjie me akt nënligjor (VKM), ndërkohë që ajo parashtron detyra edhe për institucionet e pavarura nga ekzekutivi.*

*Në drejtim të implementimit, Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit (Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore për periudhën mars 2015- shtator 2017 dhe Ministria e Drejtësisë për periudhën shtator - qershor 2018) me rol kyç në hartimin, implementimin dhe monitorimin e SNKK dhe Planit të Veprimit, nuk kanë zotëruar asnjë hallkë të detyrave dhe përgjegjësi të veta, duke rezultuar në një Strategji të pazbatuar, pamonitoruar dhe rrjedhimisht të paraportuar për arritjet dhe mosarritjet. Në vijim, vlerësojmë përpjekjet e Ministrisë së Drejtësisë në luftën kundër korrupsionin, nëpërmjet veprimtarisë së Task Forcës, përgjatë 3-mujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2018.*

*Prefekturat, si një nga palët kryesore në zbatimin e Strategjisë janë joaktive si në afatet, ashtu edhe cilësinë e raportimit dhe rezultojnë të mos kenë realizuar produktet finale të parashikuara.*

*Nga ana tjetër, edhe pse shoqërisë civile i janë lëvruar fonde nga buxheti i shtetit lidhur me çështjen antikorrupsion dhe specifikisht këtë Strategji, roli i saj pothuajse nuk ekziston. Ajo rezulton të mos jetë e përfshirë në procesin e hartimit të SNKK dhe atë të luftimit të këtij fenomeni dhe për rrjedhojë nuk ka kontribuar si vlerë e shtuar e kësaj Strategjie.*

*Duke e konsideruar të dështuar në masën më të madhe objektivin A.11 dhe përgjithësisht Strategjinë Antikorrupsion dhe Planin e Veprimit për ta vënë në jetë atë, si edhe për të siguruar implementimin e një nisme kaq jetike për vendin e për të eliminuar në vijimësi riskun e transferimit të KKK nga njëri institucion në tjetrin, KLSH rekomandon krijimin e një Agjencie Kombëtare Antikorrupsion. Kjo agjenci sugjerohet të jetë nën varësinë e Kryeministrit dhe përgjegjëse për rihartimin, rizbatimin dhe monitorimin e mëtejshëm të SNKK dhe PV, duke marrë fillimisht dakordësinë e Kuvendit për dokumentet strategjike në formën e një Ligji të posaçëm. Gjithashtu, për përfshirjen e institucioneve jashtë-qeveritare në këtë Strategji, sinergjizimin e përpjekjeve antikorrupsion nga qeveria dhe institucionet kushtetuese, shoqëria civile, donatorët e huaj dhe aktorë të tjerë publikë, Kuvendi mund të përfshijë në Ligjin e miratuar për këtë Strategji, një aneks mbi raportet*

*dhe rolin e këtyre aktorëve në Strategjinë Antikorrupsion dhe konkretisht me Agjencinë Kombëtare Antikorrupsion. Marrëdhëniet dhe roli i aktorëve jashtë-qeveritarë, sugjerohet të fokusohen në rakordimin e strategjive individuale të këtyre aktorëve me Strategjinë Antikorrupsion të qeverisë.*

---

### **3.1 A është SMART objektivi A.11 dhe nënobjektivat përkatës?**

Më poshtë në formë skematike prezantohen tërësia e hallkave kërkimore nëpër të cilat është kaluar për t'iu përgjigjur pyetjes audituese **nëse është SMART objektivi A11 dhe nënobjektivat përkatës**. Nëse kuptojmë se si është hartuar Strategjia dhe Plani i Veprimit, si është implementuar dhe si bëhet monitorimi i zbatimit të këtyre dy dokumenteve strategjike, do të konkludojmë nëse Plani i Veprimit është vërtet një zbërthim analitik i Strategjisë dhe se specifikisht objektivi madhor A 11 "Adoptimi i Politikave kundër Korrupsionit në Nivelin e Qeverisjes Vendore" është një objektiv specifik (**Specific**), i matshëm (**Measurable**), i arritshëm (**Achievable/ Aligned**), të ketë lidhje me qëllimin e vetë strategjisë (**Relevant**) dhe realist në lidhje me afatet kohore (**Time - Bound**).

#### **3.1.1 A është aplikuar metodologjia e duhur që integron arritjen e nënobjektivave me atë të objektivit madhor të Strategjisë ku bën pjesë?**

##### **1. Hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit**

- **Zbërthimi i objektivave madhore të Strategjisë në ato specifike sipas Planit të Veprimit 2015-2020**

##### **Gjetje:**

1. Me kalimin e kompetencave të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit nga MShÇV tek MD nëpërmjet VKM nr. 506 datë 13.09.2017<sup>25</sup> e deri në datën 08.01.2018<sup>26</sup>, MD nuk kishte në dispozicion ende arkivin e plotë shkresor për të gjithë aktivitetin e kryer nga Koordinatorin i mëparshëm kundër Korrupsionit prej datës 22.11.2013 e deri në 13.09.2017.

Vlen të përmenden katër momente kyçe që kanë të bëjnë me mungesën e arkivës së aktivitetit të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit pranë Ministrisë së Drejtësisë.

- Momenti i parë është se në fillim të muajit Janar, kur grupi i auditimit kërkon evidenca<sup>27</sup> mbi aktivitetin e KKK përgjatë 2015-2017, MD nuk dispononte asnjë dokument mbi aktivitetin e KKK të mëparshëm. MD në rolin e KKK, kishte filluar aktivitetin e vet pa asnjë historik të mëparshëm mbi të cilin të vijonte puna pa asnjë ndërprerje. Në datë 08.01.2018, Ministria e Drejtësisë në reflektim të kërkesës së grupit të auditimit të KLSH-së, jo me iniciativën e saj, kërkon pranë institucionit të Kryeministrisë mundësimin e transferimit të fondit arkivor nëpërmjet shkresës me nr. prot. 131.
- Momenti i dytë i rëndësishëm është se Arkiva e MSHÇV, e cila erdhi në Ministrinë e Drejtësisë vetëm nëpërmjet këmbënguljes për të disatën herë të

---

<sup>25</sup> VKM Nr. 506 datë 13.09.2017 "Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë", pika 4

<sup>26</sup> Grupi i auditimit i kërkon Ministrisë së Drejtësisë dokumentacion lidhur me aktivitetin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2017 nëpërmjet shkresës datë 04.01.2018

<sup>27</sup> Nëpërmjet shkresës me datë 04.01.2018

grupit të auditimit, nuk përmbante asnjë dokument shkresor të rëndësishëm dhe relevant mbi Strategjinë Antikorrupsion dhe Planin e Veprimit për periudhën objekt auditimi. Materialet që përmbanin këto tre dosje ishin mjaft të ç'rregullta, jo në bazë të ndonjë kronologjie kohore apo aktiviteti, dhe të shkartisura brenda shkresave të ndryshme. Shumica e materialeve përbëheshin nga memo të ndryshme pa datë, informacione pa letër formale, dokumente pa numër protokoll, etj., ku të gjitha këto përmbanin vetëm vulën e institucionit të Kryeministrit.

- Së treti, materiali i ardhur në zyrën e grupit të auditimit nuk kaloi në procedurat e cilësuar në “Norma Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, duke mos u bërë hyrje në arkivën e institucionit.

Arkiva e sjellë nga Kryeministria nuk u konsultua dhe filtrua nga Ministria e Drejtësisë për të gjeneruar përgjigjet e pyetjeve për të cilat interesohet grupi i auditimit. Në vend të përgjigjeve zyrtare që Ministria e Drejtësisë duhet të përcillte pranë grupit të auditimit sipas shkresës 3312, datë 20.03.2018, MD i la akses grupit të konsultonte vetë arkivën, duke hequr dorë nga përgjegjësia për të marrë një pozicion zyrtar lidhur me të.

Me kërkesë të grupit të auditimit, bërë disa herë në takime zyrtare me Sekretarin e Përgjithshëm dhe Zv. Ministrin në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, seti i dokumentacionit u tërhoq nga Përgjegjësi i Sektorit të Programeve në Fushën e Drejtësisë dhe Antikorrupsionit, nga zyra e grupit të auditimit të vendosur pranë MD.

- Së fundmi, Ministria e Drejtësisë nuk është ende në gjendje të konfirmojë zyrtarisht se tërësia e materialeve shkresore të Ministrisë së Shtetit për Çështjet Vendore lidhur me aktivitetin e vet mbi antikorrupsionin konsiston vetëm në këto tre dosje që institucioni i Kryeministrit lëvroi pranë Ministrisë në fjalë. Me gjithë kërkesat e bëra nga grupi i auditimit, për të patur një konfirmim zyrtar, Ministria e Drejtësisë nuk është në dijeni nëse ka mbetur ende dokumentacion shkresor në arkivën e Kryeministrit që duhet të lëvrohet pranë ambienteve të saj për të vijuar punën pa ceduar në cilësi në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit.

2. Për një periudhë 5-mujore<sup>28</sup>, Ministria e Drejtësisë nuk ka emëruar Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit, që nga momenti kur kjo ministri ngarkohet me këtë rol.

3. Pas konsultimit të arkivës fizike të lëvruar në zyrën e grupit të auditimit, dhe asaj elektronike të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga Ministria e Drejtësisë, dhe pas mungesës së përgjigjeve zyrtare nga ana e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me pyetjet e intervistës<sup>29</sup> së dërguar nga grupi i auditimit, konstatohet se:

- Prefektura e Tiranës nuk është përfshirë në asnjë nga fazat e hartimit të objektivave të SNKK 2015-2020 sikundër pretendohet në metodologjinë e hartimit të SNKK 2015-2020. Nga përgjigjet e intervistës së shkruar, drejtuar

---

<sup>28</sup> Urdhri i Ministrit nr. 2237, datë 20.02.2018

<sup>29</sup> Shkresa nr. 3312 Prot., datë 20.03.2018

Prefekturës së Tiranës, lidhur me pyetjen “Në cilat faza të hartimit të objektivave të SNKK 2015-2020 ka qenë i përfshirë institucioni juaj”, konfirmohet se Prefektura e Tiranës ka qenë pjesëmarrëse vetëm në dy takime, ku ajo e muajit mars 2015 ishte *“për të diskutuar në lidhje me portalin Stop Korrupsionit. Objekt diskutimi ishte mënyra se si trajtohen dhe raportohen denoncimet që vijnë në institucion.”*

- Prefektura e Tiranës konfirmon nëpërmjet përgjigjes së vet zyrtare se institucioni në fjalë është thirrur nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit në mars të vitit 2015 për të diskutuar mbi portalin Stop Korrupsion dhe në 19.07.2016 është ftuar në takimin e dytë të nën-grupit tematik për çështje jo relevante me hartimin e objektivave.
- Ministria e Drejtësisë e ka të pamundur të përgjigjet mbi pyetjet e intervistës së shkruar që grupi i auditimit i ka përcjellë në datë 20.03.2018, duke tejkuluar tërësisht afatet ligjore të kthimit të përgjigjeve cilësuar në Ligjin nr. 154/2014 *“Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, duke u shprehur në takime zyrtare me grupin e auditimit se *“nuk kanë informacion mbi përfshirjen e institucioneve lokale në hartimin e objektivave madhorë të SNKK 2015-2020<sup>30</sup>”*.

4. Pas shqyrtimit të detajuar të evidencës shkresore dhe elektronike të MSHÇV, të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga Ministria e Drejtësisë, përveç rastit të Prefekturës Berat (e cila ka gjeneruar propozimet e veta për mënyrën e zberthimit e objektivit madhor A11 të SNKK 2015-2020 “Adoptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore”) nuk evidentohet në asnjë rast, se ndonjë institucion tjetër i pushtetit lokal të ketë propozuar objektiva specifike në zberthim të mëtejshëm të objektivit madhor A.11 të përcaktuara sipas Planit të Veprimit.

Ndonëse nuk ishte detyrim ligjor, Grupi i Auditimit ka kryer takime me punonjës të ish-Ministrisë së Shtetit për Çështjet Vendore dhe ish-ekspertë të përfshirë në hartimin e strategjisë së mëparshme antikorrupsion, në përpjekje për të marrë informacion. Nga takimet e kryera, rezultoi se nuk ka dokumente të tjerë, jashtë arkivës së lëvruar në MD, të cilët duhet të ishin përfshirë në auditim nga GA. Në këtë mënyrë, grupi i auditimit ofron siguri të arsyeshme, se janë marrë në konsideratë të gjitha burimet e mundshme të informacionit për gjenerimin e gjetjeve, konkluzioneve dhe rezultateve përkatëse.

### **Konkluzione:**

1. Mungesa e kujtesës institucionale dhe e historikut të veprimtarisë së një institucioni nuk mund të sjellë as vijimësi të proceseve ekzistuese dhe as përmirësime që duhet të burojnë nga analizimi i rezultateve të arritura. Në çastet kur Ministri i Drejtësisë merr nën përgjegjësinë e vet një kompetencë të re dhe kaq të rëndësishme, siç është SNKK dhe PV, duhet të sigurohej që bashkë me

---

<sup>30</sup>Takimi i kryer në Ministrinë e Drejtësisë, datë 20.04.2018. Pjesëmarrës në takim: Znj. Teuta Vodo (Zv. Ministre), Znj. Donika Nano (Specialiste), Znj. Brikena Shehu (Specialiste), Z. Mirjon Brahimllari (Përgjegjës Sektor), Z. Rinald Muça (Drejtor i Departamentit të Auditimit të Performancës, KLSH), Znj. Eva Leka dhe Znj. Megi Kurushi (anëtare të grupit të auditimit, KLSH)

kompetencat do të merreshin edhe përgjegjësitë, duke siguruar kështu edhe marrjen e të gjithë arkivës shkresore dhe elektronike nga Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore. Nuk mund të merren vetëm kompetencat për periudhën e ardhshme, pa u informuar lidhur me punën e kryer, etapat në të cilat ka mbetur puna dhe çfarë është bërë realisht nga stafi i mëparshëm.

2. Për një periudhë 5-mujore, Ministria e Drejtësisë nuk ka patur personin apo grupin e personave pranë institucionit të saj, i cili/ të cilët do të merrnin përgjegjësinë dhe detyrat e rolit të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit. Përcaktimi i personit përgjegjës për këtë rol është vetëm fillimi i një punë kaq të rëndësishme siç konsiderohet edhe në dokumentin e SNKK 2015-2020 “Korrupsioni dhe luftimi i tij vijojnë të jenë një nga sfidat kryesore dhe një nga prioritetet madhore ndërsektoriale për Shqipërinë<sup>31</sup>.” Mosngarkimi i një personi për të vijuar punën lidhur me implementimin e strategjisë dhe të Planit të Veprimit kundër korrupsionit, nuk tregon për vëmendje dhe përqendrim të Ministrisë së Drejtësisë në rolin e KKK në luftën kundër korrupsionit.

Sipas SNKK 2015-2020<sup>32</sup>, citohet se “Në kuadër të bashkërendimit, është krijuar institucioni i Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, si institucioni që drejton përpjekjet e qeverisë për zbatimin e masave nën Prioritetin 3<sup>33</sup>.” Që prej daljes së VKM nr. 506<sup>34</sup> datë 13.09.2017, ku cilësohet kjo ministri në rolin e KKK, e deri në daljen e Urdhrit të Ministrit nr. 2237 datë 20.02.2018<sup>35</sup>, nuk ka patur një Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit i cili të vijojë drejtimin e përpjekjeve të qeverisë në përmbushjen e masave lidhur me prioritetin 3 të Bashkimit Evropian “Vendosmërinë në luftën kundër korrupsionit”. Pas 5 muajsh që nga marrja e përgjegjësisë, Ministri i Drejtësisë përcakton njërin nga dy zëvendës ministrat e vet si KKK.

3. Urdhri i Kryeministrit nr. 93<sup>36</sup> datë 07.08.2012, shpreh qartë se “... kjo pjesë hartohet nga secila ministri linje, e cila paraqet objektivat përkatëse ndërsektoriale, me produktet madhore. Ministria udhëheqëse përmbledh kontributet përkatëse, duke i shkrirë në një kapitull të vetëm”

- Sipas dokumentit të SNKK 2015-2020, “Metodologjia bazohet në parimin e koordinimit midis institucioneve me qëllim arritjen e objektivave që përfshihen në SKZHI duke zbatuar një qasje sistematike dhe të integruar...Dokumenti strategjik është hartuar në bazë të eksperiencave dhe nga të gjitha institucionet kombëtare që kanë patur një rol për zbatimin e Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin

---

31 Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020 – Kapitulli I – Kushtet Aktuale – Vështrim i përgjithshëm.

32 Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020, Kapitulli I – Kushtet Aktuale – Vështrim i përgjithshëm, pika 4 “Planifikimi, bashkërendimi dhe monitorimi i masave kundër korrupsionit”.

33 5 Prioritetet e BE, ku Prioriteti 3 është “Vendosmëri në luftën kundër korrupsionit”.

34 VKM Nr. 506 datë 13.09.2017 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”, pika 4.

35 Urdhri i Ministrit nr. 2237 datë 20.02.2018 “Për Caktimin e Fushës së Përgjegjësisë dhe Detyrave të Zëvendës Ministrave të Drejtësisë”.

36 Urdhri i Kryeministrit Nr. 93 datë 07.08.2012 “Për Përgatitjen e Strategjive Sektoriale e Ndërsektoriale Kombëtare për Periudhën 2013-2020 si dhe Dokumenteve Strategjike Sektoriale 2013-2020, në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2013-2020.” Shtojca 3, Kapitulli 3 “Objektivat e politikës dhe produktet madhore”.

e Luftën kundër Korrupsionit 2008-2013<sup>37</sup>” Me gjithë përpjekjet e grupit të auditimit për të identifikuar gjurmë të institucioneve të ndryshme në propozimin e objektivave madhore, nëpërmjet kontrollit të arkivës fizike dhe asaj elektronike të MSHÇV përcjellë grupit të auditimit nga KKK aktual, vihet re se hartimi i objektivave madhorë në fakt nuk është një rezultante e tërësisë së propozimeve të të gjitha institucioneve të përfshira në strategji duke evidentuar moszbatimin e parimit të koordinimit mes institucioneve, siç shprehet SNKK 2015-2020. Objektivat madhore të SNKK 2015-2020 në të vërtetë nuk janë një sintezë e objektivave të propozuara nga çdo institucion i pushtetit lokal, sikurse cilëson metodologjia e hartimit të SNKK 2015-2020.

4. Sipas SNKK 2015-2020 “Masat e sugjeruara nga institucionet janë hartuar në bazë të prioriteteve të qeverisë, të buxhetit që i është alokuar çdo institucioni, si dhe në bazë të sugjerimeve të ekspertëve nga çdo institucion<sup>38</sup>”. Në fakt, edhe pse Prefektura e Tiranës nuk ka sugjeruar propozimet e veta lidhur me zbërthimin e objektivit A11 “Adoptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore” sipas nevojave të veta, konfirmon nëpërmjet shkresës nr. 1445/1 datë 03.05.2018 se “... me miratimin e Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, institucionet u gjendën para disa fakteve dhe detyrimeve që duheshin zbatuar... “. Vihet re, se pavarësisht asaj që shpreh SNKK 2015-2020 lidhur me metodologjinë dhe procesin e hartimit, institucionet lokale nuk kanë bërë propozime dhe zbërthimi i objektivave madhorë në objektiva specifike nuk reflekton nevojën e vërtetë të secilit institucion që përfshihet në objektivin A11 të SNKK 2015-2020.

#### **Për këtë rekomandojmë:**

1. KKK të kujdeset për të arkivuar dhe inventarizuar tërë dokumentacionin e arkivës shkresore të MSHÇV për sa i përket rolit të vet si KKK, lëvruar deri tani nga institucioni i Kryeministrit, bazuar në Ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003, “Për Arkivat”, i ndryshuar.

***Brenda muajit Tetor 2018***

2. Sekretari i Përgjithshëm pranë Ministrisë së Drejtësisë të konfirmojë zyrtarisht se i gjithë arkivi shkresor që ka lidhje me aktivitetin e KKK të mëparshëm (rol i mbuluar nga Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore) është lëvruar pranë Ministrisë së Drejtësisë.

***Brenda muajit Tetor 2018***

3. KKK nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të përfshijë të gjitha institucionet e përgjegjëse dhe mbështetëse që të propozojnë masat tyre respektive në zbërthimin e mëtejshëm të objektivave madhorë të SNKK 2015-2020, sa herë që rishikohet planit i veprimit të SNKK 2015-2020.

***Vazhdimisht, sa herë bëhet përditësimi i Planit të Veprimit të SNKK 2015-2020***

- ***Shënjestrimi i nënobjektivave me treguesit, produktet finale dhe afatet kohore respektive në Planin e Veprimit 2015-2020***

#### **Gjetje:**

---

<sup>37</sup>Strategjia Ndërsektorale kundër Korrupsionit 2015-2020 – Metodologjia dhe procesi i hartimit.

<sup>38</sup>Strategjia Ndërsektorale kundër Korrupsionit 2015-2020 – Metodologjia dhe procesi i hartimit.

1. Pas shqyrtimit të detajuar të evidencës shkresore dhe elektronike të MSHÇV, të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga Ministria e Drejtësisë, nuk u gjet asnjë evidencë që të tregojë se parashikimet e Treguesve të përgjithshëm dhe synimeve të SNKK 2015-2020<sup>39</sup> për vitet 2017 dhe 2020 janë hartuar nëpërmjet një analize dhe krahasimi të përshtatshëm dhe të detajuar, për të siguruar se parashikimet janë të arritshme dhe mund të masin realisht efektshmërinë e Strategjisë si një e tërë. Grupi i auditimit nuk ka mundur të gjejë informacion shkresor që të evidentojë nëse ka një metodologji të përdorur për përcaktimin e këtyre shënjestrimeve për vitet 2017 dhe 2020.
2. Grupi i auditimit nuk mori përgjigje zyrtare nga ana e Ministrisë së Drejtësisë apo vetë KKK, për tërësinë e pyetjeve të lëvruara me shkresën nr. 3312 prot., datë 20.03.2018, ku ndër të tjera grupi i auditimit kërkon përgjigje zyrtare dhe evidenca mbi mënyrën se si janë përcaktuar në terma sasiorë objektivat e SNKK 2015-2020 për projeksionet e viteve 2017 dhe 2020, referuar SNKK 2015-2020 – Kapitulli 5 – Llogaridhënia, monitorimi dhe analiza vlerësuese – Treguesit e përgjithshëm dhe synimet e strategjisë.
3. Grupi i auditimit nuk ka gjetur evidenca se:
  - Prefekturat kanë propozuar masat e tyre, treguesit respektivë, kostot e parashikuara për realizimin e këtyre produkteve dhe afatet kohore përkatëse, përveç rastit të prefekturës Berat.
  - Nga përgjigjet zyrtare të Prefekturës Tiranë përcjellë grupit të auditimit nëpërmjet shkresës nr. 1445/1 datë 03.05.2018, konfirmohet se treguesit e objektivit A11 janë vendosur në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i cili ishte miratuar rishtazi dhe jo në përputhje me nevojat specifike të vetë institucionit.
  - Jo të gjitha masat e propozuara nga Prefektura Berat janë përfshirë në tërësinë e objektivave specifike dhe treguesve të Planit të Veprimit.

### **Konkluzione:**

1. Që një strategji apo plan të jetë i suksesshëm, objektivat operacionalë, të cilat zbërthejnë ato strategjike e taktike duhet të jenë SMART. Në rastin e SNKK-së, një kërkesë e tillë buron edhe nga Urdhri i Kryeministrit nr. 139 datë 01.07.2010<sup>40</sup>, pika 3 i cili specifikon se “*Treguesit dhe qëllimet përcaktohen në mënyrë të tillë që të jenë të posaçëm (Specific), të matshëm (Measurable), të arritshëm (Achievable/ Aligned), realistë (Relevant/ Realistic) dhe të përcaktuar për një periudhë kohore të caktuar (Time – Bound)*”. SNKK 2015-2020 është detajuar në një Plan Veprimi që në pamje të parë përmban objektiva SMART, por kontributi i realizimit të këtyre objektivave në përmbushjen e objektivave madhorë strategjike është i papërcaktuar. Pra, nuk ekziston një metodologji apo një sistem që të konsolidojë objektivat operacionalë në vlerësimin sasior të ecurisë së objektivit madhor strategjik përkatës. Një mangësi e tillë në

---

<sup>39</sup> Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020 – Kapitulli 5 – Llogaridhënia, monitorimi dhe analiza vlerësuese – Treguesit e përgjithshëm dhe synimet e strategjisë.

<sup>40</sup> Urdhri i Kryeministrit Nr. 139 datë 01.07.2010 “Për Zbatimin e Procesit të Monitorimit të Strategjive Sektoriale e Ndërsektoriale” pika 3

planifikimin e strategjisë, mbetet ende e pakorregtuar në rishikimin që i është bërë Planit të Veprimit, duke e bërë praktikisht inefektive Strategjinë.

Kështu, 5 treguesit e përgjithshëm të SNKK 2015-2020, prezantojnë vlerat në të cilat ndodhet vendi ynë në momentin e hartimit të strategjisë dhe parashikimet respektive të secilit prej tyre për vitet 2017 dhe 2020, vlerat e të cilëve gjenerohen nga organizata ndërkombëtare të pavarura, si Transparency International, Banka Botërore, GRECO, etj. Por ndryshe nga ç'kërkon Urdhri i Kryeministrit nr. 93 datë 07.08.2013, SNKK 2015-2020 nuk shfaq asnjë prezantim të qartë mbi ecurinë dhe progresin në lidhje me përmbushjen e këtyre treguesve në periudha afatgjata.

2. Sipas Udhëzimit të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore "Udhëzime në lidhje me përgatitjen e Plan Veprimit kundër Korrupsionit 2014-2017" cilësohet se *"Plani i Veprimit ka si qëllim përmbledhjen në një dokument të vetëm të të gjithë atyre masave të cilat parashikohen nga institucionet për realizimin konkret të objektivave të SNKK... Çdo ministri, institucion i pavarur apo prefekturë, me anë të koordinatorit dhe pikës së kontaktit ... organizojnë punën brenda secilës ministri apo institucion për identifikimin e objektivave dhe masave (brenda orientimeve dhe objektivave strategjike të strategjisë."*

Po ashtu, bazuar në Udhëzimit të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore "Udhëzime në lidhje me përgatitjen e Plan Veprimit kundër Korrupsionit 2014-2017" *"... çdo pikë kontakti duhet ndër të tjera, të kujdeset që të detajojë objektivin strategjik në masa konkrete, duke organizuar punën... dhe të bëjë formulimin përfundimtar të masave..."*

Shkresa nr. 1445/1 datë 03.05.2018 përcjellë grupit të auditimit nga Prefektura e Tiranës shpreh se *"... me miratimin e Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" institucionet u gjendën para disa fakteve dhe detyrimeve që duheshin zbatuar. Ky ligj, në kuadër të së drejtës për informim të qytetarëve, përcaktonte detyrimin e transparencës së veprimtarisë së institucionit për çdo njeri që interesohej, për të lënë sa më pak hapësirë për mundësi abuzimi. ... Kështu që indikatorët e objektivit A11 janë përcaktuar pikërisht referuar të drejtës për informim..."*

Përveç rastit të Prefekturës Tiranë, rasti i Prefekturës Berat tregon se edhe pse ka evidenca se vetëm ky institucion ka propozuar masat e veta, afatet dhe kostot respektive, nuk janë përfshirë në planin e veprimit 2015-2020 të gjitha propozimet e prefekturës Berat.

Në kushte të tilla, kur Udhëzimet e Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore lidhur me hartimin e Planit të Veprimit, janë thjesht një akt zyrtar, nuk mund të pretendohet se është gjeneruar një plan veprimi duke u nisur nga baza drejt hierarkisë, që përmban nënobjektiva të zbërthyera në mënyrë SMART, me masa, afate kohore dhe kosto të parashikuara sipas nevojave të vetë prefekturave për rastin e objektivit A11.

### **Për këtë rekomandojmë:**

Sekretariati Teknik pranë KKK të marrë masa që të grumbullojë propozimet e nga i gjithë rrjeti i pikave fokale kundër korrupsionit dhe të gjenerojë masa, tregues, kosto të parashikuara për realizimin e këtyre produkteve dhe afatet kohore të cilat të reflektojnë sintetizim të nevojave reale të institucioneve përgjegjëse për një arritje të SNKK.

***Vazhdimisht, sa herë bëhet përditësimi i Planit të Veprimit të SNKK 2015-2020***

- **Kostimi i produkteve të synuara**

**Gjetje:**

1. Për vitin 2016 dhe 2017, KKK nuk ka rishikuar në bazë vjetore planin e veprimit të strategjisë, ndryshe nga sa parashikon strategjia. Sipas SNKK 2015-2020 – Kapitulli 4 – Burimet Financiare, cilësohet se “*Plani i Veprimit të strategjisë do të rishikohet në bazë vjetore për ta përshtatur me progresin në zbatimin e masave, por edhe për ta azhurnuar atë konform ciklit të programimit vjetor buxhetor, si dhe prioriteteve të çdo sektori*”
2. Objektivi specifik i Planit të Veprimit A11.1 “Krijimi i faqeve web të përditësuara” rezulton i pazbatuar për vitin 2015 dhe pjesërisht i zbatuar për vitet 2016 dhe 2017 për mungesë fondesh nga ana e prefekturave. Edhe pse objektivi madhor A11 i SNKK 2015-2020 si një tërësi e objektivave specifike të përcaktuar në planin e veprimit 2015-2020, është parashikuar në të dy këta dokumente strategjike si një objektivi që nuk ka kosto, rezulton se përmbushja apo mospërmbushja e tij varet drejtpërdrejt nga kostot. Më poshtë është prezantimi sintetik i gjetjes në formë tabelore:

**Tabela 4: Arsyet e raportuara nga prefekturat për mosrealizimin e objektivit specifik A11.1 “Krijimi i faqeve web të përditësuara”**

Qasja e strategjisë	Objektiv i madhor i SNKK 2015-2020	Objektivi specifik i Planit të Veprimit	Arsyet e raportuara për mos realizim					
			Raporti i monitorimit 2015	Nr i Prefekturave që kanë raportuar	Raporti i monitorimit 2016	Nr i Prefekturave që kanë raportuar	Raporti i monitorimit 2017	Nr i Prefekturave që kanë raportuar
Para - ndaluese	A11 Artikulli mi dhe adoptimi i politikave anti korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore	A11.1 Krijimi i faqeve web të përditësuara	9 prefektura raportojnë se adresat web nuk janë të aksesueshme për mungesë fondesh	9	Prefektura Korçë raporton se nuk është realizuar hapja e faqes web për mungesë fondesh.	8	3 prefektura raportojnë se kanë mungesë fondesh.	9

Punoi: Grupi i auditimit të KLSH

**Konkluzione:**

1. Sipas SNKK 2015-2020, rishikimi i Planit të Veprimit në bazë vjetore është jetik për të ndjekur zbatimin e masave dhe korrelacionin e tyre me pamjaftueshmërinë e burimeve financiare. Pavarësisht se SNKK kërkon të parashikojë minimizimin e risqeve të moszbatimit të saj për mungesa të burimeve financiare, duke përditësuar në bazë vjetore planin e veprimit, nuk vihet re e njëjta qasje nga ana e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, i cili për dy vjet nuk e ka përditësuar asnjëherë planin e veprimit. Kjo mungesë përditësimi thëllon risqet për mosimplementimin e strategjisë në tërësi, duke çënuar kështu edhe objektivat

madhorë në të cilat është bazuar vetë strategjia, siç është edhe prioriteti 3 i BE “Vendosmëri në luftën kundër korrupsionit”.

2. Vetë Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 - Metodologjia dhe procesi i hartimit, specifikon se “Masat e sugjeruara nga institucionet janë hartuar në bazë të prioriteteve të qeverisë, të buxhetit që i është alokuar çdo institucioni si dhe në bazë të sugjerimeve të ekspertëve nga çdo institucion”, duke i kushtuar rëndësi mirëplanifikimit të kostove të parashikuara, si një nga kushtet jetike për implementimin e suksesshëm të strategjisë. Po ashtu, sipas SNKK 2015-2020 – Kapitulli 4 “Burimet Financiare” thuhet se “Kostot e zbatimit të masave konkrete janë paraqitur nga secila ministri apo institucion përgjegjës për zbatimin e tyre”. Vihet re se për objektivin specifik A11.1 nuk janë analizuar me kujdes kostot e nevojshme për realizimin e tij, duke ndikuar në mosalokim buxheti tek çdo prefekturë (siç cilësohet në SNKK 2015-2020). Për pasojë ky nën-objektiv rezulton në rastin më të mirë “Pjesërisht i zbatuar”.
3. Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, cilëson objektivin A11 “Artikulimi dhe adoptimi i politikave antikorrupsion në nivelin e qeverisjes vendore” si një nga 4 objektivat madhorë të Qasjes Parandaluese me kosto totale 0. Po ashtu, edhe Plani i Veprimit bashkëlidhur SNKK 2015-2020, i cili zbërthen më tej në objektiva specifike objektivin madhor A11, nuk parashikon asnjë kosto për realizimin e plotë të tij. Nga të gjithë objektivat specifike të A11 vetëm A11.1 “Krijimi i faqeve web të përditësuara” është i tillë që realizimi apo mosrealizimi i tij varet plotësisht nga parashikimi i saktë i kostove në plan veprimi. Kështu, për rastin e objektivit specifik A11.1 “Krijimi i faqeve web të përditësuara” treguesi i zbatimit të të cilit sipas Planit të Veprimit është “Adresa web të aksesueshme” nga raportet vjetore të monitorimit që harton KKK rezulton si i pazbatuar për vitin 2015 dhe pjesërisht i zbatuar për vitet 2016-2017. Më poshtë është paraqitja tabelare e raportimit të objektivit specifik A11.1 “Krijimi i faqeve web të përditësuara” për vitet 2015, 2016 dhe 2017.

**Tabela 5: Masa e realizimit të objektivit specifik A11.1 “Krijimi i faqeve web të përditësuara” në planin e veprimit 2015-2020**

Qasja e strategjisë	Objektivi madhor	Objektivat specifike të Planit të Veprimit		Raporti i monitorimit 2017
		2015	2016	
Parandaluese	A11 Artikulimi dhe adoptimi i politikave anti korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore	A11.1 Krijimi i faqeve web të përditësuara	I pa zbatuar	Pjesërisht i zbatuar

Punoi: Grupi i auditimit të KLSH

**Për këtë rekomandojmë:**

1. KKK aktual nëpërmjet strukturave përkatëse, të përditësojë Planin e veprimit në bazë vjetore me qëllim përshtatjen me progresin në zbatim të masave.

***Në vazhdimësi***

2. KKK aktual nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masat për analizuar dhe siguruar se kostot e nevojshme të propozuara nga institucionet përgjegjëse për implementimin e objektivave specifike sipas Planit të Veprimit, mund të sigurojnë zbatimin e plotë të tyre brenda harqeve të përcaktuara kohore.

***Në vazhdimësi, çdo vit para hartimit të planit të përditësuar të veprimit të SNKK***

3. Sekretariati Teknik pranë KKK të marrë masa që të sigurojë se kostot e parashikuara për realizimin e objektivave specifike nga institucionet përgjegjëse të reflektohen në planin e veprimit.

***Në vazhdimësi çdo vit para hartimit të planit të përditësuar të veprimit të SNKK***

## **2. Implementimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit**

### ***• Baza ligjore për ndarjen e kompetencave***

VKM nr. 1012 datë 22.11.2013<sup>41</sup> përcakton Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore si KKK. Më tej, me shkrirjen e MSHÇV, ky rol iu kalua Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet VKM nr. 506 datë 13.09.2017<sup>42</sup>, për t'iu caktuar konkretisht njërit prej Zv/Ministrave të Drejtësisë nëpërmjet Urdhrit të Ministrit nr. 2237<sup>43</sup>. Sipas kësaj rrjedhe kohore ka lëvizur kalimi i përgjegjësisë dhe i detyrave të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit.

Sipas SNKK 2015-2020 dhe VKM nr. 1012, datë 22.11.2013, pika 5 “Ministrit i Shtetit për Çështjet Vendore, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e organeve e të institucioneve shtetërore të pavarura, në qendër dhe në nivel vendor për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, si dhe përfaqëson qeverinë në marrëdhëniet me organet kushtetuese, në kuadër të bashkërendimit të punës në këtë fushë”, institucionet zbatuese të kësaj strategjie përmbliohen në paraqitjen skematike, si më poshtë në skemën 6.

### **Gjetje:**

1. Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 2237<sup>44</sup>, datë 20.02.2018, i cili përcakton se cili do të jetë personi përgjegjës në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, përveç faktit që ka dalë 5 muaj më vonë se VKM nr. 1012, datë 22.11.2013 që ia kalon këtë kompetencë MD, është i paplotë dhe i mungon aneksi i cili udhëzon se si duhet bërë monitorimi i zbatimit të detyrave të zv/ministrave, ku duhet të përfshihen edhe ato të KKK.
2. Që prej datës 13.09.2017 kur kompetencat e KKK i kalojnë Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet VKM nr. 506, Ministria e Drejtësisë:

---

<sup>41</sup> VKM Nr. 1012 datë 22.11.2013 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore”


<sup>42</sup> VKM Nr. 506 datë 13.09.2017 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”

<sup>43</sup> Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 2237 datë 20.02.2018 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë dhe Detyrave të Zëvendësministrave të Drejtësisë”

<sup>44</sup> Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 2237 datë 20.02.2018 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë dhe Detyrave të Zëvendësministrave të Drejtësisë”

- a. Nuk ka hartuar asnjë ndryshim respektiv në Rregulloren e Brendshme, në të cilën të detajohen organizimi dhe funksionimi i kësaj përgjegjësie të re të shtuar që në Shtator 2017.
- b. Ende nuk është e qartë nëse kompetencat e KKK duhet të përfshihen nëpërmjet ndryshimit të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, i ndryshuar apo të përfshihet në Rregulloren e Brendshme.

### Skema 6: Institucionet zbatuese të SNKK 2015-2020



Punoi: Grupi i auditimit të KLSH

3. Që prej datës 05.10.2017, 56% e pozicioneve tek tre sektorët e rinj pranë MD me fokus antikorrupsionin, të miratuara sipas Skemës 1 të Urdhrit të Kryeministrit nr. 5166, rezultojnë ende vakante.

**Tabela 6: Vendet vakante pranë Ministrisë së Drejtësisë për sektorët dedikuar antikorrupsionit.**

<i>Sektori pranë Ministrisë së Drejtësisë</i>	<i>Pozicioni</i>	<i>Statusi</i>
Monitorimit, Jetësimi të Prioriteteve dhe Statistikave	Përgjegjës	Vakant
	Specialist	x
	Specialist	x
Programeve në Fushën e Drejtësisë dhe Antikorrupsionit	Përgjegjës	x
	Specialist	Vakant
	Specialist	Vakant
Projektit Anti korrupsion	Përgjegjës	Vakant
	Specialist	x

Burimi: Të dhëna nga Ministria e Drejtësisë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

### Grafiku 3: Prezantimi grafik i vendeve vakante dhe atyre të plotësuara me staf në tre sektorët me fokus antikorrupsionin.



Punoi: Grupi i auditimit të KLSH

#### Konkluzione:

1. Sipas Urdhrit të Ministrit nr. 2237, datë 20.02.2018, pika 5, thuhet se *“Monitorimi i zbatimit të detyrave do të bëhet mbi bazën e planit të masave me afate për prioritetet dhe objektivat, sipas Aneksit bashkëngjitur këtij urdhri”*. Grupi i auditimit i kërkoi Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet email-it zyrtar që të vihej në dispozicion edhe aneksi i cili nuk ishte përcjellë me urdhrin në fjalë. Sipas përgjigjes zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, *“nuk rezulton që ky urdhër të ketë aneks”*. Aneksi që mungon duhet të sigurojë në mënyrë të brendshme se secili Zv/Ministër, specifikisht ai në rolin e KKK, po zbaton detyrat dhe përgjegjësitë për çështjet në sektorin e antikorrupsionit. Mungesa e këtij aneksi në fakt, tregon për një Urdhër Ministri të mangët, duke ndikuar në efektshmërinë e vetë urdhrin.
2. Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Drejtësisë është miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 5745, datë 13.08.2008 e më tej organizimi dhe funksionimi i institucionit është rregulluar nëpërmjet shtesave dhe ndryshimeve me Urdhra të njëpasnjëshëm në 2009, 2010, 2011, për të konkluduar në 2013. Edhe pse në 13.09.2017 roli i KKK iu bashkëngjiti Ministrisë së Drejtësisë, institucioni vijon të përdorë të njëjtën Rregullorë të Brendshme ku ndryshimet e fundit janë bërë në vitin 2013. Në përgjigjen e vet zyrtare me shkresën nr. 3312/1, datë 28.03.2018, Ministria e Drejtësisë konfirmon se *“...sa i përket pikës së parë të kërkesës tuaj, ju bëjmë me dije se në Rregulloren e Brendshme të Ministrisë së Drejtësisë nuk ka ndryshime ku të përcaktohet mandati, fusha e veprimit, detyrat dhe përgjegjësitë e KKK.”*
3. Me tej, lidhur me cilësimin e kompetencave të KKK, Ministria e Drejtësisë shpreh në shkresën e saj nr. 3312/1, datë 28.03.2018 se *“...Aktualisht jemi në proces diskutimi nëse ndryshimet në lidhje me kompetencat e KKK të përfshihen nëpërmjet ndryshimit të Ligjit 8678, datë 14.05.2001, i ndryshuar apo të Rregullores së Brendshme.”* Kanë kaluar 6 muaj që nga momenti i delegimit të rolit të KKK pranë

Ministrisë së Drejtësisë dhe drejtuesit e saj ende nuk janë të qartë se si mund të zgjidhet ky ngërç administrativ. Kjo paqartësi, ende pas 6 muajsh e pazgjidhur, jep efektet e veta në mungesën e vizionit të një institucioni për të siguruar implementimin dhe monitorimin e SNKK 2015-2020 dhe Planit të Veprimit.

Vlen të përmendet se mungesa e një akti që vendos kornizat administrative të fushës së veprimit të KKK:

- nuk mundëson një strukturë organizative të fokusuar ndaj antikorrupsionit, pasi mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e specifikuar sipas secilit sektor;
- nuk mundëson identifikimin e nevojave për burime njerëzore, pasi nuk dihet se çfarë pune duhet të kryhet dhe çfarë cilësish duhet të zotërojë stafi mbështetës në përmbushje të misionit të KKK;
- dhe për pasojë nuk mundëson suksesin e strategjisë dhe Planit të Veprimit.

Rrjedhimisht, situata si kjo, ku ekzistojnë dilema të tilla administrative, ndikojnë drejtpërdrejt në efektivitetin e vetë dokumenteve strategjike në përmbushjen e programeve të qeverisë dhe veçanërisht Prioritetit 3 të Bashkimit Europian “**Vendosmëri në luftën kundër korrupsionit**”, ashtu siç theksohet edhe në SNKK 2015-2020.

4. Që prej muajit Tetor 2017, Ministria e Drejtësisë përballet me staf të reduktuar në të tre sektorët e rinj të dedikuar antikorrupsionit.

- Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave ka dy specialistë, por jo një përgjegjës që të udhëheqë punën e sektorit.
- Sektori i Programeve në Fushën e Drejtësisë dhe Antikorrupsionit, ka një përgjegjës por i mungojnë 2 specialistë për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e veta.
- Sektori i Projektit Antikorrupsion duket sektori më i plotë, të cilit i mungon vetëm një specialist.

Me mungesa kaq të theksuara të stafit fokusuar në antikorrupsion, misioni i KKK në sigurimin e implementimit dhe monitorimit të objektivave specifike dhe atyre madhore të parashikuara në dokumentet strategjike, është i vështirë për t’u arritur.

#### **Për këtë rekomandojmë:**

1. Ministri i Drejtësisë të marrë masa e të përpilojë aneksin për t’iu bashkëngjitur Urdhrit nr. 2237, datë 20.02.2018, ashtu siç vetë Ministri urdhëron.

***Brenda muajit Tetor 2018***

2. Ministri i Drejtësisë të marrë masa dhe të hartojë Rregulloren e Brendshme, duke specifikuar mandatin, fushën e veprimit, detyrat dhe përgjegjësitë e KKK, dhe të të gjithë organikës sipas Skemës 2 të Urdhrit të Kryeministrit nr. 5166, datë 05.10.2017, “Organika e Ministrisë së Drejtësisë”

***Brenda muajit Tetor 2018***

3. Ministria e Drejtësisë të marra masa në plotësimin e vendeve vakante, specifikisht të të tre sektorëve me fokus antikorrupsionin.

***Brenda muajit Nëntor 2018***

- ***Struktura përgjegjëse për garantimin e implementimit të SNKK dhe Planit të Veprimit***

## **Gjetje:**

1. Nuk ka asnjë evidencë se KKK ka organizuar takime koordinuese me një periodicitet prej 3 dhe 6 muajsh për një analizë më të thelluar të problematikave të hasura në implementimin e strategjisë antikorrupsion, ashtu siç parashikohet në SNKK 2015-2020.
2. Nuk ka asnjë evidencë se KKK ka organizuar një takim çdo vit në dhjetor në Ditën Ndërkombëtare kundër Korrupsionit sipas përcaktimeve të SNKK 2015-2020.
3. Nuk ka evidenca që vërtetojnë se në bazë 6-mujore janë mbajtur takime diskutimi mbi raportet e monitorimit që janë hartuar nga Sekretariati Teknik dhe të publikuara për konsultim, të cilat i prezantohen Mekanizmit Monitorues për miratim.
4. Sekretariati Teknik:
  - Nuk ka hartuar raporte të përmbledhura monitorimi çdo 3 muaj, sikundër kërkohet në SNKK. Grupi i auditimit ka mundur të ketë në dispozicion të auditimit vetëm raportet e mëposhtme:
    - Raport vjetor monitorimi i vitit 2015
    - Raport monitorimi nr. 2 Periudha: Janar – Qershor 2016
    - Raport monitorimi nr. 3 Periudha: Korrik - Dhjetor 2016
    - Raport vjetor monitorimi i vitit 2016
    - Raport vjetor monitorimi i vitit 2017
  - Nuk ka hartuar asnjë raport të zbatimit të integruar.
  - Nuk ka miratuar asnjë dokument dhe nuk ka marrë asnjë vendim të cilin duhet t’ia komunikojë publikut.
  - Nuk ka përdorur asnjë analizë statistikore apo cilësore duke përdorur të dhëna krahasuese përtej atyre që lidhen me vetëvlerësimin e situatës të luftës kundër korrupsionit.
  - Nuk ka komunikuar me palë të treta dhe shoqërinë civile për vlerësimin e masave të zbatuara.
  - Nuk ka asnjë dokumentim të arritjeve dhe praktikave të mira
  - Nuk ka asnjë metodë tjetër vlerësimi, përfshi këtu sondazhe, vlerësime situatë, pyetësorë, etj.
  - Nuk ka ofruar asnjë mjet dhe mënyrë me të cilat do të raportohet si p.sh. formularë, sisteme/ programe elektronike komunikimi të informacionit, etj. Institucionet raportojnë në varësi të matricës së vetë Planit të Veprimit.

## **Konkluzione:**

1. Mungesa e takimeve koordinuese çdo 3 dhe 6 muaj prek cilësinë e raportimeve dhe gasjen e institucioneve përgjegjëse në implementimin e SNKK dhe Planit të Veprimit. Pa takime të vazhdueshme në të cilat të reflektohen vështirësitë dhe problemet që hasin grupet e interesit, është e vështirë të rishikohet Plani i Veprimit. Në thelb, të gjitha këto takime synojnë eliminimin e barrierave të mundshme për një implementim sa më të plotë të një dokumenti jetik në minimizimin e korrupsionit, sikurse pretendohet se është SNKK 2015-2020 dhe Plani i Veprimit.
2. Lidhur me raportet e monitorimit, sipas SNKK 2015-2020, Kapitulli 5 “Raportimi periodik, metodologjia e raportimit dhe raportimet publike” këto raporte të

përgatitura do të publikohen gjithashtu për të mundësuar aksesin dhe dhënien e informacionit ndaj palëve të interesuara.

Mungesa e tërësisë së dokumentacionit dhe evidencave mbi aktivitetin e Sekretariatit Teknik, sipas cilësimeve të SNKK 2015-2020 “Raportimi periodik, metodologjia e raportimit dhe raportimet publike”, nuk tregojnë vetëm për procese pune të pafilluara, por hedhin dyshimin nëse Sekretariati Teknik ka ekzistuar ndonjëherë. Më shumë se kaq, të gjitha këto mangësi flasin për një mungesë vëmendje dhe dëshirë që këta dy dokumente strategjikë siç është SNKK dhe PV të implementohen suksesshëm nën optikën e KKK dhe të gjithë palëve të interesit.

### **Për këtë rekomandojmë:**

1. KKK aktual të organizojë në mënyrë periodike dhe sistematike takimet sipas harqeve kohore të mirëpërcaktuara në SNKK 2015-2020.

*Në vazhdimësi*

2. KKK aktual të ngrejë dhe të sigurojë funksionimin e plotë të Sekretariatit Teknik.

*Brenda muajit Tetor 2018*

- a. Sekretariati teknik të hartojë raportet e përmbledhura të monitorimit çdo 3 muaj sikundër është parashikuar në SNKK 2015-2020

*Në vazhdimësi*

- b. Mekanizmi Monitorues të sigurojë se Sekretariati Teknik po ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e veta në përputhje me specifikimet e SNKK 2015-2020, miratuar me VKM nr. 247, datë 20.3.2015.

*Në vazhdimësi*

3. Sekretariati Teknik të organizojë periodikisht takime diskutimi mbi raportet e monitorimit të hartuara dhe të publikuara.

*Në vazhdimësi*

### **3. Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit**

#### **• Strukturat përgjegjëse**

#### **Gjetje:**

1. Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit nuk ka ngritur asnjë mekanizëm mbikëqyrës dhe zbatues për strategjinë kundër korrupsionit, i cili sipas SNKK 2015-2020 ka si qëllim dhe detyrë koordinimin e punës për zbatimin e strategjisë.
2. Për pasojë, mungesa e këtij mekanizmi bën që:
  - a. Të mos jenë marrë vendime nga ana e tij,
  - b. Të mos jenë lënë udhëzime
  - c. Të mos jenë miratuar dhe rishikuar mjetet dhe mënyrat me të cilat do të raportohet lidhur me implementimin e SNKK dhe Planit të Veprimit
  - d. Të mos jetë lënë asnjë rekomandim për institucionet përgjegjëse nga ky mekanizëm

#### **Konkluzione:**

1. Mekanizmi mbikëqyrës dhe zbatues që duhet të ishte ngritur nga KKK që në vitin 2013, sipas SNKK 2015-2020, Kapitulli 5 “*Llogaridhënia, monitorimi dhe analiza vlerësuese – Institucionet zbatuese*” duhet të koordinonte punën për zbatimin e strategjisë përmes zhvillimit të mëtejshëm dhe miratimit të Planit të Veprimit, monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit dhe raportimit publik mbi progresin e zbatimit të tij.

Nga komunikimet e grupit të auditimit me KKK aktual, Ministrinë e Drejtësisë dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit shkresor dhe elektronik, nuk ka asnjë informacion mbi ekzistencën e këtij mekanizmi.

Pas takimeve të shumta, grupi i auditimit u takua edhe me përfaqësues të Kryeministrit, Njësia e Politikave për Zhvillim dhe Mirëqeverisje<sup>45</sup>, të cilët u shprehën se këto kompetenca që duhet të ishin mbuluar nga Mekanizmi në fjalë, mbuloreshin në mënyrë më të përgjithshme nga Grupet Tematike të miratuara nëpërmjet Urdhrit të Kryeministrit nr. 125, datë 21.09.2015 “Për Marrjen e Masave Institucionale dhe Operacionale për Zbatimin e Qasjes Sektoriale dhe Krijimin e Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave”. Fusha Antikorrupsion i është përcaktuar GMIP për Mirëqeverisjen dhe Reformën e Administratës Publike, si një nga nëngrupet tematike të punës.

Sipas Urdhrit të Kryeministrit, përbërja e këtij GMPI që ka patur nën spektrin e vet edhe fushën antikorrupsion, është ende në diskutim dhe nuk është finale. Kjo GMPI udhëhiqej nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike. Por sipas Urdhrit në fjalë, GMPI kryesohet nga Ministri apo titullari i institucionit udhëheqës për sektorin e veçantë.

- Në këtë këndvështrim, nëse GMPI që pretendohet se ka kryer rolin e Mekanizmit Mbikëqyrës dhe Zbatues të SNKK 2015-2020 dhe Planit të Veprimit, është drejtuar nga një ministër shteti që nuk është as Ministri për Çështjet Vendore e as Zv. Ministri i Drejtësisë (pas 13.09.2017), kemi të bëjmë me një shkelje të vetë Urdhrit të Kryeministrit nr. 125, datë 21.09.2015.
- Në fund të fundit, funksioni i Mekanizmit të Mbikëqyrës dhe Zbatues të SNKK 2015-2020 dhe Planit të Veprimit nuk është i njëjtë me funksionin e GMPI i cili sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 125 cilësohet kështu: “*Funksioni i GMPI-së është të këshillojë, drejtojë dhe koordinojë institucionet e përfshira në sektor, të zhvillojë dhe të zbatojë një Program Kombëtar Sektorial...*”
- Edhe pse ky Urdhër ka dalë më vonë se Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 247, datë 20.3.2015, i cili miraton SNKK 2015-2020 dhe Planin e Veprimit, GMPI-të nuk reflektojnë nevojat e SNKK-së për institucionin e Mekanizmit të Mbikëqyrjes dhe Zbatues.

2. Mungesa e këtij mekanizmi vë në rrezik implementimin e një strategjie ndërsektoriale e cila synon të përmbushë jo vetëm programin e qeverisë por edhe një nga 5 prioritetet e BE.

### **Për këtë rekomandojmë:**

---

<sup>45</sup> Takimi mes GA të KLSH dhe Stafit të Njesisë së Politikave për Zhvillim dhe Mirëqeverisje pranë Kryeministrit, në ambientet e KLSH, datë 27 Prill 2018, ora 9.00 am, konfirmuar nëpërmjet emailit të znj. Zv. Ministre drejtuar GA, KLSH, datë 27 Prill 2018 ora 00.19

1. KKK aktual të ngrejë Mekanizmin Monitorues dhe të sigurojë funksionimin e plotë të tij sikundër përcaktohet në SNKK 2015-2020.

***Brenda muajit Tetor 2018 dhe në vazhdimësi***

---

### **3.2 Si janë zbatuar nënobjektivat e strategjisë dhe aktivitetet e PV për adoptimin e politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore?**

Vizioni i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020 dhe Plani i Veprimit 2015-2017 është për institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm, në funksion të politikave për ç'rrenjosjen e korrupsionit nga radhët e administratës publike dhe të të gjitha segmenteve shtetërore dhe kryesisht nga institucionet që ofrojnë shërbime publike për qytetarët.

#### **3.2.1 Sa ka ndikuar angazhimi i Prefekturave në adoptimin e politikave kundër korrupsionit në nivel vendor?**

Institucioni i Prefekturës është hallkë e rëndësishme mes pushtetit vendor dhe atij qendror. Përfshirja e tyre në SNKK 2015-2020 dhe në mënyrë më eksplicite në Planin e Veprimit, u jep mundësinë këtyre institucioneve të adoptojnë politikat kundër korrupsionit në nivel vendor.

Objektivi A11 është një nga objektivat kryesorë të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020, e cila zërthehet në Planin e Veprimit nëpërmjet 6 objektivave specifike:

- ✓ A11.1 Krijimi i faqeve web të përditësuara;
- ✓ A11.2 Krijimi i mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal;
- ✓ A11.3 Publikimi në ambientet publike dhe internet të Prefekturave të buxheteve dhe shpenzimeve të çdo komune dhe bashkie në qark;
- ✓ A11.4 Krijimi i regjistrit tematik të ankesave;
- ✓ A11.5 Ofrimi i shërbimeve administrative në nivel vendor përmes sporteleve unike;
- ✓ A11.6 Publikimi në ambientet publike të çdo prefekturë të akteve nënligjore të miratuara nga bashkitë përkatëse të qarkut.

#### **Gjetje:**

1. Mënyra e raportimit të pikave fokale, specifikisht në secilën prefekturë, nuk kryhet nëpërmjet Matricave të vlerësimit të rezultateve, në të cilat përfshihen edhe tabelat e monitorimit, ashtu siç është përcaktuar në udhëzimin përkatës.<sup>46</sup>
2. Ka prefektura që nuk kanë raportuar lidhur me vetë-deklarimin e realizimit të objektivave specifike të objektivit kryesor A11. Koncretisht:
  - Prefektura Tiranë nuk ka raportuar asnjëherë lidhur me statusin e implementimit të Planit të Veprimit përgjatë periudhës 2015-2017;
  - Prefektura Lezhë nuk ka raportuar për vitet 2015 dhe 2016;

---

<sup>46</sup> Urdhri i Kryeministrit nr. 139 datë 01.07.2010 "Për Zbatimin e Procesit të Monitorimit të Strategjive Sektoriale e Ndërsektoriale", pika 5 "*Tabelat e monitorimit përshkruajnë veprimet dhe masat e ndërmarra kundërsht masave të planifikuara me qëllim përcaktimin e rezultateve mbi arritjet sipas programeve dhe strategjive*".

- Prefektura Durrës nuk ka raportuar për vitin 2015;
- Prefektura Gjirokastrë dhe Fier nuk kanë raportuar për vitin 2016;
- Prefektura Elbasan dhe Shkodër nuk kanë raportuar për vitin 2017;
- Prefektura Vlorë dhe Berat nuk kanë raportuar për 6 mujorin e dytë të vitit 2016.

3. Ka prefektura që edhe pse kanë raportuar për masën e implementimit për një vit të caktuar, p.sh vitin 2015, nuk e kanë bërë këtë për vitet e ardhshme. Raste të tilla janë prefekturat e Fierit, Vlorës, Shkodrës, Elbasanit, Gjirokastrës, Beratit dhe Elbasanit.

Në tabelën e mëposhtme prezantohet përmbledhja e raportimit 2015 – 2017.

**Tabela 7: Raportimi i të gjitha prefekturave lidhur me A11.**

Nr	Prefektura	Raportet e monitorimit të SNKK dhe Planit të Veprimit			
		2015	Jan - Qersh 2016	Korr - Dhje 2016	2017
1	Tiranë				
2	Vlorë	+	+		+
3	Fier	+			+
4	Shkodër	+	+	+	
5	Korçë	+	+	+	+
6	Elbasan	+	+	+	
7	Dibër	+	+	+	+
8	Kukës	+	+	+	+
9	Gjirokastrë	+			+
10	Berat	+	+		+
11	Durrës		+	+	+
12	Lezhë				+
<b>Raportuar gjithsej</b>		<b>9</b>	<b>8</b>	<b>6</b>	<b>9</b>
<b>Pa raportuar</b>		<b>3</b>	<b>4</b>	<b>6</b>	<b>3</b>

Burimi: Raportet e Monitorimit 2015, 2016, 2017, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Specifikisht më poshtë paraqitet përmbledhja e raportimeve për 3 prefekturat e marra në auditim: Tiranë, Fier, Shkodër.

**Tabela 8: Raportimi sipas prefekturave të marra në auditim**

Nr	Prefektura	Raportet e monitorimit të SNKK dhe Planit të Veprimit			
		2015	Jan - Qersh 2016	Korr - Dhje 2016	2017
1	Tiranë				
2	Fier	+			+
3	Shkodër	+	+	+	

Punoi: Grupi i auditimit të KLSH

4. Nga 6 objektivat specifike të objektivit A11, vetëm A11.2 (Krijimi i mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal) raportohet i zbatuar për vitet 2015, 2016 dhe 2017. Objektivat e tjerë kryesisht janë raportuar si pjesërisht të zbatuar. Nga raportet vjetore të hartuara nga KKK, vihet re se nuk janë zbatuar të gjitha masat e vendosura nga ana e prefekturave, ku vetëm 1 nga 6 objektivat specifike raportohet i zbatuar.

**Tabela 9: Përmbledhje e realizimit të masave të objektivit madhor A11**

Objektivat specifike sipas Planit të Veprimit		Afati kohor i paracaktuar	2015	2016	2017
A11.1	Krijimi i faqeve web të përditësuara	Dhjetor 2015	I pazbatuar	Pjesërisht i zbatuar	Pjesërisht i zbatuar
A11.2	Krijimi i Mekanizmit të Monitorimit dhe Vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal	Janar 2015 e në vijim	I zbatuar	I zbatuar	I zbatuar
A11.3	Publikimi në ambientet publike dhe internet të Prefekturave të buxheteve dhe shpenzimeve të çdo komune dhe bashkie në qark	Dhjetor 2015		Pjesërisht i zbatuar	Pjesërisht i zbatuar
A11.4	Krijimi i regjistrit tematik të ankesave	Dhjetor 2016	Pjesërisht i zbatuar	Pjesërisht i zbatuar	Pjesërisht i zbatuar
A11.5	Ofrimi i shërbimeve administrative në nivel vendor përmes sporteleve unike	2017	Pjesërisht i zbatuar	Pjesërisht i zbatuar	Pjesërisht i zbatuar
A11.6	Publikimi në ambientet publike të çdo prefekturë të akteve nënligjore të miratuara nga bashkitë përkatëse të qarkut.	2017		Pjesërisht i zbatuar	Pjesërisht i zbatuar

Punoi: Grupi i auditimit të KLSH

### **Konkluzione:**

1. Asnjë nga pikat fokale për implementimin e SNKK 2015-2020 dhe Planit të Veprimit nuk raporton sipas formatit të miratuar nëpërmjet Urdhrit të Kryeministrit nr. 139, datë 01.07.2010. Matrica aktuale e cila përmban informacion përshkrues nuk e bën të mundur krahasimin e masave të ndërmarra kundrejt atyre të planifikuara. Matrica e vlerësimit të rezultateve zbatohet, ndër të tjera, dhe për llogaridhënien me qëllim rritjen e transparencës.
2. Rezultatet e tabelave të mësipërme japin të dhëna mbi përfshirjen reale të prefekturave në adoptimin e objektivit madhor A11 kundër korrupsionit në nivel vendor, të cilat shfaqin:
  - Nuk ka asnjë vazhdimësi në raportim as nga prefektura që në 2015 kanë raportuar arritjet / mosarritjet e tyre pranë KKK. Kështu, nëse në 2015 kanë raportuar gjithsej 9 prefektura, në 6-mujorin e parë të 2016 raportojnë vetëm 8,

në 6-mujorin e dytë të 2016 vetëm 6 prefektura dhe në 2017 pasqyrohet i njëjti numër i prefekturave me atë të vitit 2015.

- Ka prefektura që nuk kanë raportuar më shumë se një herë. Prefektura më e rëndësishme e vendit, ajo e Tiranës nuk ka raportuar asnjëherë në tre vite, për vlerësimin e zbatueshmërisë së masave të Planit të Veprimit, për t'u pasuar nga prefektura Lezhë e cila nuk ka raportuar për dy vite.
- Ka prefektura që nuk kanë raportuar për një vit të plotë të aktivitetit të tyre në zbatim të Planit të Veprimit përgjatë periudhës 2015-2017. Nga 12 prefektura, 41% e tyre nuk kanë përcjellë asnjë informacion tek KKK për nivelin e implementimit të objektivave specifike.
- Më i rëndësishëm bëhet fakti se edhe ato prefektura që kanë raportuar për vitin e parë të implementimit të SNKK dhe Planit të Veprimit nuk kanë raportuar rregullisht për vitet 2016 dhe 2017. Mungesa e periodicitetit në raportim edhe për ato prefektura që e kanë bërë vitin e parë, tregon për mungesë angazhimi nga të gjitha palët: KKK dhe vetë niveli lokal (prefekturat). Kjo mungesë angazhimi në raportim e aq më tepër në zbatim bëhet faktor përcaktues i efekteve të Strategjisë Ndërsektoriale për rezultate të prekshme në luftën kundër korrupsionit.

3. Edhe në ato raste kur aktivitetet e objektivave të një strategjie nuk varen nga disponueshmëria e burimeve financiare (pasi nuk është parashikuar kosto për realizimin e tyre), vihet re se mosrealizmi i tyre është produkt i një punë të pakryer mirë apo i një procesi të porealizuar. Në rastin konkret, Prefektura Fier në raportin e vitit 2017 konfirmon se për objektivin specifik A11.1 "*Në vazhdim jemi në procedurë e sipër për punësimin e një specialisti IT*"<sup>47</sup>, duke mos dhënë asnjë afat kohor për realizimin e një nënobjektivi që pretendohet se e kanë propozuar vetë. Ky koment, me gjithë mangësitë e veta për një planifikim korrekt të punës nga ana e prefekturës për realizimin e objektivave specifike, flet për një mospërfshirje të pushtetit vendor në hartimin e objektivave që ata vetë duhet të realizojnë. Në këtë mënyrë, të gjithë këta objektiva specifike, sado të rëndësishëm të jenë në dukje, bëhen të porealizueshëm ose realizohen fare rastësisht, pa patur një plan të saktë punë për të zbërthyer me tej planin e veprimit.

### **Për këtë rekomandojmë:**

1. KKK aktual të evidentojë përgjegjësitë për mangësitë e shfaqura deri tani, të marrë masa dhe të informojë të gjithë pikat fokale për implementimin e SNKK dhe Planit të Veprimit, mbi raportimin e tyre sipas Matricës së Vlerësimit të Rezultateve.

***Vazhdimisht***

2. KKK të grumbullojë raportimet e të gjithë institucioneve përgjegjëse në zbatimin e Planit të Veprimit, për të gjeneruar raporte sa më të plota të monitorimit.

***Vazhdimisht***

---

<sup>47</sup>Raporti i monitorimit, viti 2017

3. KKK dhe Mekanizmi Monitorues të kujdesen që të monitorojnë raportimin dhe zbatimin e objektivave specifike të secilit objektiv madhor të SNKK dhe Planit të Veprimit, për të siguruar realizim të këtyre masave brenda afateve të parashikuara kohore.

*Vazhdimisht*

### **3.2.2 A janë efektive mekanizmat e Monitorimit dhe të Vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal?**

#### **Gjetje:**

1. MSHMS, megjithëse është institucioni përgjegjës për ngritjen e mekanizmave të monitorimit dhe të vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal, gjatë gjithë periudhës 2015-2017 thjesht ka përcjellë informacionin e marrë nga SHSSH (cilësohet institucion mbështetës në Planin e Veprimit) për tek KKK.
2. Sipas raportimit tek KKK, deri në muajin nëntor 2015 janë kontrolluar 376 njësi vendore (muaji dhjetor është në proces). Janë konstatuar si familje abuzuese në skemën e NE 2.118 familje, me efekt financiar 37.378.596 lekë, si dhe janë konstatuar 541 PAK dhe invalidë pune me probleme, me efekt financiar në shumën 11.783.670 lekë. Në lidhje me shkeljet e konstatuara janë propozuar në bazë të VKM nr. 512, e ndryshuar: 58 vërejtje me shkrim, 11 largime nga puna dhe 21 gjoba. Në zbatim të legjislacionit në fuqi për inspektimin në RSH dhe VKM-së së sipërpërmendur janë realizuar për periudhën janar-nëntor 2015, 91 inspektime në subjektet publike dhe jopublike që ofrojnë shërbime të përkujdesit social për kategoritë në nevojë.  
Shërbimi Social Shtetëror, për periudhën janar-maj 2016, ka realizuar 170 kontrole, nga të cilat janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike 933 familje abuzuese, me efekt financiar 7.442.853 lekë dhe 323 përfitues PAK, me efekt financiar 8.273.283 lekë. Për periudhën korrik-dhjetor 2016, 6-mujori i dytë i vitit 2016, grupet e kontrollit kanë kryer 203 kontrole të njësive administrative. Në kontrole janë konstatuar: 1.265 familje kanë përfituar nga skema e ndihmës ekonomike në kundërshtim me legjislacionin, me efekt financiar 3.843.294 lekë dhe 592 PAK dhe invalidë pune, me efekt financiar 14.195.802 lekë. Nga kjo rezulton se nuk është përfshirë aktiviteti i muajit qershor 2016, duke shfaqur cilësi të dobët raportimi dhe monitorimi, për më tepër që konsiderohet i zbatuar edhe kur nuk raportohet për periudha gjithëvjetore.  
Raportimi për vitin 2017 është i zbrazët, duke cilësuar se janë kryer 392 kontrole dhe rikontrole (për zbatim detyrash) pranë njësive vendore, pa të dhëna të tjera lidhur me numrin e rasteve të referuara dhe proceduara për abuzim, pra mungon njëri prej dy treguesve më të rëndësishëm për aktivitetin e krijimit të mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal.
3. Sipas Raportit të SHSSH për vitin 2016, nga kontrollet e ushtruara kanë rezultuar 2.198 familje që kanë përfituar padrejtësisht ndihmë ekonomike në masën 11.286.147 lekë, 545 persona me aftësi të kufizuara me dëm ekonomik 15.952.657

lekë dhe 371 invalidë në shumën 6.516.398 lekë. Gjithashtu, janë rekomanduar 111 masa disiplinore, si dhe 13 gjoba.

Për vitin 2017, nga kontrollet e ushtruara kanë rezultuar se 1.124 familje kanë përfituar ndihmë ekonomike padrejtësisht 8.828.998 lekë, 462 persona me aftësi të kufizuara me dëm 17.959.608 lekë dhe 330 invalidë për shumën 12.965.448 lekë. Në këto kontrolle janë raportuar 18 masa disiplinore dhe 18 gjoba.

Në mënyrë të përmblëdhur për periudhën 2015-2017 numri i familjeve, numri i PAK dhe numri invalidëve të referuara për abuzim me fondet dhe dëmi përkatës sipas raporteve të SHSSH paraqitet në tabelën e mëposhtme.


**Tabela 10: Rastet dhe vlerat përkatëse të abuzimeve me fondet nga SHSSH 2015-2017**

Emërtimi	2015		2016		2017	
	Numër	Lekë	Numër	Lekë	Numër	Lekë
Familje NE	2598	39.314.426	2198	11.286.147	1124	8.228.998
PAK	283	7.925.163	545	15.952.657	462	17.959.608
Invalidë	444	3.510.965	371	6.516.398	330	12.965.448
Gjithsej	3.325	50.750.554	3.114	33.755.202	1.916	39.154.054

*Burimi:* Të dhëna të raporteve vjetore të SHSSH, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Në mënyrë grafike përmblëdhësja e numrit të rasteve dhe fondet e abuzuara jepen në grafikun e mëposhtëm.

**Grafiku 4: Rastet dhe fondet e abuzuara nga kontrollet e SHSSH 2015-2017**



*Burimi:* Të dhëna të raporteve vjetore të SHSSH të përpunuara nga grupi i auditimit, KLSH

- Sipas raportimeve të MSHMS, treguesi i krijimit të Mekanizmit të Monitorimit dhe vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal, konsiderohet i zbatuar, pasi është një pjesë e aktivitetit institucional të SHSSH. Në këto kushte, ky tregues do të rezultojë i realizuar në vazhdimësi, për sa kohë që SHSSH të ekzistojë si institucion.

5. Konstatohet se nuk jemi në rastin e krijimit të Mekanizmit të Monitorimit dhe të vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe të ndihmës ekonomike në nivel lokal, nga ana e MSHMS, pra në zbatimin e aktiviteteve të PV 2015-2017 të SNKK. Kjo, pasi njëri nga dy treguesit, numri i inspektimeve vjetore, barazohet me kontrollin. SHSSH, në cilësinë e institucionit mbështetës, kryen inspektim vetëm mbi standardet e ofrimit të shërbimeve sociale, dhe jo për të evidentuar raste dhe proceduara në të cilat abuzohet. Veç këtyre, nëse në funksion të zbatimit me sukses të Planit të Veprimit do të ishte rritja e numrit të kontroleve nga SHSSH, ai mbetet i kufizuar. Kjo pasi është kufizuar nga numri i subjekteve që janë objekt kontrolli të përbëra nga 61 bashki dhe 313 njësi administrative, pra nuk mund të ketë rritje të numrit të kontroleve në funksion të treguesve të Planit të Veprimit antikorrupsion 2015-2017. Të gjitha këto shfaqin mangësi të theksuara në hartimin e PV 2015-2017, në funksion të zbatimit të SNKK.
6. Megjithëse nuk rezultojnë specifikisht të krijuara mekanizma të monitorimit dhe të vlerësimit të ofrimit të shërbimit dhe të ndihmës ekonomike në nivel lokal, SHSSH nuk kryen inspektime por kontrole, raportimi i të cilëve ka qenë me mangësi në përmbajtje, afate kohore, etj., duke minimizuar ndjeshëm efektivitetin e tyre në ofrimin e shërbimit dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal.

### **Konkluzione:**

MSHMS (ish-MMSR) është institucioni të cilit i janë vënë detyra në sektorin social për krijimin e mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal (një ndër katër nënobjektivat e objektivit 11 të Strategjisë), ndërsa Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) është në cilësinë e institucionit bashkëpunues për realizimin e tyre. Ky nënobjektiv në Planin e Veprimit ka dy tregues zbatimi: 1. Numri i inspektimeve vjetore; dhe 2. Numri i rasteve të referuara dhe proceduara për abuzim, tregues këto për gjithë periudhën duke filluar nga janari i vitit 2015, si dhe është parashikuar pa kosto shtesë.

1. Në kuptimin klasik, mekanizmi i monitorimit ndihmon në zbatimin efektiv të rregullave, si dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. Monitorimi duhet të identifikojë pengesat dhe të sugjerojë masa të përshtatshme që do të kontribuonin në zbatimin e suksesshëm të rregullave. Kjo arrihet edhe nëpërmjet inspektimeve për kontrollin ose testimin e një çështjeje të caktuar kundrejt standardeve të vendosura. Nga kjo konkludohet se, në praktikë ka një mospërputhje midis mekanizmave të monitorimit dhe të vlerësimit të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike dhe treguesit të inspektimeve dhe rasteve dhe procedurave të referuara për abuzim.
2. MSHMS, lidhur me raportimin e objektivit specifik A11.1, në periudhën 2015-2017 thjesht ka përcjellë informacionin e marrë nga SHSSH për tek KKK, megjithëse është institucion përgjegjës për krijimin e mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal.
3. Aktiviteti i kontrollit të SHSSH, megjithëse është pjesë e funksionit të këtij institucioni publik, për efekt të treguesve të Planit të Veprimit të Strategjisë, janë konsideruar të realizuara si inspektime, duke arritur në konkluzionin e nivelit të ulët të hartimit të strategjisë dhe anës formale të zbatimit të saj, për ta paraqitur se po jep efektet e veta në luftën kundër korrupsionit.

4. Për vitin 2015, një ndër objektivat e programit të qeverisë në fushën sociale ka qenë dhe fuqizimi i kapaciteteve profesionale në nivel qendror dhe rajonal, rritja e transparencës dhe informimit publik mbi aktivitetin e strukturave të SHSSH-së, por në të vërtetë nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me treguesit e objektivit 11 të SNKK (numri i inspektimeve dhe numri i rasteve të referuara dhe të proceduara për abuzim), duke evidentuar që objektivat e programit qeverisës nuk kanë pasur përputhje me ato të SNKK.
5. Strukturat e SHSSH, në vijim kanë synuar për të përmbushur 7 objektiva thelbësore, një ndër të cilat ka të bëjë me shmangien e abuzimeve nga skema e aftësisë së kufizuar, por që përsëri nuk është e plotë krahasuar me treguesit e SNKK, pasi nuk përfshin ndihmën ekonomike dhe për personat me aftësi të kufizuar, të cilat përbëjnë mbi 96% të shpenzimeve gjithsej të alokuara për SHSSH.
6. SHSSH është një institucion publik i cili ka për mision zbatimin e politikave, legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore. Këtë mision e realizon përpos të tjerave, nëpërmjet kontrollit të zbatimit të legjislacionit dhe përdorimit të fondeve buxhetore për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore, të cilën e realizon nga kontrollet e administratës për 12 Zyra Rajonale, dhe prej këtyre të fundit në të gjitha njësitë vendore.<sup>48</sup> Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se, veprimtaria normale e SHSSH për kontrollin e përdorimit të fondeve (një tregues i aktiviteteve të Planit të Veprimit të Strategjisë) konsiderohet në plotësim të objektivave të Strategjisë për Qasjen Parandaluese, çka bën që Strategjia të humbasë vlerat e saj si dokument i rëndësishëm ndërsektorial.

**Për këtë rekomandojmë:**

1. Sekretariati Teknik të marrë masa që për Planin e ri të Veprimit t'i vendosë MSHMS tregues konkretë që lidhen drejtpërdrejtë me krijimin e mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal, në funksion të luftës kundër korrupsionit dhe rritjes së mirëqenies së popullatës.

***Me hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020***

2. Sekretariati Teknik, nëpërmjet MSHMS dhe përfshirjes së saj, të sigurojë monitorim dhe vlerësim periodik të ofrimit të shërbimeve dhe të ndihmës ekonomike në nivel lokal, jo vetëm nga ana e institucioneve mbështetëse.

***Vazhdimisht***

3. Sekretariati Teknik të marrë masa dhe të evidentojë përgjegjësitë në rastin e raportimeve me mangësi dhe jashtë afateve kohore nga ana e MSHMS, dhe kjo e fundit kundrejt institucioneve mbështetëse të vartësisë.

***Vazhdimisht***

---

<sup>48</sup> <http://www.sherbimisocial.gov.al>

4. Sekretariati Teknik dhe MSHMS të marrë masat e nevojshme që në Planin e ri të Veprimit të mundësojë përfshirjen në objektivat qeverisëse dhe ato specifike të Strategjisë kundër korrupsionit.

***Me hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020***

5. Sekretariati Teknik së bashku me Mekanizmin Monitorues të sigurojnë se institucionet përgjegjëse raportojnë për secilën periudhë që duhet përgatitur dhe publikuar raporti i implementimit të SNKK 2015-2020 dhe Planit të Veprimit.

***Vazhdimisht***

6. KKK dhe Mekanizmi monitorues të monitorojnë me rigorozi në se institucionet përgjegjëse përdorin instrumentet e duhura për implementimin e objektivave kryesorë dhe specifike për përmbushjen e SNKK 2015-2020.

***Vazhdimisht***

### **3.2.3 A realizohet ofrimi i shërbimeve administrative përmes sporteleve unike në nivel vendor?**

Aktiviteti i Planit të Veprimit për krijimin e “one stop shop” në nivel vendor për ofrimin e shërbimeve dhe/ose lehtësimi i procedurave për marrjen e shërbimeve ka parashikuar treguesit e zbatimit:

- a) Inventarizimi i shërbimeve aktuale;
- b) Identifikimi i shërbimeve parësore për t’u ofruar;
- c) Adoptimi i modifikimeve të nevojshme ligjore për ofrimin e shërbimeve në formë elektronike; dhe
- d) Ngritja e qendrës për ofrimin e shërbimeve në modelin “one stop shop”.

Ky aktivitet është programuar në sektorin e çështjeve vendore, me institucione përgjegjëse bashkitë e vendit, si dhe institucion bashkëpunues ish-Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore (MSHCV), me afat përfundimi vitin 2017, si dhe pa kosto shtesë.

Nëpërmjet realizimit të këtij aktiviteti bëhet e mundur reduktimi i kontakteve personale të përdoruesve/kërkuesve të shërbimit me një numër të konsiderueshëm të nëpunësve të administratës, garantimi i një shërbimi cilësor, si dhe kontribuon në uljen e nivelit të korrupsionit në këtë nivel të qeverisjes. Gjithashtu, sjell modernizimin e shërbimeve publike, duke thjeshtuar e integruar procedurat komplekse dhe unifikuar ofrimin e tyre në një qendër të vetme. Mosrealizimi ose realizimi me vonesë i këtij aktiviteti sjell pasoja korruptive në administratën publike në nivel vendor, duke cenuar mirëqenien e qytetarëve. Veç kësaj, kryerja me shpenzime të këtij aktiviteti tregon më së paku për mangësi në hartimin e Planit të Veprimit, thëllim të deficitit të kostos së zbatimit të Planit të Veprimit dhe komprometon zbatimin e SNKK.

Shqyrtimi dhe analiza e çështjes së ofrimit të shërbimeve administrative përmes sporteleve unike në nivel vendor është kryer duke vlerësuar zbatimin mbi bazën e raporteve të monitorimit 2015–2017, si dhe mbledhjes dhe shqyrtimit të dokumenteve zyrtare dhe burimeve të tjera. Gjithashtu janë realizuar vizita në terren në bashkitë Tiranë, Shkodër dhe Fier, krahas takimeve, komunikimit dhe intervistimit të personave përgjegjës për raportimin e zbatimit të kësaj mase.

**Gjetje:**

1. Sipas Raportit Vjetor të marsit 2016 për vitin 2015, në përgjithësi është vërejtur se raportimi në raundet e para jo vetëm që ka zgjatur, por ka qenë i paplotë dhe/ose i paqartë<sup>49</sup>, si dhe verifikimi i të dhënave të raportuara është kryer pjesërisht në Internet dhe pjesërisht në bashkëpunim me KKK për të siguruar saktësinë e tyre<sup>50</sup>. Në vitin 2015, është raportuar se sportelet unike për shërbimet administrative janë duke u pilotuar në bashkitë Elbasan, Durrës, Korçë, Lezhë dhe Shkodër, procesi i cili do të vazhdonte deri në dhjetor 2015 dhe do të shërbente si një model aplikimi në bashkitë e tjera. Nga sa më sipër konstatohet se, megjithëse Raporti i monitorimit përfshin periudhën prill-dhjetor 2015, raportimi shprehet i pasigurtë mbi pilotimin gjatë muajit dhjetor të këtij viti.<sup>51</sup> Veç kësaj, nuk është raportuar për treguesit e zbatimit të kësaj mase si: inventarizimi i shërbimeve aktuale, identifikimi i shërbimeve parësore për t'u ofruar, adoptimi i modifikimeve të nevojshme ligjore për ofrimin e shërbimeve në formë elektronike etj. KKK nuk ka njohuri mbi ecurinë e kësaj mase në 82% të bashkive të vendit ose në 56 bashki nga 61 gjithsej.

Pavarësisht se ky aktivitet ishte planifikuar të përfundonte në vitin 2017, nuk mund të konsiderohet i nisur për të influencuar uljen e korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore, si dhe komprometon realizimin e tij në afat.

2. Sipas Raportit të monitorimit për vitin 2016, kjo masë vlerësohet pjesërisht e zbatuar, pasi është kryer pilotimi, dhe në vijim do të prokurohet kompania që do të implementojë “one stop shop” në të gjithë Shqipërinë. Gjithashtu, po sipas raportit, përcaktohet afat i ri zbatimi që pritet të jetë 3- mujori i katërt i vitit 2018, me kosto totale të zbatimit që pritet të jetë 2 milionë US\$.

Një përshkrim i tillë në Raportin e monitorimit për vitin 2016 tregon mungesë serioziteti dhe mungesë vullneti për ulur nivelin e korrupsionit dhe për pasojë dhe të zbatimit të kësaj strategjie nga ana e njërive të pushtetit vendor.

Nga ana tjetër edhe KKK nuk ka vlerësuar dhe analizuar situatën për zbatimin e këtij aktiviteti dhe ndikimin e tij në objektivin A.11 dhe SNKK në tërësi.

Formulimi i raportimit të progresit të këtij aktiviteti tregon që raportet vjetore nuk kanë vijueshmëri, pasi pilotimi në 5 bashki duhet të kishte përfunduar në vitin 2015 dhe gjatë vitit 2016 nuk ka pasur asnjë veprimtari, pasi cilësohet se është kryer pilotimi.

Gjithashtu këtu nuk ka asnjë element monitorimi, pasi më shumë përqendrohet në atë se çfarë do të bëhet në të ardhmen. Për më tepër që KKK i jep të drejtën vetes të shtyjë afatin e parashikimit të realizimit me një vit dhe të llogarisë koston e parashikuar me 2 milionë US\$, nga pa kosto në Planin e Veprimit.

3. Raporti i monitorimit të Strategjisë për vitin 2017 vazhdon ta konsiderojë këtë masë pjesërisht të zbatuar. Sipas raportimeve janë ngritur zyrat me një ndalesë për ofrimin e shërbimeve administrative në nivel vendor përmes sporteleve unike në 12 bashki: me mbështetjen e DLDP-së (financuar nga SDC-Qeveria Zvicerane) në 5 bashki dhe atë të PLGP (USAID) në 6 bashki, ndërkohë që Bashkia e Urës Vajgurore

---

<sup>49</sup> Raportime të realizuara në kuadër të mekanizmit të Pikave të Kontaktit Antikorrupsion në Prefektura.


<sup>50</sup> Raport monitorimi 2015, mars 2016, përgatitur me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

<sup>51</sup> Raporti i monitorimit 2015, faqe 10, mars 2016.

e ka ngritur nëpërmjet buxhetit të bashkisë. Konsiderohet problematike për t'u zgjidhur në të ardhmen "Inventarizimi i shërbimeve aktuale" dhe "Identifikimi i shërbimeve parësore për t'u ofruar", si pjesë e fazës së vlerësimit të situatës në bashki dhe analizës së biznesit, e cila pritet të përfundojë në janar të 2018. Ngritja e qendrës për ofrimin e shërbimeve në modelin "one stop shop" në 49 bashkitë e mbetura pritet që të finalizohet në fund të vitit 2019, pra 2 vjet më vonë se sa ishte parashikuar në Planin e Veprimit 2015-2017.

Gjithashtu, cilësohet si një nga arritjet kryesore në objektivat e Qasjes Parandaluese krijimi i 4 qendrave të ofrimeve të shërbimeve si sportel unik dhe në total. Në sportelet e administruara nga ADISA ofrohen 344 shërbime publike, të institucioneve qendrore, vendore dhe të pavarura. Nga ky raportim konstatohet se nuk kemi të bëjmë thjesht dhe vetëm me institucionet vendore, por dhe ato qendrore e të pavarura, që nuk duket të ketë lidhje të drejtpërdrejtë me kryerjen e aktiviteteve në kuadrin e realizimit të objektivit për "Adoptimin e politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore".

**Grafiku 5: Ecuria e ngritjes së sporteleve unike nga bashkitë 2015-2017**



*Burimi:* Të dhëna të raporteve të monitorimit të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

4. Nga vizitat në terren, në bashkitë qendër qarku të Tiranës, Shkodrës dhe Fierit, konstatohet se është zbatuar krijimi i sporteleve unike, për të cilën bashkia Shkodër ishte vlerësuar dhe me çmim për shërbim dhe transparencë në këto zyra.

*Foto nr. 1* Ambiente të sportelit unik në bashkinë Fier



*Burimi:* Grupi i auditimit të KLSH

### **Konkluzione:**

1. Realizimi i sporteleve unike në të gjitha bashkitë e vendit nuk është realizuar në afat brenda vitit 2017, sipas parashikimeve në Planin e Veprimit për 49 bashki nga 61 gjithsej, ose është realizuar në vetëm  $\frac{1}{4}$  e tyre. Duhet theksuar se në raportimet e vitit 2016 dhe 2017 përfundimi është shtyrë me një vit, në kundërshtim me parashikimet e Planit të Veprimit.
2. Ka mangësi në cilësinë e raportimeve 2015-2017 të pikave të kontaktit të prefekturave dhe të pranuar nga KKK, si për sa i përket vijueshmërisë, periudhave, numrit të bashkive për të cilat raportohet, ashtu edhe elementëve që e përbëjnë këtë aktivitet si: inventarizimeve i shërbimeve, konsiderimi i atyre parësore, etj., duke evidentuar njëkohësisht edhe mungesën e monitorimit të ecurisë së zbatimit të objektivit për krijimin e sporteleve unike.
3. Ndryshe nga sa ishte parashikuar fillimisht në Planin e Veprimit si një aktivitet pa kosto shtesë, në raportimet e mëvonshme është vendosur një kosto e përafërt prej 2 milionë US\$, çka tregon për mangësi të theksuara në hartimin Planit të Veprimit dhe probleme të mëdha në realizimin e Strategjisë, në kushtet kur edhe kostoja e parashikuar nuk ishte e mbuluar plotësisht me fondet përkatëse.
4. Niveli i ndërgjegjësimit të institucioneve të përfshira në Strategji, në raport me zbatimin e Planit të Veprimit, bazuar në raportimin e kryer nga vetë këto institucione, rezulton të jetë i ulët, edhe për shkak të aktorëve të ndryshëm në zbatim dhe raportim.
5. Ka munguar monitorimi dhe koordinimi ndërinstytucional, duke ndikuar negativisht në rritjen e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga strukturat e brendshme të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve përkatëse të Planit të Veprimit të SNKK.

Në këto kushte, Strategjia ndërsektoriale kundër korrupsionit, nuk ka arritur të përballojë sfidën e transparencës në veprimtarinë shtetërore, për të mundësuar një kontroll më të plotë nga ana e publikut.

### **Për këto rekomandojmë:**

1. KKK të evidentojë përgjegjësitë për mosrealizimin e treguesit të krijimit të sporteleve unike brenda afatit të përcaktuar në PV, si dhe të sigurojë saktësinë e raportimeve të të gjithë institucioneve përgjegjëse për të gjeneruar një raport vjetor sa më cilësor.

***Brenda muajit tetor 2018 dhe vazhdimisht***

2. KKK, në Planin e ri të Veprimit të vendosë afate dhe kosto reale që të garantojnë zbatimin me sukses të Strategjisë për krijimin e sporteleve unike deri në nivelin e njësisive administrative.

***Me hartimin e Planit të ri të Veprimit***

3. Sekretariati Teknik të hartojë një raport të veçantë lidhur me efektet që ka në zbatimin e SNKK roli dhe përgjegjësia e institucioneve shtetërore që zbatojnë dhe raportojnë ecurinë e implementimit të treguesve të Planit të Veprimit.

***Brenda vitit 2018***

4. KKK dhe Sekretariati Teknik të monitorojnë dhe të koordinojnë krijimin sporteleve me një ndalesë për shërbimet administrative në njësitë e pushtetit lokal, si një nga elementët e rëndësishëm të adoptimit të politikave kundër korrupsionit në nivel vendor.

**Vazhdimisht**

### **3.3 Cili është perceptimi i opinionit publik dhe palëve të tjera për politikat e ndërmarra kundër korrupsionit në qeverisjen vendore?**

“Përprojekte të mëtejshme të vendosura në luftën kundër korrupsionit”<sup>52</sup> është prioriteti i tretë kyç i kërkuar Shqipërisë për të vazhduar rrugëtimin e saj drejt integritit në BE. Në raportin e vlerësimit të publikuar në Prill të 2018<sup>53</sup> nga Komisioni Evropian, korrupsioni në Shqipëri konsiderohet si gjerësisht i përhapur dhe se mbetet një çështje shqetësuese. Lidhur me luftën kundër korrupsionit dhe realizimin e prioritetit, Komisioni Evropian vlerëson se: “Impakti i masave të ndërmarra mbetet ende për t’u parë”. Në vijim të politikave dhe instrumenteve antikorrupsion të ndërmarra nga qeveria, me fokus prioritetin e tretë të kërkuar nga BE është edhe Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 dhe Plani i Veprimit 2015-2017. Në këtë strategji<sup>54</sup>, matësi i suksesit apo dështimit të politikave dhe programeve të qeverisë në luftën kundër korrupsionit dhe tregues i gjendjes reale të këtij të fundit, përcaktohet perceptimi i publikut. Për këtë arsye, grupi i auditimit ka gjykuar të rëndësishme njohjen e perceptimit të publikut dhe palëve të tjera lidhur me korrupsionin dhe politikat e ndërmarra për ta luftuar atë. Për të identifikuar perceptimin mbi korrupsionin, G.A. ka përdorur:

- Vlerësime të publikuara për Shqipërinë nga indekse dhe raporte ndërkombëtare. Indekse dhe raporte këto, të cilave SNKK i referohet për të matur arritjen e objektivave.
- Pyetësor drejtuar qytetarëve,
- Pyetësor drejtuar OJF-ve në rang kombëtar,
- Pyetësor drejtuar OJF-ve me projekte fituese, me tematikë luftën kundër korrupsionit,
- Intervista me përfaqësuesit e tre OJF-ve më aktive<sup>55</sup> në këtë Strategji.

Në SNKK 2015-2020 janë përcaktuar si matës të arritjeve të synimeve të strategjisë, treguesit/indiktorët e mëposhtëm:

- a) *Indeksi i perceptimit të korrupsionit CPI i publikuar nga Transparency International.* Ky indeks rendit rreth 180 shtete bazuar në nivelin e korrupsionit në qeverisjes, që një shtet besohet se ka. Për shkak të kufizimeve<sup>56</sup> që ka ky tregues në përdorimin e renditjes për të matur nivelin e perceptuar të

<sup>52</sup><https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf> fq. 5

<sup>53</sup><https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>

<sup>54</sup> SNKK 2015-2020 fq. 7 hyrja.

<sup>55</sup>Në takimet e zhvilluara nga G.A me përfaqësues të MD-së, këta të fundit i referohen shpesh raporteve të publikuara nga TI, IDM dhe IDRA.

<sup>56</sup>Me shtimin e një shteti të ri në listën e vendeve për të cilat publikohet CPI renditja e vendeve të tjera mund të ndryshojë pa ndryshuar niveli i perceptimit të korrupsionit.

korrupsionit sugjerohet përdorimi i pikëve të shënuara nga secili shtet (nga 0 - tepër i korruptuar në 100 - tepër i pastër) dhe jo renditja. Në këtë indeks, Shqipëria duhet të shënojë rritje të qëndrueshme (1.5-2.5 pikë) çdo vit, duke nisur nga 33 pikë të shënuara në 2015, për të arritur 37.5 në 2017.

- b) *Kontrolli i korrupsionit*. Banka Botërore çdo vit publikon 6 indikatorë për 6 dimensione të qeverisjes. Kontrolli i korrupsionit është një prej këtyre 6 indikatorëve i cili përfaqëson shtrirjen e korrupsionit në qeverisje. Bazuar në këtë indikator, në 2017-ën Shqipëria duhet të performojë më mirë se 34% e vendeve për të cilat publikohet “Kontrolli i Korrupsionit”.
- c) *Studimi mbi performancën e mjedisit të sipërmarrjes dhe të investimeve*, Banka Botërore. Sipas këtij treguesi, Korrupsioni në Shqipëri në 2017 nuk duhet të përbëjë një ndër 3 pengesat më të rëndësishme për biznesin
- d) *Raporti Nations in Transit (FH)*. Ky është një raport vjetor i cili publikohet për 29 vende ish-komuniste të Evropës e Azisë dhe jep vlerësime për 7 kategori si: Pavarësia e mediave, shoqëria civile, korrupsioni, etj. Vlerësimi për korrupsionin në Shqipëri në 2017 duhet të arrijë vlerën 4.5.
- e) *Rekomandimet e GRECO për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe parlamentarëve*. GRECO është Grupi i Vendeve Kundër Korrupsionit i Këshillit të Evropës, i cili në 2014-ën ka dhënë 10 rekomandime me temë: “Parandalimi i korrupsionit në lidhje me anëtarët e parlamentit, gjykatësit dhe prokurorët”. Në 2017-ën Shqipëria duhet të ketë zbatuar plotësisht rekomandimet e raundit të IV të GRECO.

Mbështetur në SNKK 2015-2020, arritja e synimeve të Strategjisë do të matet me anë të arritjes së rezultateve të parashikuara për secilin nga treguesit e sipërpërmendur. Me anë të krahasimit të rezultateve faktike të arritura në 2017 nga vendi ynë, me rezultatet e parashikuara dhe synuara në strategji, G.A ka vlerësuar arritjen e synimeve të strategjisë dhe efektivitetin e politikave antikorrupsion të ndërmarra, në kuadër të këtij dokumenti strategjik.

Treguesit si CPI, Nations in Transit, etj., janë indekse ndërkombëtare të cilat në qendër të metodologjisë së përdorur për të nxjerrë vlerësimet në pikë/njësi kanë matjen e perceptimit mbi korrupsionin me anë të pyetësorëve apo intervistave me qytetarë në të gjithë vendin. Vlerësimet e publikuara nga këta tregues japin informacion mbi fenomenin e hasur në qeverisjen e një vendi në përgjithësi. Meqenëse fokusi i këtij auditimi është korrupsioni dhe politikat kundër korrupsionit në qeverisjen vendore, G.A realizoi pyetësorë drejtuar qytetarëve në rang republike në linjë me pyetjet e përdorura nga indekset e sipërpërmendura. Qëllimi ishte identifikimi i perceptimit të qytetarëve lidhur me korrupsionin dhe adoptimin e politikave antikorrupsion veçanërisht në qeverisjen vendore. Pyetësori u shpërnda *online* dhe u plotësua nga qytetarë të grup moshave të ndryshme (mbi 18 vjeç), në të gjitha qarqet. Opinioni i 180 qytetarëve i mbledhur nëpërmjet këtij pyetësori u përpunua dhe u analizua nga G.A. Analiza e detajuar është trajtuar në pyetjen 3.3.1.

Komisioni Evropian në raport vlerësimin (Prill 2018) e Shqipërisë, mbi realizimin e prioritetëve të përcaktuara nga BE (dy prej tyre i referohen korrupsionit), cilëson si të domosdoshëm konsultimin e shoqërisë civile vendase: “Nevojiten përpjekje thelbësore për të siguruar konsultime domethënëse me aktorët e shoqërisë civile si

pjesë e një dialogu gjithëpërfshirës të politikave”<sup>57</sup>. Gjithashtu, lidhur me përfshirjen e OJF-ve vendase OECD<sup>58</sup> cilëson procesin e monitorimit të Planit të Veprimit të qeverisë nga organizata jofitimprurëse/ joqeveritare si, të domosdoshëm jo vetëm për monitorimin dhe dhënien e rekomandimeve për të zhvilluar aktivitetet në drejtimin e duhur, por edhe si një mjet për të influencuar qeverisjen e vendit, duke rritur kështu efektivitetin e politikave antikorrupsion. Ndërsa, “Përfshirja në mënyrë të gjerë dhe të rëndësishme të shoqërisë civile, ...”<sup>59</sup> është një prej objektivave që SNKK synon të arrijë. Në dokumentin strategjik të saj është përcaktuar se SNKK është hartuar bazuar në eksperiencat e gjithë aktorëve që kanë patur një rol në të. Shoqëria civile është përfshirë në procesin e hartimit/zhvillimit dhe zbatimit/ monitorimit të SNKK 2015-2020 dhe PV 2015-2017. Për arritjen e këtij të fundit, KKK ka patur përgjegjësinë të përdori të gjitha platformat e mundshme.<sup>60</sup>

Për sa më sipër, G.A konsultoi edhe opinionin e OJF-ve, si një prej aktorëve kyç në këtë strategji. Me qëllim identifikimin e perceptimit mbi korrupsionin jo vetëm nga vlerësimet ndërkombëtare dhe opinionin i drejtpërdrejtë i qytetarëve, por edhe nga palë të tjera si p.sh. shoqëria civile, u hartua dhe shpërnda një pyetësor *online* drejtuar 600 OJF-ve të regjistruara tek Agjencia në Mbështetje të Shoqërisë Civile (AMSHC)<sup>61</sup>. Për të mbledhur reflektime apo opinione më konkrete, më të orientuara drejt luftës kundër korrupsionit, G.A hartoi dhe shpërndau edhe një pyetësor me pyetje të hapura drejtuar 18 OJF-ve me të paktën një projekt fitues, me tematikë luftën kundër korrupsionit. AMSHC ka alokuar fonde për realizimin e këtyre projekteve, në kuadër të SNKK. Përveç sa më sipër, G.A kontaktoi dhe realizoi edhe 3 intervista me përfaqësues nga TIA<sup>62</sup>, IDM dhe IDRA, si tre prej OJF-ve më aktive lidhur me tematikën e korrupsionit në Shqipëri.

### **3.3.1 Si është perceptimi i opinionit publik mbi adoptimin e politikave kundër korrupsionit nga zyrtarët vendorë?**

Qytetarët, si "përfituesit" kryesorë të shërbimeve në administratën publike janë në kontakt të drejtpërdrejtë me fenomenin e korrupsionit në njësitë e qeverisjes vendore. Perceptimi që ata kanë lidhur me korrupsionin dhe politikën antikorrupsion të ndërmarra është matësi dhe treguesi më domethënës i arritjeve në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Me anë të pyetësorit drejtuar qytetarëve (të përshkruar më herët), *G.A ka mbledhur perceptimet e individëve mbi aktivitetet antikorrupsion të cilat, bazuar në Planin e Veprimit të Strategjisë, duhet të ishin adoptuar në periudhën 2015 - 2017 në qeverisjen vendore.* Fillimisht, nëpërmjet këtij pyetësori G.A. synoi të identifikojë shkallën e informimit të publikut lidhur me Strategjinë dhe politikën e adoptuara antikorrupsion në institucionet qeverisëse, si dhe

---

<sup>57</sup><https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>  
Fq. 11

<sup>58</sup><http://www.oecd.org/corruption/acn/ACN-Civil-Society-Monitoring-Practical-Guide-ENG.pdf> Fq. 8

<sup>59</sup>SNKK 2015-2020 Fq 15

<sup>60</sup>SNKK, fq. 27

<sup>61</sup> AMSHC është ent publik qendror, buxhetor, i përkufizuar ndryshe si “autoritet financues”, sepse shpërndan fonde nga buxheti i vet, për mbështetjen e shoqërisë civile. Misioni themelor i saj është nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimi i kushteve të favorshme për nisma civile, në të mirë dhe në interes të publikut.

<sup>62</sup> Nga kontakti me përfaqësuesin e TIA, G.A mësoi se kjo e fundit prej 5 vitesh nuk operon më në Shqipëri

perceptimin e tyre lidhur me adoptimin e këtyre politikave dhe korrupsionin, në qeverisjen vendore.


Nga përpunimi statistikor i përgjigjeve të pyetësorit, rezultoi se: 78% e të pyeturve pohojnë se në njësitë e tyre vendore kryhet korrupsion, 61% prej të cilëve e bazojnë përgjigjen në eksperiencën personale. Pjesa tjetër tregojnë se të afërmit apo të njohurit e tyre, e kanë hasur këtë fenomen. Gjithashtu, mediat apo historitë e dëgjua nga të tjerë, janë cilësuar si burime informimi.

*Këto të dhëna ndihmojnë grupin e auditimit në krijimin e një konkluzioni të përgjithshëm se një pjesë e konsiderueshme e publikut, korrupsionin e ka identifikuar gjatë kontakteve të drejtpërdrejta me institucionet publike, si p.sh. marrja e një certifikate, lejeje, etj. Pavarësisht se një pjesë e konsiderueshme e individëve e kanë hasur këtë dukuri në vetë të parë, mosdenoncimi nga ana e publikut i këtyre rasteve, i cili zë një peshë të konsiderueshme, rreth 76% (nuk e kanë denoncuar korrupsionin), ka ndikuar negativisht në reduktimin e këtij fenomeni.*

Të pyetur mbi trendin e korrupsionit në 3-vjeçarin e fundit në qeverisjen e tyre vendore, 47% e individëve të përgjigjur kanë gjykuar se korrupsioni është rritur në tre vitet e fundit, ndërsa 21% mendojnë se ka mbetur i pandryshuar; përgjigjet në përqindje paraqiten në grafikun e mëposhtëm.

*G.A., bazuar në këto përgjigje dhe në të dhënat e nxjerra nga dy indekset, CPI dhe FH (të trajtuara më gjerësisht në pyetjen 3.3.2), krijon mendimin se politikat antikorrupsion të ndërmarra në qeverisjen vendore nuk kanë dhënë efekt për të ulur korrupsionin në perceptimin e qytetarëve.*

### Grafiku 6: Perceptimi i qytetarëve mbi korrupsionin në qeverisjen vendore




Burimi: Të dhënat nga pyetësori i plotësuar nga qytetarët, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Korrupsioni në qeverisjen vendore, për shumicën e qytetarëve, konsiston në përfitimet personale dhe politike (përfitim i organizuar i zyrtarëve për të ruajtur pushtetin politik) të zyrtarëve publikë, ndërsa për 13% të tyre shkak i korrupsionit është: financimi i aktiviteteve kriminale (terrorizmit, kultivimit të bimëve narkotike, grupeve mafioze, etj.). Më konkretisht format e korrupsionit, janë të radhitura më poshtë:

1. Marrja dhe dhënia e ryshfeteve (77%<sup>63</sup>)
2. Rekrutimi dhe favorizimi i padrejtë i burimeve njerëzore (76%)
3. Vendim-marrja e padrejtë në favor të grupeve të caktuara të interesit (75%)
4. Përvetësimi i fondeve publike përmes prokurimeve të padrejta (69%)
5. Keq-alokimi i burimeve natyrore. (65%)

Çka rezulton nga shifrat e mësipërme sipas gjykimit të G.A. është se deri më sot, *institucionet e qeverisjes vendore nuk kanë marrë masat e duhura për parandalimin, reduktimin deri në eliminimin e dukurive të mësipërme*. P.sh. krijimi i qendrave “one stop shop”<sup>64</sup> për ofrimin e shërbimeve administrative do të kishte dhënë efekt pozitiv në uljen e marrjeve dhe dhënive të ryshfeteve, e cila është dhe forma më e përhapur e korrupsionit në nj.q.v. Në mënyrë më të detajuar, format kryesore të korrupsionit paraqiten në grafikun e mëposhtëm.

**Grafiku 7: Format më të përhapura të korrupsionit në qeverisjen vendore**



Burimi: Të dhënat nga pyetësi i plotësuar nga qytetaret, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Gjithashtu, nga pyetësi rezulton se: një pjesë e konsiderueshme, rreth 74% e të pyeturve nuk janë të informuar mbi politikën antikorruption që duhet të adoptohen nga qeverisja vendore.

*Kjo e dhënë, së bashku me informacionin se “nuk ka patur aktivitete të zhvilluara nga Prefektura mbi informimin e publikut lidhur me politikën antikorruption të ndërmarra në qeverisjen vendore, në kuadër të SNKK 2015-2020”, e marrë nga intervista e zhvilluar me përfaqësues të Prefekturës Tiranë, krijon bindjen e arsyeshme tek grupi i auditimit se:*

<sup>63</sup> 77% nga të përgjigjurit vlerësojnë si mesatarisht, shumë dhe ekstremisht të përhapur këtë formë të korrupsionit në njësitë e qeverisjes vendore.

<sup>64</sup> Një ndër 6 aktivitetet e përcaktuara në PV për t’u ndërmarrë në qeverisjen vendore me qëllim parandalimin e korrupsionit. Plani i Veprimit 2015-2017, fq. 53


*aktiviteti i institucioneve qeverisëse lokale nuk ka qenë i mjaftueshëm për të informuar publikun mbi politikat antikorrupsion.*

Në Planin e Veprimit 2015-2017, të bashkëlidhur me Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, nënobjektivat<sup>65</sup> e vendosur për të parandaluar korrupsionin dhe arritur qëllimet e Strategjisë, në njësitë e qeverisjes vendore janë:

- Krijimi i faqeve WEB të përditësuara,
- Krijimi i mekanizmit të monitorimit dhe ofrimit periodik të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal,
- Publikimi në ambientet publike dhe Internet të prefekturave, të buxheteve dhe shpenzimeve të çdo komune dhe bashkie në qark,
- Krijimi i regjistrit tematik të ankesave,
- Ofrimi i shërbimeve administrative në nivel vendor përmes sporteleve unike,
- Publikimi në ambientet publike të çdo prefekturë të akteve nënligjore të miratuara nga bashkitë përkatëse të qarkut në mjediset publike.

Për të identifikuar nëse aktivitetet e mësipërme janë adoptuar apo jo në njësitë e qeverisjes vendore sipas perceptimit të publikut, G.A. ka mbledhur nëpërmjet pyetësorit këto vlerësime: Një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve nuk kanë informacion mbi realizimin e këtyre aktivitete (për secilin nga aktivitetet e paraqitura në grafikun e mëposhtëm, mesatarisht 40% e qytetarëve nuk kanë informacion). Midis atyre që kanë informacion (rreth 60% e totalit), pjesa dërrmuese, tregojnë se shumica e aktiviteteve të mësipërme<sup>66</sup> nuk janë realizuar. Ndërsa, individët të cilët e konsiderojnë të realizuar objektivin, frekuencën e realizimit e tregojnë sporadike.

**Grafiku 8: Masa e zbatimit nga qeverisja vendore e nënobjektivave të PV**



Burimi: Të dhënat nga pyetësi i plotësuar nga qytetarët, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

<sup>65</sup> Shpesh herë në strategji i gjeni me emërtimin aktivitetet.

<sup>66</sup> Për 3 nga 5 aktivitetet e listuar, përqindja e “Nuk e ka realizuar” është me e madhe se shumica e përqindjeve midis: “E realizon në mënyrë sporadike” dhe “E realizon me rigorozitet”.

Bazuar në perceptimin e përgjigjeve mbi masën e realizimit, nënobjektivat radhiten si vijon:

1. Krijimi i faqeve WEB të përditësuara (35%<sup>67</sup>),
2. Krijimi i sporteleve unike (*one stop shop*) për ofrimin e shërbimeve vendore (32.5%),
3. Monitorimi dhe vlerësimi periodik i ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike (28.5%),
4. Publikimi në mjediset publike dhe Internet i buxheteve dhe shpenzimeve vendore (27.8%),
5. Publikimi i akteve nënligjore në mjediset publike (26.8%).

Gjithashtu, G.A. ka kërkuar opinionin e qytetarëve se sa mund të parandalojnë korrupsionin midis niveleve të ndryshme hierarkike të nëpunësve shtetërorë këto aktivitete. Nga analizimi i të dhënave rezultoi se: shumica e individëve mendojnë se masat e mësipërme kanë aspak apo pak aftësi për të parandaluar korrupsionin, si për zyrtarët e lartë, ashtu edhe për punonjësit e thjeshtë të administratës në qeverisjen vendore. Vetëm 18% e individëve që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje, gjykojnë se këto masa kanë aftësi të mirë dhe shumë të mirë për të parandaluar korrupsionin midis zyrtarëve të lartë (p.sh. Kryetar Bashkie, Drejtor i Përgjithshëm, etj.), të mesëm dhe të ulët (p.sh. Drejtor Drejtorie/Shef Sektori) dhe 22% mendojnë se këto masa kanë aftësi të mirë ose shumë të mirë për të parandaluar korrupsionin në punonjësit e administratës.

*Pra, në opinionin e publikut këto masa nuk japin efektin e duhur në “ç’rrënjosjen e korrupsionit nga rradhët e administratës publike dhe të të gjithë segmenteve shtetërore”, i cili është edhe synimi kryesor i qasjes parandaluese, qasja me nivelin më të lartë të buxhetit në SNKK.*

Parë në tërësi, lufta për parandalimin, reduktimin dhe deri në eliminimin e korrupsionit nuk do të mjaftonte vetëm me punën e institucioneve publike, por duhet një bashkëpunim i ngushtë dhe me aktorët e tjerë si shoqëria civile, institucione të pavarura, etj. Për të vlerësuar se cili është kontributi i secilit prej aktorëve kryesorë në luftën ndaj korrupsionit, G.A. ka kërkuar dhe vlerësuar opinionin e publikut. Sipas kontributit të dhënë për këtë problem ekonomik-social, aktorët radhiten:

1. Qytetarët (56.1%<sup>68</sup>)
2. Kontrolli i Lartë i Shtetit (53.5%)
3. Organizatat jofitimprurëse (33%)
4. Bashkia ku bëjnë pjesë (30.2%)
5. Ministria e Drejtësisë (26.6%)
6. Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore (24.3%)

Mbështetur në perceptimin e qytetarëve vërehet se: *Koordinatori i mëparshëm kundër korrupsionit, Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore dhe Koordinatori i ri, Ministria e Drejtësisë, janë aktorët me kontribut më të ulët në luftën kundër korrupsionit.*

---

<sup>67</sup> Kjo përqindje është një shumatorë midis: “E realizon në mënyrë sporadike” dhe “E realizon me rigorozitet”. Për aktivitetin i cili vlerësohet më i realizuari, 25.5% e qytetarëve tregojnë se realizohet në mënyrë sporadike

<sup>68</sup> Këto përqindje janë rezultat i shumës së përgjigjeve, “Performancë mesatare”, “Performancë e mirë në luftën kundër korrupsionit” dhe “Performancë shumë e mirë”, për secilin prej aktorëve.

***Në përfundim të trajtimit, G.A konkludon se:***

1. Mosrealizimi i takimeve informuese me qytetarët nga Prefekturat, mbi aktivitetet antikorrupsion të ndërmarra në kuadër të PV dhe SNKK, ka ndikuar negativisht në njohjen e këtyre të fundit nga publiku. Si pasojë, Strategjia nuk ka dhënë efektin e duhur në motivimin e individëve për të denoncuar rastet e konstatuara të korrupsionit.
2. Pamundësia për të parandaluar korrupsionin midis zyrtarëve të niveleve të ndryshme hierarkike me anë të masave të përcaktuara në P.V, sëbashku me mosadoptimin e politikave, apo adoptimin jo në frekuencën e duhur, nuk ka dhënë efektin e pritur në perceptimin e qytetarëve lidhur me korrupsionin, duke shkaktuar që ky i fundit të mbetet i njëjtë apo të jetë në rritje në njësitë e qeverisjes vendore në tre vitet e fundit.

***Për këtë rekomandojmë:***

1. Realizimin e takimeve informuese me qytetarët, nga Prefekturat, me qëllim informimin e publikut lidhur me aktivitetet antikorrupsion të adoptuara në kuadër të SNKK 2015–2020.

***Vazhdimisht***

2. Të ndërmerren masa nga prefekturat për adoptimin e aktiviteteve A11.1, A11.3, A11.4 dhe A11.6 të përcaktuara në Planin e Veprimit 2015-2017<sup>69</sup>.

***Menjëherë***

3. Të ndërmerren masa nga bashkitë për adoptimin e aktivitetit A11.5 të përcaktuar në Planin e Veprimit 2015-2017<sup>70</sup>.

***Menjëherë***

4. Të monitorohet me rigorozitet nga KKK adoptimi i objektivit A11 nga prefekturat dhe bashkitë.

***Vazhdimisht***

5. Të merren në shqyrtim nga KKK format më të përhapura të korrupsionit në qeverisjen vendore<sup>71</sup>, dhe të rivlerësohen aktivitetet antikorrupsion të përcaktuara në nënobjektivin A11 nëse i parandalojnë këto forma. Nëse jo, të ndërmerren masat më emergjente dhe të domosdoshme në përgjigje të tyre dhe të përfshihen në Planin e ri të Veprimit.

***Me hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020***

**3.3.2 Cili është opinioni i shoqërisë civile mbi korrupsionin në qeverisjen vendore?**

Sipas Bankës Botërore<sup>72</sup>, shoqëria civile konsiderohet: “Një grup i gjerë i organizatave joqeveritare dhe jofitimprurëse që kanë një prezencë në jetën publike, duke shprehur

---

<sup>69</sup> Plani i Veprimit 2015-2017, fq 53.

<sup>70</sup> Plani i Veprimit 2015-2017, fq 53


<sup>72</sup>[http://www3.ëeforum.org/docs/ËEF\\_FutureRoleCivilSociety\\_Report\\_2013.pdf](http://www3.ëeforum.org/docs/ËEF_FutureRoleCivilSociety_Report_2013.pdf)

interesat dhe vlerat e anëtarëve të tyre, bazuar në konsideratat etike, kulturore, politike, shkencore, fetare ose filantropike”. Pra, shoqëria civile përbëhet nga grupe komunitare, organizata joqeveritare, organizata jofitimprurëse, sindikatat e punëtorëve, organizata bamirëse, organizata fetare, shoqata profesionale dhe fondacione. Organizatat jofitimprurëse janë përfaqësuesi i shoqërisë civile më i përfshirë në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit<sup>73</sup> 2015-2020.

Fillimisht, për të identifikuar perceptimin mbi korrupsionin dhe suksesin e politikave antikorrupsion të ndërmarra në tre-vjeçarin e fundit, G.A ka analizuar rezultatet që Shqipëria ka arritur në disa prej treguesve<sup>74</sup> më të mirënjohur, të publikuara nga organizata të pavarura ndërkombëtare. Më tej, këto rezultate janë krahasuar me rezultatet që strategjia synonte të arrinte në këto tregues pas zbatimit të planit të parë të veprimit (PV 2015-2017), për të identifikuar kështu arritjen apo jo të qëllimeve të përgjithshme të Strategjisë<sup>75</sup>

Sikurse është trajtuar dhe më herët, indeksi më i referuar për të matur nivelin e korrupsionit në një vend është Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit (CPI) i publikuar nga Transparency International. CPI<sub>2017</sub> e rendit Shqipërinë në vendin e 91, me një vlerësim prej 38 pikësh. Në 2016-tën Shqipëria shënoi vlerësimin më të mirë 39 pikë (+3 pikë) nga vlerësimi në 2015-tën, për të pësuar sërish ulje në 2017, duke treguar kështu paqëndrueshmëri në perceptimin mbi korrupsionin në vend.

### Grafiku 9: Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit për Shqipërinë dhe vendet e rajonit



Burimi: Të dhëna të publikuara nga TI, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Ndërsa, vendet e tjera fqinje dhe të rajonit si Greqia, Kroacia dhe Mali i Zi në 3-vjeçarin e fundit, bazuar në këtë indeks, shfaqen dukshëm me një nivel perceptimi të korrupsionit nga qytetarët më të ulët se ai i Shqipërisë, duke u pozicionuar në 2017 respektivisht në vendin e 59, 57 dhe 64. Në analizën vlerësuese të integritetit<sup>76</sup> që TI publikoi në shtator të 2016-ës për Shqipërinë, korrupsionit i referohet si i gjithanshëm

<sup>73</sup> Bazuar në intervistat e zhvilluara nga G.A gjatë auditimit “Strategjia Antikorrupsion”

<sup>74</sup> Pjesë e treguesve janë indekse, indikatorë apo raporte vlerësimi.

<sup>75</sup> Qëllimet e strategjisë janë përshkruar në fq. 65 të këtij raporti

<sup>76</sup>[https://www.transparency.org/ehatëedo/publication/national\\_integrity\\_system\\_assessment\\_albani\\_a\\_2016](https://www.transparency.org/ehatëedo/publication/national_integrity_system_assessment_albani_a_2016) Kapitulli V Profili i Korrupsionit dhe VI Aktivitetet Antikorrupsion.

dhe se të gjitha sferat publike janë të prirura drejt korrupsionit të vogël dhe të madh ndërsa, korrupsioni politik është evident në financimin e partive politike, në shpërdorimin e burimeve publike, në fushatat zgjedhore, etj. Në kapitullin e politikave antikorrupsion, TI veçon portalin “Stopkorrupsionit.al”<sup>77</sup> për të denoncuar korrupsionin *online* nga qytetarët ndërsa, SNKK-në dhe PV si të lëvruara me vonesë. Në përfundim të përshkrimit të profilit të korrupsionit, politikat antikorrupsion të ndërmarra në vendin tonë janë konsideruar si joefektive dhe të paqëndrueshme në kohë.

Gjithashtu, Freedom House (FH), në raportin e publikuar në 2017-ën<sup>78</sup> mbi nivelin e demokratizimit të vendeve në tranzicion, e vlerëson korrupsionin në Shqipëri si të lartë dhe të pandryshueshëm: 5.25 për tre vitet e fundit, por në rritje krahasuar me periudhën 2008-2012, periudhë në të cilën ky tregues ishte 5. Edhe sipas renditjes së Freedom House, Mali i Zi<sup>79</sup>, Maqedonia dhe Bosnje-Hercegovina vlerësohen me një nivel korrupsioni më të ulët sesa Shqipëria. Në raportin e publikuar në 2018<sup>80</sup>-ën prej saj (Freedom House), Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, si një prej dy instrumenteve antikorrupsion të ndërmarra në Shqipëri, citohet se ka neglizhuar korrupsionin politik dhe atë të madh: “Përparimet e bëra në vitin 2017 për të reduktuar korrupsionin e vogël u kompensuan nga humbjet në luftën kundër korrupsionit të madh dhe kapjes së shtetit”.

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, Koordinatorin Kundër Korrupsionit dhe rrjeti i pikave fokale të ndërtuara në ministri të ndryshme janë vlerësuar gjithashtu, në dy raportet e fundit<sup>81</sup> të Indeksit të Transformimit (BTI)<sup>82</sup>. Performanca e qeverisë, e vlerësuar me tregues efektivitetin e politikave antikorrupsion të ndërmarra, shfaqet e pandryshuar në 4-vjeçarin e fundit, pavarësisht hartimit dhe zbatimit të Strategjisë Antikorrupsion.

**Tabela 11: Efektiviteti i politikave antikorrupsion në Shqipëri dhe vendet e rajonit**

Vendet/ Raportet	Raporti i 2016	Raporti i 2018
Shqipëria	5	5
Maqedonia	5	5
Mali i Zi	7	7
Kroacia	7	7

<sup>77</sup>[www.stopkorrupsionit.al](http://www.stopkorrupsionit.al)Ky portal aktualisht është i paaksesueshëm.

<sup>78</sup> Raporti i Vendeve në Tranzicion, është një raport i përvitshëm i publikuar nga Freedom House <https://freedomhouse.org/report/nations-transit/2017/albania>

<sup>79</sup><https://freedomhouse.org/report/nations-transit/2017/montenegro>

<sup>80</sup><https://freedomhouse.org/report/nations-transit/2018/albania>

<sup>81</sup> Raportet e vlerësimit të BTI publikohen çdo dy vite. Grupi i auditimit i është referuar raportit të 2016 dhe 2018.

<https://www.bti-project.org/en/reports/country-reports/detail/itc/ALB/>

<sup>82</sup> BTI është një rezultat agregat i dy indekseve, Indeksit të Statusit dhe të Menaxhimit. BTI publikohet çdo dy vjet. Indeksi i Menaxhimit përbëhet nga 5 kritere si: Niveli i vështirësisë, Aftësia drejtuese, Eficenca në përdorimin e burimeve, Arritja e konsensusit dhe Bashkëpunimi ndërkombëtar. Një ndër variablat e përdorur për të matur “Eficiencën në përdorimin e fondeve” është Eficenca e Politikës Antikorrupsion

Sipas indeksit BTI, politikat antikorrupsion të implementuara në Maqedoni vlerësohen me efektivitet të njëjtë si ato në Shqipëri, ndërsa ato të Malit të Zi dhe Kroacisë kanë rezultuar më efektive.

*Perceptimi i publikut mbi korrupsionin në vendin tonë, i matur nga indekset ndërkombëtare, shfaqet i paqëndrueshëm në 3-vjeçarin e fundit. Politikat antikorrupsion të ndërmarra nga qeveria gjatë këtyre viteve vlerësohen nga këto indekse si joefektive dhe të paqëndrueshme në kohë. Performanca e qeverisë, e matur me efektivitetin e politikave antikorrupsion të ndërmarra, shfaqet e pandryshuar për periudhën 2014-2018.*

Në SNKK 2015-2020 disa prej indekseve të lartpërmendura janë përcaktuar si tregues të përgjithshëm me anë të cilëve do të matet arritja e synimeve të Strategjisë. Në Qasjen Parandaluese, Strategjia synon që “të ç’rrënjosë korrupsionin nga radhët e administratës publike dhe të të gjithë segmenteve shtetërore”<sup>83</sup>. Në Qasjen Ndëshkuese, synimi i SNKK 2015 -2020 është “rritja e kapaciteteve dhe bashkëpunimit për hetimin e korrupsionit, si dhe marrja e masave për hetime më efektive dhe efikase”<sup>84</sup>. Ndërsa, në Qasjen Ndërgjegjësuese<sup>85</sup> synimi është përfshirja aktive e publikut në denoncimin apo parandalimin e korrupsionit. Në vijim, paraqiten të dhënat e arritura nga vendi ynë për këto tregues, të gjeneruara nga G.A.

**Tabela 12: Krahasimi i rezultateve të synuara nga strategjia me rezultatet faktike**

<b>Përshkrimi i treguesit</b>	<b>Synimi për 2017-ën</b>	<b>Faktike në 2017-ën</b>	<b>Krahasimi</b>
<b>Indeksi i perceptimit të korrupsionit (CPI)</b>	37.5 Rritje prej 1.5 – 2.5 pikë çdo vit (0= nivel i lartë i korrupsionit, 100= nivel i ulët i korrupsionit)	38 CPI <sub>2016</sub> =CPI <sub>2015</sub> +3 pikë CPI <sub>2017</sub> =CPI <sub>2016</sub> -1 pikë	Bazuar në këtë tregues, strategjia nuk i ka arritur synimet (jo rritje e qëndrueshme çdo vit).
<b>Kontrolli i korrupsionit Banka Botërore</b>	Shqipëria të performojë më mirë se 34% e totalit të vendeve për të cilat vlerësohet ky indeks	Në 2013 janë publikuar të dhënat e fundit për vendin tonë <sup>86</sup> .	/

<sup>83</sup>SNKK 2015-2020 Fq. 15

<sup>84</sup> SNKK 2015-2020 Fq. 15

<sup>85</sup>SNKK 2015-2020 Fq. 16

<sup>86</sup><http://info.worldbank.org/governance/ëgi/#home>

<b>Studimi mbi performancën e mjedisit të sipërmarrjes dhe të investimeve, Banka Botërore</b>	Korrupsioni nuk përbën një nga tre pengesat më të rëndësishme për bizneset	G.A. nuk ka arritur të gjejë të dhëna mbi këtë studim	/
<b>Raporti Nations in Transit (FH)</b>	Vlerësimi për Shqipërinë 4.5 (1= mirë, 7= shumë keq)	Për periudhën 2014–2018 Shqipëria vlerësohet 5.25	Bazuar në këtë tregues, strategjia nuk i ka arritur synimet.
<b>Rekomandimet e GRECO për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe parlamentarëve</b>	Të gjitha rekomandimet e raundit të IV të jenë zbatuar plotësisht	Në vlerësimin e fundit, nëntë nga dhjetë rekomandimet janë konsideruar të zbatuara pjesërisht. Një nga dhjetë është vlerësuar i zbatuar plotësisht. <sup>87</sup>	Bazuar në këtë tregues, strategjia nuk i ka arritur synimet.

Burimi: Të dhëna të publikuara nga TI, FH, KE, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

*Nga krahasimi i rezultateve të synuara nga strategjia me rezultatet faktike të arritura nga vendi ynë duket qartë se SNKK 2015-2020 nuk i ka arritur synimet e saj, duke treguar kështu se aktivitetet e përcaktuara dhe të ndërmarra në kuadër të saj dhe të Planit të Veprimit, nuk kanë qenë efektive.*

*Përfshirja e OJF-ve vendase në luftimin kundër korrupsionit shfaqet joaktive në Shqipëri, e përqendruar kryesisht në publikimin e pak të dhënave apo raporteve. G.A i është drejtuar gjithashtu edhe raporteve të publikuara nga këto OJF. Në Mars të 2018-ës, UNDP dhe IDM prezantuan gjetjet e sondazhit të përvitshëm "Besimi në Qeverisje 2017"<sup>88</sup>, të zhvilluar në Shqipëri. Krahasuar me 2016-ën, në 2017-ën gjetjet tregojnë se ekspozimi personal i qytetarëve ndaj korrupsionit në qeverisjen vendore është rritur me 6%, ndërsa në qeverisjen qendrore me 5%. Sipas sondazhit, tetë nga dhjetë të anketuar kanë vlerësuar korrupsionin e vogël dhe të madh si të përhapur dhe shumë të përhapur në Shqipëri. Ndërsa, transparencën e qeverisjes vendore dhe qendrore në 2017-ën, të anketuarit e vlerësojnë përafërsisht të njëjtë me atë të 2016-ës. Në 2017-ën, nga 100% të të intervistuarve, 58% mendojnë se qeverisja qendrore nuk është transparente dhe 53% gjykojnë se qeverisja vendore nuk është transparente.*

Një tjetër raport i konsultuar nga Grupi i Auditimit, është ai i IDRA-ës i publikuar në 2016-ën<sup>89</sup> "Korrupsioni dhe Perceptimi i Korrupsionit". Sipas këtij raporti, i shtrirë në periudhën kohore 2015-2016, 89% e të përgjigjurve mendojnë se korrupsioni midis

<sup>87</sup><https://rm.coe.int/16806c1be3>

<sup>88</sup><http://idmalbania.org/ep-content/uploads/2018/03/IDM-OpinionPoll-2017-EN-web.pdf>

<sup>89</sup>[http://www.idrainstitute.org/files/reports/Corruption%202016/Gjetjet%20Kryesore%20Studimi%20i%20Korrupsionit%20IDRA%20\\_Grafike.pdf](http://www.idrainstitute.org/files/reports/Corruption%202016/Gjetjet%20Kryesore%20Studimi%20i%20Korrupsionit%20IDRA%20_Grafike.pdf)

zyrtarëve publikë është i përhapur dhe shumë i përhapur (prej të cilëve 51% e konsiderojnë shumë të përhapur). Ndërsa, respektivisht 33% dhe 37% besojnë se korrupsioni është rritur dhe se ka mbetur i njëjtë në tre vitet e fundit. Transparenca e bashkive është në nivele më të ulëta se mesatarja, duke shënuar 44 pikë në vlerësimin nga 0 (aspak transparente) në 100 (shumë transparente). “Hartëzimi i qeverisjes vendore në Shqipëri”<sup>90</sup>, i publikuar në tetor 2017, është një projekt i financuar nga Komisioni Evropian dhe i zhvilluar nga UNDP, IDRA dhe Star II, i cili vlerëson qeverisjen vendore në disa dimensione si: eficientia dhe efektiviteti, transparenca dhe sundimi i ligjit, llogaridhënia dhe pjesëmarrja e qytetarëve, etj. Në dimensionin e transparencës, qeverisja vendore vlerësohet si mesatare, duke cilësuar që një pjesë e bashkive nuk kanë faqe web, ose kanë informacione të pakta dhe jo të përditësuara në to. Sipas këtij vlerësimi, strategjitë, planet dhe mekanizmat për luftën kundër korrupsionit në nivel vendor konsiderohen të pamjaftueshme dhe kërkohen ndërhyrje të mëtejshme.

*Nga analizimi i rezultateve që vendi ynë ka arritur në disa prej indekseve më të mirënjohura ndërkombëtare, krahasimi i rezultateve të arritura me rezultatet e synuara nga strategjia dhe analizimi i raporteve të publikuara nga OJF-të vendase, G.A konkludon se: SNKK 2015-2020, me anë të zbatimit të PV 2015-2017, nuk i ka arritur synimet e përgjithshme të saj. Korrupsioni në rang kombëtar, bazuar në të dhënat e indekseve, dhe korrupsioni në qeverisjen vendore bazuar në publikimet e shoqërisë civile, shfaqet gjerësisht i përhapur në të tre format e tij, në rritje ose i pandryshuar. Politikant antikorrupsion vlerësohen joefektive, jo të qëndrueshme dhe e nevojshme për të ndërhyrë në to.*

Me qëllim dhënien e rekomandimeve të nevojshme, G.A ka gjykuar të rëndësishme edhe vjeljen e drejtpërdrejtë të opinionit të organizatave jofitimprurëse që veprojnë në vendin tonë. Për këtë është hartuar dhe shpërndarë një pyetësor në adresat e kontaktit të të gjithë OJF-ve të regjistruara në AMSHC. Në fazën e përpunimit të të dhënave të pyetësorit rezultoi se: vetëm 6%<sup>91</sup> e OJF-ve janë përgjigjur nga rreth 600 pyetësorë të shpërndarë në total. Për të kuptuar më tepër, G.A hartoi dhe shpërndau gjithashtu, një pyetësor me pyetje të hapura drejtuar 18 OJF-ve<sup>92</sup> të cilat kanë qenë fituese në të paktën një projekt me tematikë luftën kundër korrupsionit në AMSHC. Nga këto, janë përgjigjur vetëm 3 organizata, me tema fituese<sup>93</sup>: “Rritja e Transparencës në Njësitë e Qeverisjes Vendore në Elbasan, Librazhd, Pogradec, Korçë” (2.500.000 lekë), “Demokracia bashkiake si bashkëveprim i komuniteteve qytetare me pushtetin lokal” (700.000 lekë) dhe “Nxitja e pjesëmarrjes qytetare në vendim-marrjen e Bashkive në lidhje me sigurimin e ujit të pijshëm përmes krijimit dhe funksionimit të grupeve të monitorimit” (2.500.000 lekë). Mbështetur në këto nivele të ulëta të reagimit nga OJF-të kundrejt plotësimin të pyetësorëve, gjithashtu dhe në rezultatin e arritur nga përlllogaritja statistikore e të dhënave, ku pjesa dërrmuese e këtyre organizatave dëshmojnë se kontributi i tyre në luftën kundër korrupsionit ka qenë i pamjaftueshëm duke u shprehur se: “Kemi bërë diçka, por duhet të bëjmë edhe më

<sup>90</sup><http://www.idrainstitute.org/files/star2/Local%20Governance%20Mapping%20in%20Albania.pdf>

<sup>91</sup> Rreth 100 adresa kontakti nuk ekzistojnë. G.A kërkoi individualisht kontaktet për secilën prej këtyre OJF duke ridërguar pyetësorin në adresat e reja të gjeneruara nga kërkimi individual.

<sup>92</sup> Të dhënat mbi projektet fituese G.A. i mori në databazën e krijuar nga AMSHC.

<sup>93</sup> Në valën e parë të shpërndarjes së pyetësorëve, nuk pati asnjë përgjigje nga këto OJF. Pas kontaktit në numrat e telefonit, G.A i ridërgoi sërish pyetësorë për ato OJF që i kërkuan.

*shumë”, G.A krijon bindjen se angazhimi i vetë shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit ka qenë i vakët, për të mos i thënë i ftohtë.*

Gjithashtu, fakti se 7 prej OJF-ve fituese të fondeve me tematikë çështjen në fjalë nuk rezultojnë të regjistruara në databazën e AMSHC tërhoqi vëmendjen e audituesve. G.A. tentoi t'i kontaktonte në numrat e kontaktit, meqenëse deri në atë moment nuk ishte marrë asnjë përgjigje prej tyre nëpërmjet e-mail-it. *U konstatua se: përpos faktit që këto OJF nuk janë të regjistruara në AMSHC, nuk janë përgjigjur në e-mail, për një pjesë të tyre adresat web nuk figurojnë aktive, e numrat e kontaktit nuk ekzistojnë.* Nga intervista e kryer me përfaqësuesit e AMSHC-së, grupit të auditimit iu bë me dije se një pjesë e buxhetit të kësaj agjencie alokohet për financimin e projekteve për luftën kundër korrupsionit në Shqipëri. Kjo është diskutuar në një takim të organizuar nga KKK në kuadër të SNKK, e përcaktuar edhe në Planin e Veprimit 2015-2017, duke konfirmuar kështu se: një pjesë e buxhetit të AMSHC-së i është alokuar këtyre organizatave në kuadër të SNKK 2015-2020. AMSHC raporton për këto projekte në Sekretariatit Teknik të Strategjisë Ndërsektoriale këto të dhëna: OJF-të përfituese, shumat e alokuara dhe numrin e vendimit me anë të cilit janë alokuar këto shuma. Nga kryqëzimi i të dhënave midis databazës së marrë nga AMSHC (ku përcaktohen projektet fituese në mbështetje të luftës kundër korrupsionit) dhe raportimeve të bëra nga AMSHC në Sekretariatit Teknik (mbi projektet fituese në kuadër të Strategjisë, të publikuara në raportet e monitorimit të strategjisë Mars 2015 dhe Janar 2017) rezulton se: OJF-të përfituese të fondeve në kuadër të strategjisë, të raportuara nga AMSHC në Sekretariatit Teknik, nuk rezultojnë të njëjtat me OJF-të e përcjella fituese të fondeve grupit të auditimit, nga vetë AMSHC.

*Faktet e paraqitura më sipër hedhin dyshim mbi vërtetësinë e këtyre projekteve dhe lidhjes së tyre me tematikat e çështjes në fjalë.*

*Në lidhje me këtë, AMSHC me anë të shkresës nr. 135/1 prot., datë 19.07.2018 shprehet se: dyshimi mbi vërtetësinë e projekteve është i pabazë, pasi AMSHC disponon të gjithë dokumentacionin provues, narrativ dhe financiar të realizimit të këtyre projekteve. Grupi i auditimit, për shkak se AMSHC nuk ishte subjekt në nauditim, nuk kërkoi evidenca të tjera mbështetëse që lidhen drejtëpërdrejtë me veprimtarinë e saj. Për këtë, G.A ka rekomanduar auditim performance për institucionin në fjalë.*

Ndërkohë, në dy raportet e monitorimit të publikuara nga Sekretariati Teknik i KKK, nënobjektivi përkatës në Planin e Veprimit (nënobjektivi C.1.7) konsiderohet “I zbatuar”, duke ngritur dyshime mbi saktësinë e përcaktimit të statusit “I zbatuar” në raportimet e bëra nga Sekretariati Teknik mbi zbatimin e Strategjisë.

Informacionet e marra nga dy pyetësorët e përmendur më lart dhe komunikimet/intervistat e kryera me përfaqësues të tre prej OJF-ve më aktive lidhur me çështjen e korrupsionit në Shqipëri (TI, IDRA, IDM) kanë ndihmuar G.A për të kuptuar perceptimin e shoqërisë civile lidhur me korrupsionin në qeverisjen vendore dhe adoptimin e politikave antikorrupsion. 43% e OJF-ve të përgjigjur në pyetësorin e përgjithshëm vlerësojnë se korrupsioni në qeverisjen e tyre lokale nuk ka ndryshuar në tre-vjeçarin e fundit, 27% perceptojnë se korrupsioni është ulur dhe 20% se është rritur. Ndër shkaqet kryesore të korrupsionit në qeverisjen vendore, OJF-të përmendin 58% ato politike, 17% shkaqe personale, 8.3% financim i aktiviteteve kriminale. Pandëshkueshmëria është një tjetër shkak i cilësuar nga OJF-të, si dhe nga

përfaqësuesi i IDRA në intervistën e kryer me këtë të fundit, si kryesor në ekzistencën e këtij fenomeni në qeverisjen vendore. Format kryesore të korrupsionit sipas opinionit të OJF-ve vendase, renditen si më poshtë:

1. Rekrutimi dhe favorizimi i padrejtë i burimeve njerëzore (83%)
2. Keq alokimin e burimeve natyrore (80.6%)
3. Përvetësimi i fondeve publike përmes prokurimeve të padrejta (69.3%)
4. Vendim-marrje e padrejtë, në favor të grupeve të caktuara të interesit (69%)
5. Marrja dhe dhënia e ryshfeteve (55%)

*Krahasimi i rezultateve të marra nga pyetëtorët drejtuar dy aktorëve: qytetarëve dhe OJF-ve, përforcon opinionin e G.A. se politikat antikorrupsion të ndërmarra në qeverisjen vendore nuk kanë dhënë efekt për të krijuar një perceptim të përgjithshëm midis publikut dhe palëve të tjera, për një korrupsion në ulje në tre vitet e fundit. Format e këtij fenomeni, të konsideruara gjerësisht të përhapura nga të dy aktorët, janë hasur si nga qytetarët në shërbimet administrative që ofrohen në njësitë lokale, ashtu edhe në aktivitetet e kryera në këto njësi nga shoqëria civile.*

G.A ka kërkuar të identifikojë nivelin e njohjes nga OJF-të të politikave antikorrupsion. Për këtë ka drejtuar një pyetje të hapur në pyetëtorin e përgjithshëm, nëse OJF-të vendase kanë dijeni mbi SNKK dhe PV të ndërmarrë nga qeveria dhe të implementuar në qeverisjen e tyre vendore në periudhën 2015-2017. Gjithashtu, G.A. ka kërkuar edhe burimin e informimit mbi këto politika. Nga analiza e përgjigjeve rezultoi se: 47% e tyre nuk kanë dëgjuar kurrë më parë për SNKK dhe PV dhe nuk kanë dijeni për këto dokumente strategjike. Midis OJF-ve të cilat kanë dijeni mbi ekzistencën e këtyre dy dokumenteve (53% e totalit), vërehet se për pjesën dërrmuese burimi i informimit ka qenë Interneti apo mediat sociale.

Në përgjigjet e ardhura, pjesëmarrja në takimet konsultative në kuadër të SNKK nuk është përmendur si burim informimi mbi Strategjinë. Të pyetur drejtpërdrejt mbi pjesëmarrjen në këto takime dhe frekuencën e pjesëmarrjes, 80% e organizatave të shoqërisë civile tregojnë se nuk kanë qenë asnjëherë pjesë e takimeve konsultative të organizuar për SNKK-në. Në pjesën e mbetur të përgjigjeve (20% e totalit), dallohen OJF të cilat nuk i janë përgjigjur pyetjes mbi pjesëmarrjen në këto takime, *kanë treguar që kanë marrë pjesë vetëm njëherë, duke dhënë mendime konkrete të cilat nuk janë marrë në konsideratë, apo janë përgjigjur se kanë marrë pjesë, pa përmendur organizatorin dhe frekuencën e pjesëmarrjes.*

*Mbështetur në mungesën e dokumentacionit dhe përgjigjeve të OJF-ve, G.A krijon bindjen e arsyeshme se KKK nuk e ka përfshirë shoqërinë civile sikurse përcaktohet në Strategji në hartimin/ zhvillimin e strategjisë<sup>94</sup> dhe zbatimin/ monitorim<sup>95</sup> e saj.*

*Mospërfshirja e aktorëve kryesorë në strategji dhe/apo mosreflektimi i komenteve të tyre në këto dokumente strategjike, ka rezultuar në krijimin e opinionit (për 60% të OJF-ve që kanë dijeni mbi strategjinë) se: SNKK 2015-2020 është një Strategji pa një rezultat konkret në uljen e korrupsionit real apo të perceptimit të tij. Sipas tyre, duhet t'u jepet rëndësi më e madhe organizatave lokale që e njohin situatën dhe e kanë të prekshme çdo ditë. Të tjerë shprehen se bashkitë nuk e njohin Strategjinë dhe se nuk është hartuar ndonjë Plan Veprimi për zbatimin e saj. Ndërsa, 40% e OJF-ve që kanë dijeni*

<sup>94</sup> SNKK 2015 – 2020, Fq. 8

<sup>95</sup>SNKK 2015 – 2020, Fq. 27

për Strategjinë gjykojnë se: Strategjia ka funksionuar disi dhe ka dhënë disa efekte më së shumti në ndërgjegjësimin e qytetarëve.

Në vijim të sa më sipër, G.A. ka kërkuar opinionin e OJF-ve, se sa aktivitetet e përcaktuara në PV ndihmojnë në arritjen e qëllimeve të strategjisë. **80% e OJF-ve të në total mendojnë se aktivitetet:**

- a) Krijimi i faqeve WEB të përditësuara,
- b) Krijimi i mekanizmit të monitorimit dhe ofrimit periodik të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal,
- c) Publikimi në ambientet publike dhe internet të prefekturave, të buxheteve dhe shpenzimeve të çdo komune dhe bashkie në qark,
- d) Krijimi i regjistrit tematik të ankesave,
- e) Ofrimi i shërbimeve administrative në nivel vendor përmes sporteleve unike,
- f) Publikimi në ambientet publike të çdo prefekturë të akteve nënligjore të miratuara nga bashkitë përkatëse të qarkut në mjediset publike, **e përcaktuara në PV 2015-2017, për t'u realizuar në qeverisjen vendore ndikojnë "mesatarisht" dhe "shumë" arritjen e qëllimeve të mëposhtme:**

- Forcimi i transparencës përmes zbatimit të ligjit,
- Rritja e transparencës lidhur me kontrollin dhe financimin e partive politike
- Forcimi i integritetit dhe transparencës së zyrtarëve publik në qeverisjen vendore, **të përcaktuara në SNKK 2015-2020.**

Megjithëse, për shumicën e organizatave këto aktivitete konsiderohen të domosdoshme për të arritur qëllimet, ato gjithashtu shprehen se duhet të ndërmerren edhe masa të tjera, të cilat në opinionin e tyre shfaqen dhe më emergjente për të parandaluar korrupsionin në njësitë e qeverisjes vendore dhe arritjen e qëllimeve 1-3. Opinion i përbashkët ky edhe me pjesën tjetër të OJF-ve të pyetura (20% e totalit), të cilat janë të mendimit se masat ndikojnë "pak" ose "aspak" në arritjen e qëllimeve të listuara më sipër.

Përsa i përket angazhimit të OJF-ve në aktivitete parandaluese të korrupsionit nga qeverisja lokale, 74% dëshmojnë se nuk është kërkuar asnjëherë mendimi i tyre mbi masat më emergjente për t'u ndërmarrë. Mungesa e bashkëpunimit me institucionet e qeverisjes vendore dhe angazhimi nga këto të fundit i vetëm disa OJF-ve të mëdha në aktivitetet antikorrupsion është vlerësuar nga organizatat si: një ndër tre sfidat kryesore me të cilat OJF-të përballen në Shqipëri, duke ndikuar negativisht kështu, luftimin e korrupsionit.

G.A. ka pyetur OJF-të se sa munden këto të fundit të asistojnë qeverisjen lokale në realizimin e nënobjektivave (aktivitetet a-f të përmendura më lart) antikorrupsion të përcaktuara në PV nëse do të kërkohej angazhimi i tyre. Më shumë se 80% e OJF-ve janë përgjigjur se mund ta asistojnë qeverisjen lokale në realizimin e aktiviteteve të përcaktuara kësaj të fundit nga PV 2015-2017, në kuadër të SNKK 2015-2020 (në Qasjen Parandaluese).


G.A. nga kërkimet e kryera mbi praktikën më të mira të angazhimit të OJF-ve në luftën kundër korrupsionit, ka gjeneruar disa aktivitete në të cilat mund të përfshihen këto organizata (OJF-të) me qëllim parandalimin e korrupsionit. Mbi rëndësinë e kryerjes së këtyre aktiviteteve nga organizatat jofitimprurëse në njësitë e qeverisjes vendore,

G.A. ka kërkuar opinionin e drejtpërdrejtë të këtyre të fundit, i cili është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

Vërehet se: më shumë se 50% e të pyeturve i vlerësojnë shtatë aktivitetet e mësipërme si shumë të rëndësishme për të parandaluar korrupsionin në qeverisjen e tyre lokale. Në gjykimin e OJF-ve, aktivitetet e gjeneruara nga G.A, të radhitura sipas rëndësisë që kanë në parandalimin e korrupsionit në qeverisjen e tyre lokale, paraqiten si vijon:

- Monitorimi i instrumenteve ndërkombëtare të antikorrupsionit 89%;
- Monitorimi i përmbushjes së treguesve të performancës 88%;
- Ndërgjegjësimi dhe edukimi publik 86%;
- Përgatitjen, pjesëmarrjen, përshpejtimin dhe zbatimin e programeve ndërkombëtare apo iniciativave lokale antikorrupsion 81%;
- Trajnime mbi masat për të parandaluar korrupsionin në sektorë të ndryshëm 81%;
- Watchdog (p.sh. identifikimi i zonave me risk të lartë në njësitë e qeverisjes vendore) 81%;
- Monitorimin dhe zbulimin e akteve të korrupsionit 76%.

### Grafiku 10: Rëndësia e ndërmarrjes së aktiviteteve antikorrupsion (të gjeneruara nga praktikrat e mira) nga OJF-të vendase



Burimi: Të dhënat nga pyetësi i plotësuar nga OJF-të, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nga renditja e mësipërme mund të dallohet se aktivitetet të cilat OJF-të i gjykojnë me rëndësi të madhe për të parandaluar korrupsionin kanë të nevojshëm bashkëpunimin midis institucioneve të qeverisjes lokale dhe shoqërisë civile. Kjo, e përmendur dhe më herët, është një ndër sfidat kryesore me të cilën OJF-të janë përballur në tre-vjeçarin e fundit. G.A ka pyetur këto organizata nëse kanë realizuar ndonjë nga aktivitetet e mësipërme në qeverisjen e tyre lokale. Nga përgjigjet rezultoi se shumica e OJF-ve nuk kanë kryer aktivitete me fokus korrupsionin apo parandalimin e tij. Midis një numri të vogël organizatash të cilat kanë kryer aktivitete me këtë tematikë, vërehet se kanë

realizuar veprimtari të orientuara drejt ndërgjegjësimit dhe edukimit publik mbi rolin e qytetarëve në denoncimin e korrupsionit dhe shpjegimin e konceptit të Ëatchdog, apo trajnime për të rritur transparencën ndaj qytetarëve.

*Mbështetur në vlerësimet e arritura në treguesit e përcaktuar si matës të arritjes së synimeve të SNKK, në opinionin e publikut dhe palëve të tjera G.A krijon bindjen e arsyeshme se: Strategjia nuk i ka arritur synimet e saj e nuk ka dhënë efektin e pritur në ç'rrënjosjen e korrupsionit nga radhët e administratës publike, hetimin efektiv dhe eficient të korrupsionit dhe në përfshirjen aktive të publikut dhe aktorëve të tjerë në këtë luftë. Korrupsioni në Shqipëri vazhdon të mbetet endemik, si në qeverisjen qendrore, ashtu dhe vendore, me të tre format e tij.*

*Shoqëria civile nuk është përfshirë aktivisht në luftimin e këtij fenomeni, mospërfshirje e ardhur kjo nga mungesa e bashkëpunimit me institucionet qeverisëse. Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit nuk ka rezultuar në pakësim të fenomenit të perceptuar dhe as në adoptimin efektiv të aktiviteteve antikorrupsion.*

### **Si përfundim, konkludojmë se:**

- Mosorientimi i veprimtarisë së shoqërisë civile nga vetë kjo shoqëri, drejt luftës kundër korrupsionit, ka bërë që ajo të mos realizojë aktivitetet që një OJF-të duhet të realizojë (bazuar në praktika të mira dhe në vetëvlerësimin e OJF-ve të pyetura nga G.A.) për të ndihmuar parandalimin e korrupsionit në qeverisjen vendore.
- Faktet e paraqitura më herët në raport hedhin dyshim mbi vërtetësinë e fondeve të alokuara nga AMSHC kah projekteve me tematikë antikorrupsionin.
- Mosekzistenca e një mekanizmi i cili kontrollon besueshmërinë e statusit “I zbatuar” në raportet e monitorimit të gjeneruara nga Sekretariati Teknik, rrezikon që “norma” e zbatueshmërisë e Strategjisë të mos paraqesë situatën reale.
- Mospërfshirja e shoqërisë civile në takimet konsultative të zhvilluara nga KKK mbi hartimin dhe zhvillimin e Strategjisë ka bërë që një pjesë e konsiderueshme e OJF-ve në të gjithë republikën, të mos ketë dijeni mbi ekzistencën e SNKK dhe PV. Mosdijenia dhe mosprania e shoqërisë civile në takimet konsultative të KKK-së ka rezultuar në mosparaqitjen e masat antikorrupsion më të nevojshme për t'u ndërmarrë në qeverisjen vendore (të reflektuara nga shoqëria civile). Si pasojë, kjo ka shkaktuar mosreflektimin e opinionit të shoqërisë civile dhe indirekt atë të qytetarit në masat antikorrupsion të përcaktuara në PV.
- Mospërfshirja e shoqërisë civile nga Prefekturat, në zbatimin dhe monitorimin e politikave antikorrupsion të adoptuara në njësitë e qeverisjes vendore ka shkaktuar mungesën e kontributit të këtij aktori në adoptimin e politikave, të perceptuara jo të adoptuara nga publiku.

### **Për këtë rekomandojmë:**

- 1 Angazhim aktiv të OJF-ve nga vetë OJF-të, në aktivitete antikorrupsion në qeverisjen vendore në përgjithësi dhe në 7 aktivitetet e gjeneruara më lart nga G.A, në veçanti.

**Menjëherë**

- 2 Auditim Performance nga institucioni i KLSH-së për AMSHC-në.

- 3 Krijimi i një mekanizmi në hierarkinë e zbatimit të Strategjisë me qëllim monitorimin e vërtetësisë së të dhënave të raportuara nga Sekretariati Teknik në raportet e monitorimit.

***Me hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020***

- 4 Përfshirjen nga KKK të shoqërisë civile, në takimet konsultative me përfaqësues të OJF-ve nga të gjitha qarqet dhe mbajtjen në konsideratë të përvojës dhe perceptimit të tyre nga Sekretariati Teknik gjatë hartimit dhe përditësimit të masave antikorrupsion (për qeverisjen vendore) në planet e reja të veprimit.

***Me hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020***

- 5 Përfshirjen e shoqërisë civile nga prefekturat në adoptimin e politikave antikorrupsion në njësitë e qeverisjes vendore

***Menjëherë***

**4. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE, KONKLUZIONEVE DHE REKOMANDIMEVE**

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, politik dhe social është synimi kryesor i çdo vendi, për më tepër kjo bëhet dhe më e rëndësishme në shtetet me demokraci të brishtë dhe me institucione të dobëta. Krahas të tjerave, korrupsioni është një nga pengesat kryesore për arritjen e këtij synimi. *“Korrupsioni është kanceri në zemër të problemeve të botës sot. Korrupsioni shkatërron vendet e punës dhe pengon zhvillimin, i kushton ekonomisë së botës miliarda dollarë çdo vit. I ngujon të varfrit në varfëri përderisa qeveritë e korruptuara anembanë botës vjedhin buxhetin e shtetit dhe parandalojnë që njerëzit e devotshëm që punojnë me djersë dhe me ndershmëri të fitojnë nga frytet e punës së tyre. Korrupsioni vjedh investimet që duhej të shkonin në shkolla dhe spitale përderisa të korruptuarit u shmangen taksave që duhet paguar.”*<sup>96</sup> Me rritjen e korrupsionit dhe njohjen e efekteve të dëmshme të tij në rritjen ekonomike dhe stabilitetin shoqëror, kërkesa për strategji praktike për të reduktuar korrupsionin është rritur në mënyrë drastike.

Korrupsioni dhe luftimi i tij vijojnë të jenë një nga sfidat kryesore dhe një nga prioritetet madhore ndërsektoriale për Shqipërinë, si dhe një ndër pesë politikat të cilat vendi ynë këshillohet t’i ndjekë me përparësi në procesin e integritetit evropian të vendit. Këtij qëllimi i shërben hartimi i SNKK 2015–2020, të miratuar me VKM nr. 247, datë 20.3.2015, si dhe PV i cili i referohet periudhës 2015–2017.

Në vitin 2015, Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë ka theksuar se: *“U miratua një strategji e re antikorrupsion dhe një plan veprimi. Megjithatë, korrupsioni është i përhapur dhe nevojiten më shumë përpjekje për të bërë përparim me qëllim të krijimit të një rekordi të qëndrueshëm të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në të gjitha nivelet”*. Edhe në vitin 2016 është vlerësuar se nevojiten më shumë përpjekje për të luftuar korrupsionin në nivel të lartë, si dhe që, korrupsioni mbetet mbizotërues në shumë fusha dhe vazhdon të jetë një problem serioz.<sup>97</sup>

**A është efektiv objektivi A. 11 i SNKK?**

***Mesazhi i auditimit***

<sup>96</sup>David Cameron-Ish kryeministri britanik.

<sup>97</sup>Commission Staff Working Document, Albania 2016 Report

SNKK dhe PV janë krijuar për të qenë në linjë me një nga 5 rekomandimet e BE-së dhe rezultati final i tyre duhet të reduktoje ndjeshëm korrupsionin në vend me anë të përfshirjes së të gjitha palëve të interesit. Pavarësisht këtij synimi, SNKK dhe rrjedhimisht PV që e detajon atë vuajnë planifikimin e dobët të objektivave të saj, specifikisht të objektivit A11 audituar nga KLSH. Ky planifikim i dobët shprehet në formulimin e nënobjektivave jo-SMART, moskonsultimin apo konsultimin fiktiv të palëve të interesit në hartimin e këtyre dokumenteve, mungesën e metodologjisë që përkthen objektivat operacionalë në strategjikë, mungesën e koherencës midis PV dhe SNKK, si edhe miratimit të kësaj Strategjie me akt nënligjor (VKM), ndërkohë që ajo parashtron detyra edhe për institucionet e pavarura nga ekzekutivi.

Në drejtim të implementimit, Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit (Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore për periudhën mars 2015- shtator 2017 dhe Ministria e Drejtësisë për periudhën shtator - qershor 2018) me rol kyç në hartimin, implementimin dhe monitorimin e SNKK dhe Planit të Veprimit, nuk kanë zotëruar asnjë hallkë të detyrave dhe përgjegjësi të veta, duke rezultuar në një Strategji të pazbatuar, pamonitoruar dhe rrjedhimisht të paraportuar për arritjet dhe mosarritjet. Në vijim, vlerësojmë përpjekjet e Ministrisë së Drejtësisë në luftën kundër korrupsionin, nëpërmjet veprimtarisë së Task Forcës, përgjatë 3-mujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2018.

Prefekurat, si një nga palët kryesore në zbatimin e Strategjisë janë joaktive si në afatet, ashtu edhe cilësinë e raportimit dhe rezultojnë të mos kenë realizuar produktet finale të parashikuara.

Nga ana tjetër, edhe pse shoqërisë civile i janë lëvruar fonde nga buxheti i shtetit lidhur me çështjen antikorrupsion dhe specifikisht këtë Strategji, roli i saj pothuajse nuk ekziston. Ajo rezulton të mos jetë e përfshirë në procesin e hartimit të SNKK dhe atë të luftimit të këtij fenomeni dhe për rrjedhojë nuk ka kontribuar si vlerë e shtuar e kësaj Strategjie.

Duke e konsideruar të dështuar në masën më të madhe objektivin A.11 dhe përgjithësisht Strategjinë Antikorrupsion dhe Planin e Veprimit për ta vënë në jetë atë, si edhe për të siguruar implementimin e një nisme kaq jetike për vendin e për të eliminuar në vijimësi riskun e transferimit të KKK nga njëri institucion në tjetrin, KLSH rekomandon krijimin e një Agjencie Kombëtare Antikorrupsion. Kjo agjenci sugjerohet të jetë nën varësinë e Kryeministrit dhe përgjegjëse për rihartimin, rizbatimin dhe monitorimin e mëtejshëm të SNKK dhe PV, duke marrë fillimisht dakordësinë e Kuvendit për dokumentet strategjike në formën e një Ligji të posaçëm. Gjithashtu, për përfshirjen e institucioneve jashtë-qeveritare në këtë Strategji, sinergjizimin e përpjekjeve antikorrupsion nga qeveria dhe institucionet kushtetuese, shoqëria civile, donatorët e huaj dhe aktorë të tjerë publikë, Kuvendi mund të përfshijë në Ligjin e miratuar për këtë Strategji, një aneks mbi raportet dhe rolin e këtyre aktorëve në Strategjinë Antikorrupsion dhe konkretisht me Agjencinë Kombëtare Antikorrupsion. Marrëdhëniet dhe roli i aktorëve jashtë-qeveritarë, sugjerohet të fokusohen në rakordimin e strategjive individuale të këtyre aktorëve me Strategjinë Antikorrupsion të qeverisë.

Në përfundim të këtij auditimi G A ka arritur në konkluzionet dhe rekomandimet të cilat në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur më poshtë:

**1. Në lidhje me pyetjen a është SMART objektivi A. 11 dhe nënobjektivat përkatës?**

• Konkluzione në lidhje me zbërthimin e objektivave madhore të Strategjisë në ato specifike sipas Planit të Veprimit 2015-2020.

1. Mungesa e kujtesës institucionale dhe e historikut të veprimtarisë së një institucioni nuk mund të sjellë as vijimësi të proceseve ekzistuese dhe as përmirësime që duhet të burojnë nga analizimi i rezultateve të arritura. Në çastet kur Ministri i Drejtësisë merr nën përgjegjësinë e vet një kompetencë të re dhe kaq të rëndësishme siç është SNKK dhe PV, duhet të sigurohej që bashkë me kompetencat do të merreshin edhe përgjegjësitë përkatëse, si edhe të realizonte transferimin e arkivës shkresore dhe elektronike nga Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore. Transferimi kompetencave nuk mund të realizohet si një proces i pashoqëruar me informacionin përkatës për punën e kryer dhe etapat në të cilat ka kaluar procesi,
2. Për një periudhë 5-mujore, Ministria e Drejtësisë nuk ka patur personin apo grupin e personave pranë institucionit të saj, i cili/ të cilët do të merrnin përgjegjësinë dhe detyrat e rolit të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit. Mosngarkimi i një personi për të vijuar punën lidhur me implementimin e Strategjisë dhe të Planit të Veprimit kundër korrupsionit, nuk tregon për vëmendje dhe përqendrim të Ministrisë së Drejtësisë në rolin e KKK në luftën kundër korrupsionit.
3. Pesë muaj prej daljes së VKM nr. 506<sup>98</sup>, datë 13.09.2017, ku cilësohet kjo ministri në rolin e KKK, e deri në daljen e Urdhrit të Ministrit nr. 2237, datë 20.02.2018<sup>99</sup>, Ministri i Drejtësisë përcakton njërin nga dy Zv/ministrat e vet si KKK.
4. Me gjithë përpjekjet e grupit të auditimit për të identifikuar gjurmë të institucioneve të ndryshme në propozimin e objektivave madhore, nëpërmjet kontrollit të arkivës fizike dhe asaj elektronike të MSHÇV, vihet re se hartimi i objektivave madhorë në fakt nuk është një rezultante e tërësisë së propozimeve të të gjitha institucioneve të përfshira në Strategji. Objektivat madhore të SNKK 2015-2020 në të vërtetë nuk janë një sintezë e objektivave të propozuara nga çdo institucion i pushtetit lokal, siç cilëson metodologjia e hartimit të SNKK 2015-2020.
5. Pavarësisht asaj që shpreh SNKK 2015-2020 lidhur me metodologjinë dhe procesin e hartimit, institucionet lokale nuk kanë bërë propozime dhe zbërthimi i objektivave madhorë në objektiva specifike nuk reflekton nevojën e vërtetë të secilit institucion që përfshihet në objektivin A11 të SNKK 2015-2020.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

1. KKK të kujdeset për të arkivuar dhe inventarizuar tërë dokumentacionin e arkivës shkresore të MSHÇV për sa i përket rolit të vet si KKK, lëvruar deri tani nga institucioni i Kryeministrisë, bazuar në Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat", i ndryshuar.

***Brenda muajit tetor 2018***

2. Sekretari i Përgjithshëm pranë Ministrisë së Drejtësisë të konfirmojë zyrtarisht se i gjithë arkivi shkresor që ka lidhje me aktivitetin e KKK të mëparshëm (rol i

---

<sup>98</sup>VKM Nr. 506 datë 13.09.2017 "Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë", pika 4

<sup>99</sup>Urdhri i Ministrit nr. 2237 datë 20.02.2018 "Për Caktimin e Fushës së Përgjegjësisë dhe Detyrave të Zëvendës Ministrave të Drejtësisë"

mbuluar nga Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore) është lëvruar pranë Ministrisë së Drejtësisë.

### ***Brenda muajit tetor 2018***

3. KKK, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të përfshijë të gjitha institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse që të propozojnë masat tyre respektive në zbërthimin e mëtejshëm të objektivave madhorë të SNKK 2015-2020, sa herë që rishikohet PV i SNKK 2015-2020.

### ***Vazhdimisht, sa herë bëhet përditësimi i Planit të Veprimit 2015-2020***

- *Konkluzione për shënjestrimin e nënobjektivave me treguesit, produktet finale dhe afatet kohore respektive në Planin e Veprimit 2015-2020.*

1. SNKK 2015-2020 është detajuar në një Plan Veprimi që në pamje të parë përmban objektiva SMART, por kontributi i realizimit të këtyre objektivave në përmbushjen e objektivave madhorë strategjikë është i papërcaktuar. Pra, nuk ekziston një metodologji apo një sistem që të konsolidojë objektivat operacionale në vlerësimin sasior të ecurisë së objektivit madhor strategjik përkatës. Një mangësi e tillë në planifikimin e Strategjisë, mbetet ende e pakorregtuar në rishikimin që i është bërë Planit të Veprimit, duke e bërë praktikisht infektive Strategjinë.

Kështu, 5 treguesit e përgjithshëm të SNKK 2015-2020, prezantojnë vlerat në të cilat ndodhet vendi ynë në momentin e hartimit të Strategjisë dhe parashikimet respektive të secilit prej tyre për vitet 2017 dhe 2020. Por SNKK 2015-2020 nuk shfaq asnjë prezantim të qartë mbi ecurinë dhe progresin në lidhje me përmbushjen e këtyre treguesve në periudha afatgjata.

2. Sipas Udhëzimit të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore “Udhëzime në lidhje me përgatitjen e Plan Veprimit kundër Korrupsionit 2014-2017” cilësohet se “*Plani i Veprimit ka si qëllim përmbledhjen në një dokument të vetëm të të gjithë atyre masave, të cilat parashikohen nga institucionet për realizimin konkret të objektivave të SNKK... Çdo ministri, institucion i pavarur apo prefekturë, me anë të koordinatorsit dhe pikës së kontaktit ... organizojnë punën brenda secilës ministri apo institucion për identifikimin e objektivave dhe masave (brenda orientimeve dhe objektivave strategjikë të strategjisë).*”

Po ashtu, bazuar në Udhëzimit të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore “Udhëzime në lidhje me përgatitjen e Plan Veprimit kundër Korrupsionit 2014-2017” “... çdo pikë kontakti duhet ndër të tjera, të kujdeset që të detajojë objektivin strategjik masa konkrete duke organizuar punën... dhe të bëjë formulimin përfundimtar të masave...” Shkresa nr. 1445/1, datë 03.05.2018 përcjellë grupit të auditimit nga Prefektura e Tiranës shpreh se “... me miratimin e Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” institucionet u gjendën para disa fakteve dhe detyrimeve që duheshin zbatuar. Ky ligj, në kuadër të së drejtës për informim të qytetarëve, përcaktonte detyrimin e transparencës së veprimtarisë së institucionit për çdo njeri që interesohej, për të lënë sa më pak hapësirë për mundësi abuzimi. ... Kështu që indikatorët e objektivit A11 janë përcaktuar pikërisht referuar të drejtës për informim...”

Përveç rastit të Prefekturës Tiranë, rasti i Prefekturës Berat tregon se edhe pse ka evidenca se vetëm ky institucion ka propozuar masat e veta, afatet dhe kostot

respektive, nuk janë përfshirë në Planin e Veprimit 2015-2020 të gjitha propozimet e prefekturës Berat.

Në kushte të tilla, kur Udhëzimet e Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore lidhur me hartimin e Planit të Veprimit, janë thjesht një akt zyrtar, nuk mund të pretendohet se është gjeneruar një plan veprimi duke u nisur nga baza drejt hierarkisë, që përmban nënobjektiva të zërthyera në mënyrë SMART, me masa, afate kohore dhe kosto të parashikuara sipas nevojave të vetë prefekturave për rastin e objektivit A11.

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Sekretariati Teknik pranë KKK të marrë masa që të grumbullojë propozimet e nga i gjithë rrjeti i pikave fokale kundër korrupsionit dhe të gjenerojë masa, tregues, kosto të parashikuara për realizimin e këtyre produkteve dhe afatet kohore të cilat të reflektojnë sintetizim të nevojave reale të institucioneve përgjegjëse për një arritje të SNKK.

#### ***Vazhdimisht, sa herë bëhet përditësimi i Planit të Veprimit të SNKK 2015-2020***

- *Konkluzione për kostimin e produkteve të synuara.*

1. Mungesa e përditësimit të Planit të Veprimit thëllon risqet për mosimplementimin e strategjisë në tërësi duke cenuar kështu objektivat madhorë në të cilat është bazuar vetë Strategjia, siç është edhe prioriteti 3 i BE “Vendosmëri në luftën kundër korrupsionit”.
2. Mosalokimi i buxhetit për çdo prefekturë (siç cilësohet në SNKK 2015-2020) tregon se nuk janë analizuar me kujdes kostot e nevojshme për realizimin e nën-objektivit A11.1, për pasojë ky nën-objektiv rezulton në rastin më të mirë “Pjesërisht i zbatuar”.
3. Nga të gjithë objektivat specifike të A.11, vetëm A11.1 “Krijimi i faqeve web të përditësuara” është i tillë që realizimi apo mosrealizimi i tij varet plotësisht nga parashikimi i saktë i kostove në plan veprimi.  
Kështu, për rastin e objektivit specifik A11.1 “Krijimi i faqeve web të përditësuara” treguesi i zbatimit të të cilit sipas Planit të Veprimit është “Adresa web të aksesueshme”, nga raportet vjetore të monitorimit që harton KKK rezulton si i pazbatuar për vitin 2015 dhe pjesërisht i zbatuar për vitet 2016-2017.

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

1. KKK aktual nëpërmjet strukturave përkatëse, të përditësojë Planin e veprimit në bazë vjetore me qëllim përshtatjen me progresin në zbatim të masave.

#### ***Në vazhdimësi***

2. KKK aktual nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masat për analizuar dhe siguruar se kostot e nevojshme të propozuara nga institucionet përgjegjëse për implementimin e objektivave specifik sipas Planit të Veprimit, mund të sigurojnë zbatimin e plotë të tyre brenda harqeve të përcaktuara kohore.

#### ***Në vazhdimësi, çdo vit para hartimit të Planit të përditësuar të Veprimit të SNKK***

3. Sekretariati Teknik pranë KKK të marrë masa që të sigurojë se kostot e parashikuara për realizimin e objektivave specifike nga institucionet përgjegjëse të reflektohen në Planin e Veprimit.

***Në vazhdimësi, çdo vit para hartimit të Planit të përditësuar të Veprimit të SNKK***

- Konkluzione mbi implementimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Baza ligjore për ndarjen e kompetencave.
1. Mungesa e aneksit të Urdhrit të Ministrit nr. 2237, datë 20.02.2018, tregon për një Urdhër Ministri të mangët. Kjo ndikon në efektshmërinë e vetë urdhrit. Aneksi që mungon duhet të sigurojë se secili Zv/Ministër, specifikisht ai në rolin e KKK, po zbaton detyrat dhe përgjegjësitë për çështjet në sektorin e antikorrupsionit.
  2. Paqartësia nëse ndryshimet në lidhje me kompetencat e KKK duhet të përfshihen nëpërmjet ndryshimit të Ligjit 8678, datë 14.05.2001, i ndryshuar ose të Rregullores së Brendshme ka dhënë efektet e veta në mungesën e vizionit të institucionit në implementimin dhe monitorimin e SNKK 2015-2020 dhe Planit të Veprimit. Mungesa e një akti që vendos kornizat administrative të fushës së veprimit të KKK:
    - nuk mundëson një strukturë organizative të fokusuar ndaj antikorrupsionit, pasi mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e specifikuar sipas secilit sektor;
    - nuk mundëson identifikimin e nevojave për burime njerëzore, pasi nuk janë të qarta kompetencat dhe cilësitë që duhet të ketë stafi mbështetës në përmbushje të misionit të KKK;
    - nuk garanton, për pasojë, suksesin e strategjisë dhe Planit të Veprimit.Dilema të tilla administrative ndikojnë drejtpërdrejt në efektivitetin e vetë dokumenteve strategjike në përmbushjen e programeve të qeverisë dhe veçanërisht Prioritetit 3 të Bashkimit Evropian **“Vendosmëri në luftën kundër korrupsionit”**, ashtu siç theksohet edhe në SNKK 2015-2020.
  3. Mungesat e theksuara të stafit, i cili duhet të fokusohet në çështjet antikorrupsion, bëjnë që misioni i KKK në sigurimin e implementimit dhe monitorimit të objektivave specifike dhe atyre madhore të parashikuara në dokumentet strategjike, të jetë i vështirë për t’u arritur.

**Për këtë rekomandojmë:**

1. Ministri i Drejtësisë të marrë masa për hartimin e aneksin të Urdhrit nr. 2237, datë 20.02.2018.

***Brenda muajit tetor 2018***

2. Ministri i Drejtësisë të marrë masa dhe të hartojë Rregulloren e Brendshme duke specifikuar mandatin, fushën e veprimit, detyrat dhe përgjegjësitë e KKK dhe të të gjithë organikës sipas Skemës 2 të Urdhrit të Kryeministrit nr. 5166, datë 05.10.2017 “Organika e Ministrisë së Drejtësisë”

***Brenda muajit tetor 2018***

3. Ministria e Drejtësisë të marra masa në plotësimin e vendeve vakante, specifikisht të të tre sektorëve me fokus antikorrupsionin.

***Brenda muajit nëntor 2018***

- Konkluzione në lidhje me strukturën përgjegjëse për garantimin e implementimit të SNKK dhe Planit të Veprimit.

Mungesa e takimeve koordinuese çdo 3 dhe 6 muaj prek cilësinë e raportimeve dhe qasjen e institucioneve përgjegjëse në implementimin e SNKK dhe Planit të Veprimit. Pa takime të vazhdueshme në të cilat të reflektohen vështirësitë dhe problemet që hasin grupet e interesit, është e vështirë të rishikohet Plani i Veprimit. Gjithashtu, mungesa e tërësisë së dokumentacionit dhe evidencave mbi aktivitetin e Sekretariatit Teknik, tregojnë jo vetëm për procese pune të pafilluara, por edhe për një mungesë vëmendje dhe dëshirë që këta dy dokumente strategjikë siç është SNKK dhe PV të implementohen suksesshëm nën optikën e KKK dhe të gjithë palëve të interesit.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

1. KKK aktual të organizojë në mënyrë periodike dhe sistematike takimet sipas harqeve kohore të mirëpërcaktuara në SNKK 2015-2020.

*Në vazhdimësi*

2. KKK aktual të ngrejë dhe të sigurojë funksionimin e plotë të Sekretariatit Teknik.

*Brenda muajit tetor 2018*

- a. Sekretariati teknik të hartojë raportet e përmbledhura të monitorimit çdo 3 muaj sikundër është parashikuar në SNKK 2015-2020

*Në vazhdimësi*

- b. Mekanizmi Monitorues të sigurojë se Sekretariati Teknik po ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e veta në përputhje me specifikimet e SNKK 2015-2020, miratuar me VKM 247, datë 20.3.2015.

*Në vazhdimësi*

3. Sekretariati Teknik të organizojë periodikisht takime diskutimi mbi raportet e monitorimit të hartuara dhe të publikuara.

*Në vazhdimësi*

- Konkluzione në lidhje me monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Strukturat përgjegjëse.

1. Mungesa e ngritjes së Mekanizmit Mbikëqyrës dhe Zbatues të SNKK 2015-2020 e Planit të Veprimit dhe pretendimi se rolin këtij mekanizmi e ka kryer Grupi i Menaxhimit dhe Implementimit të Politikave për Mirëqeverisjen dhe Reformën e Administratës Publike, me anë të një prej nëngrupeve tematike të punës, i cili është drejtuar nga një ministër shteti që nuk është as Ministri për Çështjet Vendore e as Zv. Ministri i Drejtësisë (pas 13.09.2017) tregon se kemi të bëjmë me një shkelje të Urdhrit të Kryeministrit nr. 125, datë 21.09.2015 për arsyet se:

- Funkzioni i Mekanizmit Mbikëqyrës dhe Zbatues të SNKK 2015-2020 dhe Planit të Veprimit nuk është i njëjtë me funksionin e GMIP.
- Edhe pse ky Urdhër ka dalë më vonë se Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 247, datë 20.3.2015, i cili miraton SNKK 2015-2020 dhe Planin e Veprimit, GMPI-të nuk reflektojnë nevojat e SNKK-së për institucionin e Mekanizmit të Mbikëqyrjes dhe Zbatues.

2. Mungesa e këtij mekanizmi vë në rrezik implementimin e një strategjie ndërsektoriale, e cila synon të përmbushë, jo vetëm programin e qeverisë, por edhe një nga 5 prioritetet e BE.

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

KKK aktual të krijojë Mekanizmin Monitorues dhe të sigurojë funksionimin e plotë të tij sikundër përcaktohet në SNKK 2015-2020.

### ***Brenda muajit Tetor 2018 dhe në vazhdimësi***

## **2. Në lidhje me pyetjen si janë zbatuar nënobjektivat e strategjisë dhe aktivitetet e PV për adoptimin e politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore?**

### **• Konkluzione të nënpyetjes: Sa ka ndikuar angazhimi i Prefekturave në adoptimin e politikave kundër korrupsionit në nivel vendor?**

1. Asnjë nga pikat fokale për implementimin e SNKK 2015-2020 dhe Planit të Veprimit nuk raporton sipas formatit të miratuar nëpërmjet Urdhrit të Kryeministrit nr. 139, datë 01.07.2010. Matrica aktuale e cila përmban informacion përshkrues nuk e bën të mundur krahasimin e masave të ndërmarra kundrejt atyre të planifikuara. Matrica e vlerësimit të rezultateve zbatohet ndër të tjera dhe për llogaridhënien me qëllim rritjen e transparencës.
2. Nuk ka asnjë vazhdimësi në raportim as nga prefektura të cilat në 2015 kanë raportuar arritjet / mosarritjet e tyre pranë KKK.  
Ka prefektura që nuk kanë raportuar më shumë se një herë. Prefektura më e rëndësishme e vendit, ajo e Tiranës nuk ka raportuar asnjëherë në tre vite për vlerësimin e zbatueshmërisë së masave të Planit të Veprimit. Edhe ato prefektura që kanë raportuar për vitin e parë të implementimit të SNKK dhe Planit të Veprimit, nuk kanë raportuar rregullisht për vitet 2016 dhe 2017. Mungesa e periodicitetit në raportim tregon për mungesë angazhimi nga të gjitha palët, KKK dhe vetë niveli lokal (prefekturat). Kjo mungesë angazhimi në raportim e aq më tepër në zbatim, bëhet faktor përcaktues i efekteve të strategjisë ndërsektoriale për rezultate të prekshme në luftën kundër korrupsionit.
3. Edhe rastet kur aktivitetet e objektivave të një strategjie nuk varen nga disponueshmëria e burimeve financiare (pasi nuk është parashikuar kosto për realizimin e tyre), vihet re se mosrealizimi i tyre është produkt i një punë të pakryer mirë apo i një procesi të porealizuar. Në rastin konkret, Prefektura Fier në raportin e vitit 2017 konfirmon se për objektivin specifik A11.1 “*Në vazhdim jemi në procedurë e sipër për punësimin e një specialisti IT*”<sup>100</sup>, duke mos dhënë asnjë afat kohor për realizimin e një nënobjektivi që pretendohet se e kanë propozuar vetë. Ky koment, me gjithë mangësitë e veta për një planifikim korrekt të punës nga ana e prefekturës për realizimin e objektivave specifike, flet për një mospërfshirje të pushtetit vendor në hartimin e objektivave që ata vetë duhet të realizojnë. Në këtë mënyrë, të gjithë këta objektiva specifike, sado të rëndësishëm të jenë në dukje, bëhen të porealizueshëm ose realizohen fare rastësisht, pa patur një plan të saktë pune për të zbrërthyer me tej Planin e Veprimit.

---

<sup>100</sup>Raporti i monitorimit, viti 2017

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

1. KKK të evidentojë përgjegjësitë për mangësitë e shfaqura deri tani, të marrë masa dhe të informojë të gjithë pikat fokale për implementimin e SNKK dhe Planit të Veprimit, mbi raportimin e tyre sipas Matricës së Vlerësimit të Rezultateve.

***Vazhdimisht***

2. KKK të grumbullojë raportimet e të gjithë institucioneve përgjegjëse në zbatimin e Planit të Veprimit, për të gjeneruar raporte sa më të plota të monitorimit.

***Vazhdimisht***

3. KKK dhe Mekanizmi Monitorues, të kujdesen që të monitorojnë raportimin dhe zbatimin e objektivave specifike të secilit objektiv madhor të SNKK dhe Planit të Veprimit, për të siguruar realizim të këtyre masave brenda afateve të parashikuara kohore.

***Vazhdimisht***

- *Konkluzione të nënpyetjes: A janë efektive mekanizmat e Monitorimit dhe të Vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal?*

MSHMS (ish-MMSR) është institucioni të cilit i janë vënë detyra në sektorin social për krijimin e mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal (një ndër katër nënobjektivat e objektivit 11 të Strategjisë), ndërsa Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) është në cilësinë e institucionit bashkëpunues për realizimin e tyre. Ky nënobjektiv në Planin e Veprimit ka dy tregues zbatimi: A. Numri i inspektimeve vjetore; dhe B. Numri i rasteve të referuara dhe proceduara për abuzim, tregues këto për gjithë periudhën duke filluar nga janari i vitit 2015, si dhe është parashikuar pa kosto shtesë.

1. Në kuptimin klasik, mekanizmi i monitorimi ndihmon në zbatimin efektiv të rregullave, si dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. Monitorimi duhet të identifikojë pengesat dhe të sugjerojë masa të përshtatshme që do të kontribuonin në zbatimin e suksesshëm të rregullave. Kjo arrihet edhe nëpërmjet inspektimeve për kontrollin ose testimin e një çështjeje të caktuar kundrejt standardeve të vendosura. Nga kjo konkludohet se në praktikë ka një mospërputhje midis mekanizmave të monitorimit dhe të vlerësimit të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike dhe treguesit të inspektimeve dhe rasteve dhe procedurave të referuara për abuzim.
2. MSHMS, lidhur me raportimin e objektivit specifik A11.1, në periudhën 2015-2017 thjesht ka përcjellë informacionin e marrë nga SHSSH për tek Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit, megjithëse është institucion përgjegjës për krijimin e mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal.
3. Strukturat e SHSSH, në vijim kanë synuar për të përmbushur 7 objektiva thelbësore, një ndër të cilat ka të bëjë me shmangien e abuzimeve nga skema e aftësisë së kufizuar, por që përsëri nuk është e plotë krahasuar me treguesit e Strategjisë kundër korrupsionit, pasi nuk përfshin ndihmën ekonomike dhe për personat me aftësi të kufizuar, të cilat përbëjnë mbi 96 % të shpenzimeve gjithsej të alokuara për Shërbimin Social Shtetëror.

4. Shërbimi Social Shtetëror është një institucion publik i cili ka për mision zbatimin e politikave, legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore. Këtë mision e realizon përpos të tjerave, nëpërmjet kontrollit të zbatimit të legjislacionit dhe përdorimit të fondeve buxhetore për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore, të cilën e realizon nga kontrollet e administratës për 12 Zyra Rajonale, dhe prej këtyre të fundit në të gjitha njësitë vendore.<sup>101</sup> Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se, veprimtaria normale e SHSSH për kontrollin e përdorimit të fondeve (një tregues i aktiviteteve të Planit të Veprimit të Strategjisë) konsiderohet në plotësim të objektivave të Strategjisë për Qasjen Parandaluese, çka bën që Strategjia të humbasë vlerat e saj si dokument i rëndësishëm ndërsektorial.

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

1. Sekretariati Teknik të marrë masa që për Planin e ri të Veprimit t'i vendosë MSHMS tregues konkretë që lidhen drejtpërdrejt me krijimin e mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit periodik të ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal, në funksion të luftës kundër korrupsionit dhe rritjes së mirëqenies së popullatës.

#### ***Me hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020***

2. Sekretariati Teknik, nëpërmjet MSHMS dhe përfshirjes së saj, të sigurojë monitorim dhe vlerësim periodik të ofrimit të shërbimeve dhe të ndihmës ekonomike në nivel lokal, jo vetëm nga ana e institucioneve mbështetëse.

#### ***Vazhdimisht***

3. Sekretariati Teknik të marrë masa dhe të evidentojë përgjegjësitë në rastin e raportimeve me mangësi dhe jashtë afateve kohore nga ana e MSHMS, kjo e fundit kundrejt institucioneve mbështetëse të vartësisë.

#### ***Vazhdimisht***

4. Sekretariati Teknik dhe MSHMS të marrë masat e nevojshme që në Planin e ri të Veprimit të mundësojë përfshirjen e inspektimeve në objektivat qeverisëse dhe ato specifike të Strategjisë kundër korrupsionit.

#### ***Me hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020***

5. Sekretariati Teknik, sëbashku me Mekanizmin Monitorues, të sigurojnë se institucionet përgjegjëse raportojnë për secilën periudhë që duhet përgatitur dhe publikuar raporti i implementimit të SNKK 2015-2020 dhe Planit të Veprimit.

#### ***Vazhdimisht***

6. KKK dhe Mekanizmi monitorues të monitorojnë me rigorozitet nëse institucionet përgjegjëse përdorin instrumentet e duhura për implementimin e objektivave kryesorë dhe specifike për përmbushjen e SNKK 2015-2020.

#### ***Vazhdimisht***

---

<sup>101</sup><http://www.sherbimisocial.gov.al>

• Konkluzione të nënpyetjes: A realizohet ofrimi i shërbimeve administrative përmes sporteleve unike në nivel vendor?

1. Realizimi i sporteleve unike në të gjitha bashkitë e vendit nuk është realizuar në afat brenda vitit 2017, sipas parashikimeve në Planin e veprimit për 49 bashki nga 61 gjithsej ose është realizuar në vetëm  $\frac{1}{4}$  e tyre. Duhet theksuar se në raportimet e vitit 2016 dhe 2017 përfundimi është shtyrë me një vit, në kundërshtim me parashikimet e Planit të Veprimit.
  2. Ka mangësi në cilësinë e raportimeve 2015-2017 të pikave të kontaktit të prefekturave dhe të pranuar nga Koordinatori kombëtar si përsa i përket vijueshmërisë, periudhave, numrit të bashkive për të cilat raportohet, ashtu edhe elementëve që e përbëjnë këtë aktivitet si: inventarizimi i shërbimeve, konsiderimi i atyre parësore, etj., duke evidentuar njëkohësisht edhe mungesën e monitorimit të ecurisë së zbatimit të objektivit për krijimin e sporteleve unike.
  3. Ndryshe nga sa është parashikuar fillimisht në Planin e Veprimit si një aktivitet pa kosto shtesë, në raportimet e mëvonshme është vendosur një kosto e përafërt prej 2 milionë US\$, çka tregon për mangësi të theksuara në hartimin Planit të Veprimit dhe probleme të mëdha në realizimin e Strategjisë, në kushtet kur edhe kostoja e parashikuar nuk ishte e mbuluar plotësisht me fondet përkatëse.
  4. Niveli i ndërgjegjësimit të institucioneve të përfshira në Strategji në raport me zbatimin e Planit të Veprimit, bazuar në raportimin e kryer nga vetë këto institucione, rezulton të jetë i ulët, edhe për shkak edhe të aktorëve të ndryshëm në zbatim dhe raportim.
  5. Ka munguar monitorimi dhe koordinimi ndër-institucional, duke ndikuar negativisht në rritjen e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga strukturat e brendshme të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve përkatëse të Planit të Veprimit të Strategjisë kundër korrupsionit.
- Në këto kushte, SNKK nuk ka arritur të përballojë sfidën e transparencës në veprimtarinë shtetërore, për të mundur një kontroll më të plotë nga ana e publikut.

**Për këto rekomandojmë:**

1. KKK të evidentojë përgjegjësitë për mosrealizimin e treguesit të krijimit të sporteleve unike brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit, si dhe të sigurojë saktësinë e raportimeve të të gjithë institucioneve përgjegjëse për të gjeneruar një raport vjetor sa më cilësor.

***Brenda muajit tetor 2018 dhe vazhdimisht***

2. KKK, në Planin e ri të Veprimit të vendosë afate dhe kosto reale që të garantojnë zbatimin me sukses të Strategjisë për krijimin e sporteleve unike deri në nivelin e njësive administrative.

***Me hartimin e planit tëri të veprimit***

3. Sekretariati Teknik të hartojë një raport të veçantë lidhur me efektet që ka në zbatimin e Strategjisë kundër korrupsionit roli dhe përgjegjësia e institucioneve shtetërore që zbatojnë dhe raportojnë ecurinë e implementimit të treguesve të Planit të Veprimit.

***Brenda vitit 2018***

4. KKK dhe Sekretariati teknik të monitorojnë dhe të koordinojnë krijimin sporteleve me një ndalesë për shërbimet administrative në njësitë e pushtetit lokal, si një nga elementët e rëndësishëm të adoptimit të politikave kundër korrupsionit në nivel vendor.

**Vazhdimisht**

**3. Në lidhje me pyetjen Cili është perceptimi i opinionit publik dhe palëve të tjera për politikave të ndërmarra kundër korrupsionit në qeverisjen vendore?**

- Konkluzione të nënpyetjes: Si është perceptimi i opinionit publik mbi adoptimin e politikave kundër korrupsionit nga zyrtarët vendorë?

1. Mosrealizimi i takimeve informuese me qytetarët, nga Prefekturat, mbi aktivitetet antikorrupsion të ndërmarra në kuadër të PV dhe SNKK, ka ndikuar negativisht në njohjen e këtyre të fundit nga publiku. Si pasojë, Strategjia nuk ka dhënë efektin e duhur në motivimin e individëve për të denoncuar rastet e konstatuara të korrupsionit.
2. Pamundësia për të parandaluar korrupsionin midis zyrtarëve të niveleve të ndryshme hierarkike me anë të masave të përcaktuara në PV, sëbashku me mosadoptimin e politikave apo adoptimin jo në frekuencën e duhur, nuk ka dhënë efektin e pritur në perceptimin e qytetarëve lidhur me korrupsionin, duke shkaktuar që ky i fundit të mbetet i njëjtë apo të jetë në rritje në njësitë e qeverisjes vendore në tre vitet e fundit.

**Për këtë rekomandojmë:**

1. Realizimin e takimeve informuese me qytetarët, nga Prefekturat, me qëllim informimin e publikut lidhur me aktivitetet antikorrupsion të adoptuara në kuadër të SNKK 2015–2020.

**Vazhdimisht**

2. Të ndërmerren masa nga prefekturat për adoptimin e aktiviteteve A 11.1, A 11.3, A 11.4 dhe A 11.6 të përcaktuara në Planin e Veprimit 2015-2017<sup>102</sup>.

**Menjëherë**

3. Të ndërmerren masa nga bashkitë për adoptimin e aktivitetit A 11.5 të përcaktuar në Planin e Veprimit 2015-2017<sup>103</sup>.

**Menjëherë**

4. Të monitorohet me rigorozitet nga KKK adoptimi i objektivit A11 nga prefekturat dhe bashkitë.

**Vazhdimisht**

5. Të merren në shqyrtim nga KKK format më të përhapura të korrupsionit në qeverisjen vendore<sup>104</sup>, dhe të rivlerësohen aktivitetet antikorrupsion të

---

<sup>102</sup>Plani i Veprimit 2015-2017, fq 53.

<sup>103</sup>Plani i Veprimit 2015-2017, fq 53

përcaktuara në nënobjektivin A11 nëse i parandalojnë këto forma. Nëse jo, të ndërmerren masat më emergjente dhe të domosdoshme në përgjigje të tyre dhe të përfshihen në planin e ri të veprimit.

### ***Me hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020***

- *Konkluzione të nënpyetjes: Cili është opinionimi i shoqërisë civile mbi korrupsionin në qeverisjen vendore?*
  1. Mosorientimi i veprimtarisë së shoqërisë civile nga vetë shoqëria civile drejt luftës kundër korrupsionit, ka bërë që kjo e fundit të mos realizojë aktivitetet që një OJF duhet të realizojë (bazuar në praktika të mira dhe në vetëvlerësimin e OJF-ve të pyetura nga G.A.) për të ndihmuar parandalimin e korrupsionit në qeverisjen vendore.
  2. Faktet e paraqitura më herët në raport hedhin dyshim mbi vërtetësinë e fondeve të alokuara nga AMSHC kah projekteve me tematikë antikorrupsionin.
  3. Mosekzistenca e një mekanizmi i cili kontrollon besueshmërinë e statusit “I zbatuar” në raportet e monitorimit të gjeneruara nga Sekretariati Teknik, rrezikon që “norma” e zbatueshmërisë së Strategjisë të mos paraqesë situatën reale.
  4. Mospërfshirja e shoqërisë civile në takimet konsultative të zhvilluara nga KKK mbi hartimin dhe zhvillimin e Strategjisë ka bërë që një pjesë e konsiderueshme e OJF-ve në të gjithë republikën të mos ketë dijeni mbi ekzistencën e SNKK dhe PV. Mosdijenia dhe mosprania e shoqërisë civile në takimet konsultative të KKK-së ka rezultuar në mosparaqitjen e masave antikorrupsion më të nevojshme për t’u ndërmarrë në qeverisjen vendore (të reflektuara nga shoqëria civile). Si pasojë, kjo ka shkaktuar mosreflektimin e opinionit të shoqërisë civile dhe indirekt atë të qytetarit, në masat antikorrupsion të përcaktuara në PV.
  5. Mospërfshirja e shoqërisë civile nga Prefekturat, në zbatimin dhe monitorimin e politikave antikorrupsion të adoptuara në njësitë e qeverisjes vendore, ka shkaktuar mungesën e kontributit të këtij aktori në adoptimin e politikave, të perceptuara jo të adoptuara nga publiku.

### **Për këtë rekomandojmë:**

1. Angazhim aktiv të OJF-ve nga vetë OJF-të, në aktivitete antikorrupsion në qeverisjen vendore në përgjithësi dhe në 7 aktivitetet e gjeneruara më lart nga G.A, në veçanti.

***Menjëherë***

2. Auditim Performance nga institucioni i KLSH-së për AMSHC-në.

***Brenda vitit 2019***

3. Krijimi i një mekanizmi në hierarkinë e zbatimit të Strategjisë me qëllim monitorimin e vërtetësisë së të dhënave të raportuara nga Sekretariati Teknik në raportet e monitorimit.

### ***Me hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020***

4. Përfshirjen nga KKK të shoqërisë civile, në takimet konsultative me përfaqësues të OJF-ve nga të gjitha qarqet dhe mbajtjen në konsideratë të përvojës dhe

perceptimit të tyre nga Sekretariati Teknik gjatë hartimit dhe përditësimit të masave antikorrupsion (për qeverisjen vendore) në planet e reja të veprimit.

***Me hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020***

5. Përfshirjen e shoqërisë civile nga prefekturat në adoptimin e politikave antikorrupsion në njësitë e qeverisjes vendore

***Menjëherë***

#### 4.1. Aneksë (tabela, grafikë, figura, pyetësorë, literature, etj.)

##### 1. Pyetësor me pyetje të mbyllura drejtuar qytetarëve:

[https://docs.google.com/forms/d/1jMmYXSDj8mapviGJ8kPtq3pjiyRtN6X\\_khpyëYvPN32I/prefill](https://docs.google.com/forms/d/1jMmYXSDj8mapviGJ8kPtq3pjiyRtN6X_khpyëYvPN32I/prefill)

##### 2. Pyetësor me pyetje të mbyllura, drejtuar OJF-ve.

[https://docs.google.com/forms/d/1v1EFËyTVOhjBYucxCzAm6oQmngxSNtXFkFUhPSdp\\_e0/prefill](https://docs.google.com/forms/d/1v1EFËyTVOhjBYucxCzAm6oQmngxSNtXFkFUhPSdp_e0/prefill)

##### 3. Intervistë për 3 OJF-të më aktive: TIA, IDM, IDRA

### INTERVISTË KORRUPSIONI NË QEVERISJEN VENDORE

Departamenti i Auditimit të Performancës, në Kontrollin e Lartë të Shtetit, po auditon Strategjinë Ndërsektoriale Antikorrupsion në Shqipëri, me fokus objektivin që adreson korrupsionin në qeverisjen vendore. Kjo intervistë, i shërben përthithjes së informacioneve zyrtare mbi përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në këtë Strategji. Informacionet e marra nga intervista do të paraqiten në raportin e auditimit.

#### I. Informacion i përgjithshëm mbi OJF-në

1. Fokusi i organizatës:
2. Cili ishte fokusi i projektit/projekteve? Lutemi përshkruani shkurtimisht konkluzionet:
3. Kush prej aktorëve kryesorë të shoqërisë janë përfshirë në projektin tuaj?
4. Sa kohë ka zgjatur ky projekt/projektet? Çfarë metodologjie keni përdorur për të trajtuar çështjen?

#### II. Roli i OJF-së në shoqërinë shqiptare dhe luftën kundër korrupsionit

1. Si e vlerësoni rolin e organizatës tuaj në shoqërinë shqiptare, në tërësi në tre vitet e fundit?
2. Nëse organizata juaj është përballur me sfida gjatë tre viteve të fundit, çfarë lloj sfidash kanë qenë? Lutemi jepni komentin tuaj.
3. Mendoni se angazhimi i OJF-ve nga njësitë e qeverisjes vendore do të ndihmonte në parandalimin e korrupsionit në qeverisjen lokale? Nëse po, përmendini disa aktivitete që OJF-të mund të realizojnë.
4. A ka realizuar ndonjë nga aktivitetet e mësipërme organizata juaj? Lutemi argumentoni përgjigjen tuaj.
5. A mendoni se shoqëria civile ka kontribuar mjaftueshëm në luftën kundër korrupsionit? Argumentoni përgjigjen tuaj.
6. Nëse do të angazhoheshit në aktivitetet e mëposhtme nga prefektura/bashkia e qarkut, sa mundet organizata juaj, të kontribuojë në realizimin e secilit prej tyre? Listoni të paktën një formë si ju mund të asistoni nj.q.v në secilin prej tyre dhe **burimet** që ju nevojiten.
  - Krijimi i faqeve web të përditësuar:
  - Publikimi në ambientet publike dhe internet të prefekturave të buxheteve dhe shpenzimeve të çdo komune dhe bashkie në qark:
  - Krijimi i regjistrit tematik të ankesave:

- Publikimi në ambientet publike të çdo prefekturë të akteve nënligjore të miratuara nga bashkitë përkatëse të qarkut:

### III. Korrupsioni dhe aktivitetet antikorrupsion në njësitë e qeverisjes vendore

1. Çfarë ka ndodhur me korrupsionin në tre vitet e fundit në qeverisjen vendore? Ku e bazoni mendimin tuaj?
2. Përmendni disa nga format më të përhapura të korrupsionit në njësitë e qeverisjes tuaj vendore? Cilat janë arsyt kryesore të korrupsionit?
3. A keni dijeni për Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK), të ndërmarrë nga qeveria për periudhën 2015-2020? Nëse po, lutemi tregoni burimin tuaj të informimit.
4. A keni marrë pjesë në takimet konsultative gjatë procesit të hartimit të SNKK?
5. Nëse organizata juaj, ka marrë pjesë në takimet konsultative të SNKK, lutemi përmendni frekuencën e pjesëmarrjes në to. Cili ka qenë angazhimi juaj në këto takime?
6. Mendoni se kjo strategji ka ulur korrupsionin, apo perceptimin ndaj tij, në njësitë e qeverisjes vendore? Çfarë mund të sugjeroni për t'u përmirësuar lidhur me SNKK?
7. A është kërkuar ndonjëherë mendimi juaj mbi masat më të nevojshme/immediate për t'u ndërmarrë me qëllim parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në njësitë e qeverisjes vendore? Nëse po, nga cili institucion dhe në ç' mënyrë është mbledhur opinioni juaj?
8. Sa mendoni se secili nga aktivitetet nga a-f, do të ndikojnë në arritjen e qëllimeve 1-4, për të luftuar korrupsionin në qeverisjen vendore. Vlerësoni me: shumë, mjaftueshëm, pak, aspak, ose nuk e di, në secilën nga kufizat boshe.

	1.Forcimi i transparencës përmes zbatimit të ligjit	2.Rritjen e transparencës lidhur me kontrollin dhe financimin e partive	3.Forcimi i integritetit dhe transparencës lidhur me zyrtarët publik	4.Çrrënjosjen e korrupsionit nga rradhët e administratës publike
a)Krijimi i faqeve web				
b)Publikimi në ambientet publike dhe internet të prefekturave të buxheteve dhe shpenzimeve të çdo komune dhe bashkie në qark				
c)Krijimi i regjistrit tematik të ankesave				
d)Publikimi në ambientet publike të çdo				

prefekturë të akteve nënligjore të miratuara nga bashkitë përkatëse të qarkut				
e) Ofrimi i shërbimeve administrative në nivel vendor përmes sporteve unike				
f) Krijimi i mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit periodik të ofrimit të ndihmës ekonomike				

9. A mendoni se aktivitetet e përmendura nga a- f, janë më imediate për t'u ndërmarrë për parandalimin e korrupsionit në njësitë e qeverisjes vendore? Përmendni disa prej masave më emergjente dhe të nevojshme për t'u ndërmarrë në qeverisjen lokale.
10. Në çfarë çështjesh të tjera do të donit të tërhiqnit vëmendjen e grupit auditues për këtë auditim apo edhe për të tjera?

#### **4. Pyetësor me pyetje të hapura për OJF me projekte fituese me tematikë çështjet antikorrupsion.**

##### **PYETËSOR ME PYETJE TË HAPURA KORRUPSIONI NË QEVERISJEN VENDORE**

Departamenti i Auditimit të Performancës, në Kontrollin e Lartë të Shtetit, po auditon Strategjinë Ndërsektoriale Antikorrupsion në Shqipëri, me fokus objektivin që adreson korrupsionin në qeverisjen vendore. Ky pyetësor me pyetje të hapura, i shërben përthithjes së informacioneve zyrtare mbi përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në këtë Strategji. Përgjegjshmëria dhe profesionalizmi juaj në plotësimin e këtij pyetësori, do të na vinte në ndihmë për të pasqyruar reflektimet e shoqërisë civile lidhur me çështjet e korrupsionit. Informacionet e marra nga plotësimi i pyetësorit janë konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për qëllim të auditimit. Lutemi, që ky pyetësor të plotësohet nga të paktën një (një deri në tre) përfaqësues i organizatës tuaj, preferohet të ketë njohuri mbi tematikat e korrupsionit dhe parandalimit të tij.

#### **I. Informacion i përgjithshëm mbi OJF-në dhe projektin fitues**

1. Prefektura/ Qarku ku jeni të regjistruar:
2. Fokusi i organizatës:
3. Pozicioni juaj në organizatë:

4. Projekti/ projektet fitues/e në AMSHC:
5. Kush ishte fokusi i projektit/projekteve? Lutemi përshkruani shkurtimisht konkluzionet:
6. Kush prej aktorëve kryesorë të shoqërisë janë përfshirë në projektin tuaj?
7. Sa kohë ka zgjatur ky projekt/projektet? Çfarë metodologjie keni përdorur për të trajtuar çështjen?

## **II. Roli i OJF-së në shoqërinë shqiptare dhe luftën kundër korrupsionit**

8. Si e vlerësoni rolin e organizatës tuaj në shoqërinë shqiptare, në tërësi në tre vitet e fundit?
9. Nëse organizata juaj është përballur me sfida gjatë tre viteve të fundit, çfarë lloj sfidash kanë qenë? Lutemi jepni komentin tuaj.
10. Mendoni se angazhimi i OJF-ve nga njësitë e qeverisjes vendore do të ndihmonte në parandalimin e korrupsionit në qeverisjen lokale? Nëse po, përmendini disa aktivitete që OJF-të mund të realizojnë.
11. A ka realizuar ndonjë nga aktivitetet e mësipërme organizata juaj? Lutemi argumentoni përgjigjen tuaj.
12. A mendoni se shoqëria civile ka kontribuar mjaftueshëm në luftën kundër korrupsionit? Argumentoni përgjigjen tuaj.
13. Nëse do të angazhoheshit në aktivitetet e mëposhtme nga prefektura/bashkia e qarkut, sa mundet organizata juaj, të kontribuojë në realizimin e secilit prej tyre? Listoni të paktën një formë si ju mund të asistoni nj.q.v në secilin prej tyre dhe **burimet** që ju nevojiten.
  - Krijimi i faqeve web të përditësuar:
  - Publikimi në ambientet publike dhe internet të prefekturave të buxheteve dhe shpenzimeve të çdo komune dhe bashkie në qark:
  - Krijimi i regjistrit tematik të ankesave:
  - Publikimi në ambientet publike të çdo prefekturë të akteve nënligjore të miratuara nga bashkitë përkatëse të qarkut:

## **III. Korrupsioni dhe aktivitetet antikorrupsion në njësitë e qeverisjes vendore**

14. Çfarë ka ndodhur me korrupsionin në tre vitet e fundit në qeverisjen vendore? Ku e bazoni mendimin tuaj?
15. Përmendni disa nga format më të përhapura të korrupsionit në njësitë e qeverisjes tuaj vendore? Cilat janë arsyet kryesore të korrupsionit?
16. A keni dijeni për Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK), të ndërmarrë nga qeveria për periudhën 2015-2020? Nëse po, lutemi tregoni burimin tuaj të informimit.
17. A keni marrë pjesë në takimet konsultative gjatë procesit të hartimit të SNKK?
18. Nëse organizata juaj, ka marrë pjesë në takimet konsultative të SNKK, lutemi përmendni frekuencën e pjesëmarrjes në to. Cili ka qenë angazhimi juaj në këto takime?
19. Mendoni se kjo strategji ka ulur korrupsionin, apo perceptimin ndaj tij, në njësitë e qeverisjes vendore? Çfarë mund të sugjeroni për t'u përmirësuar lidhur me SNKK?

- 20.A është kërkuar ndonjëherë mendimi juaj mbi masat më të nevojshme/immediate për t'u ndërmarrë me qëllim parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në njësitë e qeverisjes vendore? Nëse po, nga cili institucion dhe në ç' mënyrë është mbledhur opinionimi juaj?
- 21.Sa mendoni se secili nga aktivitetet nga a-f, do të ndikojnë në arritjen e qëllimeve 1-4, për të luftuar korrupsionin në qeverisjen vendore. Vlerësoni me: shumë, mjaftueshëm, pak, aspak, ose nuk e di, në secilën nga kufizat boshe.

	1.Forcimi i transparencës përmes zbatimit të ligjit	2.Rritjen e transparencës lidhur me kontrollin dhe financimin e partive	3.Forcimi i integritetit dhe transparencës lidhur me zyrtarët publik	4.Çrrënjosjen e korrupsionit nga rradhët e administratës publike
a)Krijimi i faqeve web				
b)Publikimi në ambientet publike dhe internet të prefekturave të buxheteve dhe shpenzimeve të çdo komune dhe bashkie në qark				
c)Krijimi i regjistrit tematik të ankesave				
d)Publikimi në ambientet publike të çdo prefekturë të akteve nënligjore të miratuara nga bashkitë përkatëse të qarkut				
e) Ofrimi i shërbimeve administrative në nivel vendor përmes sporteleve unike				
f) Krijimi i mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit periodik të ofrimit të ndihmës ekonomike				

- 22.A mendoni se aktivitetet e përmendura nga a- f, janë më imediate për t'u ndërmarrë për parandalimin e korrupsionit në njësitë e qeverisjes vendore? Përmendni disa prej masave më emergjente dhe të nevojshme për t'u ndërmarrë në qeverisjen lokale.

23. Në çfarë çështjesh të tjera do të donit të tërhiqnit vëmendjen e grupit auditues për këtë auditim apo edhe për të tjera?

#### 4.2 Bibliografia

- BTI “Albania Country Report” 2016;
- BTI “Albania Country Report” 2018;
- European Commission, Brussels, 10.11.2015 Swd (2015) 213 Final Commission Staff Working Document, Albania 2015 Report;
- European Commission, Brussels, 17.04.2018 Swd Final Commission Staff Working Document, Albania 2018 Report;
- European Commission, Brussels, 9.11.2016 Swd Final Commission Staff Working Document, Albania 2016 Report;
- EU-Russia Civil Society Forum “2016 Report on the State of Civil Society in the EU and Russia” 18/05/2017;
- Freedom House “NIT Albania” 2018;
- Freedom House “NIT Albania” 2017;
- Freedom House, Nations in Transit Index, Albania 2008-2017;
- GRECO “FOURTH EVALUATION ROUND”, COMPLIANCE REPORT ALBANIA, March 2016;
- Gretta Fenner Zinkernagel “Strategic Approaches to Corruption Prevention in the OSCE Region”, September 2012;
- IDRA “KORRUPSIONI NË SHQIPËRI: PERCEPTIME DHE PËRVOJA 2015-2016”;
- Institute of Public Affairs “THE ROLE OF CIVIL SOCIETY IN FIGHTING CORRUPTION IN RUSSIA AND POLAND”;
- Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA II) Indicative Strategy Paper for Albania (2014-2020);
- IRM and Transparency International UK “Bribery Risk Guide” 2016;
- Keneth M. Dye “Corruption and Fraud Detection by Supreme Audit Institutions”;
- NAVEX Global “Anti-Bribery and Corruption Risk Assessment Checklist” 2016;
- OECD “HOW TO CONDUCT MONITORING BY CIVIL SOCIETY ISTANBUL ANTICORRUPTION ACTION PLAN” 2014;
- OSCE & IDM, 2016, “Report on Local Forum Consultations ëith CSOs and Business Community”;
- SIGMA, 2015, Albania “The Principles of Public Administration”;
- SIGMA, 2016, Albania “The Principles of Public Administration”;
- SIGMA, 2017, Albania “The Principles of Public Administration”;
- Transformation Index BTI, Albania 2016;
- Transformation Index BTI, Albania 2018;
- Transparency International “The Role of Civil Society in the Fight Against Corruption” Huguette Labelle, 15 February 2012;
- Transparency International “The Role of Civil Society in the Fight Against Corruption” March 2009;
- Transparency International UK, 2016, “NATIONAL INTEGRITY SYSTEM ASSESSMENT ALBANIA 2016”;
- The Institute of Internal Auditors “Audit of Institutional Framework for Fighting Corruption”;

- The Institute of Internal Auditors “Auditing Anti-Bribery and Anti-Corruption Programs” June, 2014;
- The Institute of Internal Auditors “Role of Audit in Fighting Corruption”;
- U4 Anti-corruption resource centre “UNCAC and the participation of NGOs in the fight against corruption” 2008;
- U4 BRIEF “The Proxy Challenge: Ëhy bespoke Proxy indicators can help solve the anti-corruption measurement problem” 2013;
- UNDOC “Country Review Report of Albania” April 2016;
- UNDP “A Users’ Guide to Measuring Local Governance” Oslo Governance Centre;
- UNDP and Institute For Democracy and Mediation “TRUST in GOVERNANCE 2017” 2018;
- UNDP, IDRA and STAR II “Local Governance Mapping in Albania” Tetor 2017
- United Nations Global Compact Office “Guide for Anti-Corruption Risk Assessment” 2013;
- United Nations Mission in Sudan (UNMIS) “Role of Audit in Fighting Corruption” 2016;
- World Bank Institute “Reducing Corruption at the Local Level”, October 2000;
- World Economic Forum “The Future Role of Civil Society” January 2013;
- Worldwide Governance Indicators, Albania, 1996-2016;

#### **5. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE**

1. Z. Artur Hasanbelliu
2. Z. Gjovalin Preçi
3. Znj. Megi Kurushi
4. Znj. Eva Leka

**Drejtore i Departamentit**



**Rinald MUÇA**